



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar)

“Instituti i Statistikave”

PRIL, 2020



**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar)**

“Instituti i Statistikave”

<i>Nr</i>	<i>Përmbatja</i>	<i>Faqe</i>
I.HYRJA	(Të dhëna mbi Raportin e Auditimit)	
a)	Objektivat dhe qëllimi	8
b)	Identifikimi i çështjes.....	9
c)	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
d)	Përgjegjësitë e audituesve.....	4
e)	Kriteret e vlerësimit.....	10
f)	Standardet e auditimit.....	10
II.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT		10
A. OPINIONI I AUDITIMIT		11-12
III. DREJTIMET E AUDITIMIT		
1.	Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit.....	12-17
2.	Zbatimi i dispozitave ligjore për marëdhëniet e punës dhe pagave.....	18-22
3.	Auditimi i llogarive vjetore.....	22-69
4.	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit..	70-79
5.	Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit	
GJETJE DHE REKOMANDIME		78-86
IV.ANEKSE		87-93



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi “Insitutin e Statistikave” (INSTAT), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Auditimi i pasqyrave financiare
2. Hartimin dhe zbatimin e buxhetit
3. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar
4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në raportet e monitorimit u konstatua se mungon relacioni shpjegues në lidhje me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli. Mungon një analizë e detajuar në lidhje me investimet me financim të huaj. Veprime në kundërshtim me kapitulli IV pika 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, - Në raportet e monitorimit për 8- mujor mungon informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore” - Në raportet e monitorimit mungon rakordimi me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për shpenzimet buxhetore të realizuara nga institucioni.		MESEM	1-Drejtoria e Monitorimit dhe mbikëqyrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e planifikimit të investimeve në INSTAT të marrin masat që: - Në raportet e monitorimit të raportohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimit sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.
2	Nga auditimi u konstatua se Përgjatë periudhës objekt auditimi INSTAT ka paguar në total shumën 8,853,616 lekë si pasojë e humbjes së gjyqeve nga ish punonjës të INSTAT, të cilët janë liruar nga detyra para vitit 2017 dhe gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë në favor të ish punonjësve me kompesim monetar dhe/ose kthim në detyrë.		MESEM	Instituti i Statistikave të marrë masa që lirimet nga detyra të kryhen duke respektuar afatin e njoftimit sipas parashikimit në Kodin e Punës në zgjidhjen e kontratës së punës
3	Në pasqyrat financiare <u>të vitit 2018</u> në aktiv të bilancit kontabël llogaritë financiare paraqiten në shumën 60,480,888 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë e cila është shtuar prej vitit 2017 me 22,428,902 lekë, dhe përfaqëson rritjen e sponsorizimeve që do të trashëgohen në vitin 2019 si dhe rritjen e detyrimeve të shpenzimeve të njohura për vitin 2018 dhe që do të likujdohen në vitin 2019. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF “Procedurat e mbylljes së llogarive”, Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme. Nga auditimi u konstatua se, në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 60,480,888 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga <u>sponsorizimet</u> , në pasivin e bilancit është paraqitur në llogarinë nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 51,714,902 lekë si dhe një diferencë prej 8,765,986 lekë e cila nuk pasqyrohet. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, teprica në llogarinë 520 duhet të vërtetohet me atrakordimin me Thesarin, e cila duhet të paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve) për vitin 2018 mungon.		MESEM	1.Drejtoria e Financës së INSTAT të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit. 2. Drejtoria e Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85 “Rezultate operacioni” në grupin e llogarive të klasës së 4, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare. 3. Pasqyrat financiare vjetore, të përbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e fondeve, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme të mospërputhjeve të disa llogarive në aktet e rakordimit dhe bilancin kontabël. 4. Drejtoria e Financës të informojë në vijimësi menaxhimin e lartë mbi nivelin e



	Vlerat e mësipërme të kontabilizuarra në llogaritë “Rezultati i mbartur nga funksionimi” dhe “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” e denatyrojnë këto llogari dhe vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “Detyrimet afat shkurtër” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër (specifikisht të analizuarra sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe “Llogari të tjera” që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor). Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar. Llogaria 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, është llogari rregulluese që përfaqëson rezultatin e trashëguar nga viti ose vitet e mëparshme. Në të dhënat shpjeguese të llogarisë vjetore nuk shpjegohet besueshmëria ligjore e rezultatit të trashëguar dhe të sqarohet përbërja e tij (në ndarjen të konstatuara dhe të arkëtuara). Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditorë, përfaqësohet si rubrikë më vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepriçë kreditorë e kësaj llogarie. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe në pasqyrën financiare të vitit 2017).			realizimit të sponsorizimit dhe fondeve duke i adresuar ato në llogaritë e duhura, si dhe të sqarojnë arsyet për mosrakovordin e të dhënave të pasqyruara në kontabilitet/bilanc me të dhënat e akteve të rakovordimit, në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.
4	Nga auditimi i shpenzimeve të ushtrimit, u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakovordin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 471,251,939 lekë kurse sipas akt rakovordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 501,262,536 lekë të cilat nuk rakovdojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 2. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakovorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakovdojnë këto shuma. Edhe për vitin 2017 u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakovordin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 430,391,536 lekë kurse sipas akt rakovordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 448,520,652 lekë të cilat nuk rakovdojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pikat 172 dhe 173 si dhe UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34.		MESEM	Drejtorja e Financës së INSTAT të marrë masat për rakovordin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakovordimit me degën e thesarit. Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e INSTAT dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast. Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e shpenzimeve të realizuara kundrejt fondeve të akorduara, realizimin e regjistrit të prokurimeve të parashikuara sipas katër mujorëve, etj.
5	Nga auditimi i “Të ardhurat e ushtrimit 2018”, sipas formatit nr. 2 të bilancit vjetor, kanë mospërputhje me të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik, të pasqyruara në aktin e rakovordimit vjetor për të ardhurat. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, sipas rakovordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë për 83,394,541.48 lekë, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2018 , nga e cila janë derdhur në buxhet 9,055,205.00 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin 2019 prej 8,090,685.48 lekë. Konstatohet se, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 2		MESEM	Drejtorja e Financës INSTAT të marrë masat për regjistrimin e drejtë dhe ndjekjen e nën llogarive të granteve dhe subvencioneve, duke respektuar klasifikimin ekonomik kontabël dhe bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar. -Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për të ardhurat e ushtrimit nga veprimtaria e INSTAT dhe për çdo mospërputhje të të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	Performanca Financiare “Të ardhurat e ushtrimit 2018”, me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezultojnë se ka mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik. Nga analiza e llogarive në pasqyrat financiare (Formati 2), konstatohet se në llogarinë ekonomike 720 “Grant korrent i brendshëm” është vënë shuma 418,809,308 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “Grant nga organizma ndërkombëtare” pasqyrohet me vlerën 74,804,253 lekë në Pasqyrën e performancës ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 42,089,336.48 lekë. Po ashtu detajimi i të ardhurave dytësore në akt rakordimin e thesarit pasqyrohet në të tjera llogari nga ato të pasyrës së përfundimit. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe në pasqyrën financiare të vitit 2017)			dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast. Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e të ardhurave të siguruara, arkëtimin e tarifave nga licencimi, kryerja e analizave, grantet etj., si dhe përdorimit të këtyre shumave. -Regjistrimi dhe pasqyrimi në kontabilitet i llogarive duhet të kryhet nëpërputhje me Parimet e kontabilitetit në sektorin publik, ku dy prej të cilëve specifikojnë se, pasqyrat financiare duhet të sigurojnë transparencën dhe të jenë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e jashtëm të tyre.
6	Në pasqyrat financiare <u>të vitit 2018</u> (të aparatit edhe ato të konsoliduara) në zërin e aktiveve afatgjata, llogaria 203 “Koncension, patenta, licenca e të ngjashme” shtuar nga viti i shkruar me 1,873,730 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në bilancin <u>e vitit 2017</u> vlera e kësaj llogarie figuronte 0 lekë ndërsa në bilancin e vitit 2018 tek rreshti ‘ushtrim paraardhës’ rezultojnë me vlerën 5,389,513 lekë, shifër e cila as në shënimet shpjeguese nuk justifikohet se nga vjen.		MESEM	Drejtoria e Financës INSTAT të marrë masa për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimin mbi përgatitjen e llogarive vjetore.
7	Nga auditimi i regjistrimit të aktiveve, u konstatua se në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pasi regjistri është prezent në form elektronike, në përputhje me pikën 30 të udhëzimit i hartuar në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit por pa specifikimet e tjera sikundër kërkon Udhëzimi i sipërcituar.		MESEM	Drejtoria e Financës INSTAT të marrë masa që regjistri i aktiveve përveç hartimit të tij sipas llojit të aktiveve afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, që lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
8	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e INSTAT është zbatuar pjesërisht detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nuk është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, nuk janë dërguar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP) listat e inventarit, për t’iu dërguar më tej për miratim Këshillit të Ministrave. Nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohej AITPP, regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Gjithashtu konstatohet se, nuk është finalizuar procesi i miratimit të listës së pronave dhe nuk është vijuar me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e INSTAT nuk ka nisur asnjë procedurë për regjistrimin emarrjes së aktit në përdorim të pasurisë dhe kufijvetë kësaj pasurie të paluajtshme në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Ndërtesa që INSTAT disponon është regjistruar në kontabilitet, në bilancin kontabël të datës 31.12.2018 me vlerën që i është vendosur në Urdhrin e kalimit kapital, por nuk kemi informacion nëse kjo pronë është e regjistruar në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.		MESEM	Drejtori i INSTAT, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të kësaj pasurie, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, sidhe pas saktësisht të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për vlerësimin e trojeve dhe të pronave që ky Institucion ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit. -Të aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve të INSTAT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	<u>gjithashtu për të nuk zotërohet Akti i marrjes në përdorim, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.</u> Nga auditimi konstatohet se, nga ana e INSTAT nuk janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që ky institucion ka në dispozicion, plani i rlevimit (kadastral dhe topografik), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk arritëm të sigurojmë informacion nëse përcaktimi i vlerës së tokës është kryer Bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.			
9	Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit të aktiveve materiale u konstatua se: 1. Procedurat e inventarizimit janë zhvilluar për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara (Inventar Ekonomik, pajisje dhe makineri, mobilie, etj) si dhe gjendjet e inventarit të magazinave (kimikate, inventari i imët, qelqurina). Nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit vjetor ndërtesat, karburanti, mallrat dhe aktivet e tjera qarkulluese, mjetet e transportit, aktivet e patrupëzuara etj. Sa sipër, është vepruar <u>në kundërshtim</u> me nenin 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, 2. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet qe nuk kanë destinacion tjetër, pasi <u>nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit</u>, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. <u>Nuk ka një evidentim të situatës se inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do te procedohet ne vijim, etj.</u> 3. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2017-2018 <u>nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë</u>, (egziston një informacion, që nuk është ne përputhje me detyrimet e UMF nr. 30/2011), në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011’. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve. 4. Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30, që përcakton se “<u>ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitimi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale</u>”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Si mangësi në pamje të parë për realizimin e këtij inventarizimi rezulton se komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj, 5. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 6. Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo <u>nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e</u>	MESEM	Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar <u>procesin e vlerësimit të aktiveve</u> të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. -Nga strukturat e menaxhimit të INSTAT të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, <u>nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre</u>, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. -Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve <u>të përpilojnë një raport përmbledhës</u> mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. -Drejtori i INSTAT duhet të forcojë kontrollin në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që tu vejë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasitë fizike. -Të shmangët praktika e nxjerrjes jashtë përdorimit bazuar vetëm mbi kredenciale të punonjësit por të operohet në përputhje me Udhëzimin 30. -Të shmangët praktika e mbajtjes së aktiveve të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit në zyra qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky process -Të vlerësohet mundësia e transferimit me ose pa pagesë e aktiveve të cilat njësisë nuk i hyjnë më në punë pranë njësisë rajonale apo institucioneve të tjera.	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	<u>mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit</u> po ashtu nuk është operuar konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011 duke marr si referencë pikën 95 e vazhdim. 7. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapsirës fizike në këtë të fundit. 8. Nga auditimi rezultoj se, nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.			
10	Përsa i përket debitorëve të ndryshëm, pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 1,295,034 lekë, pas auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit mbi korrespondencën e mbajtur me këta debitorë, si dhe pas diskutimit me financën e INSTAT përsa i përket mundësisë së arkëtimit të këtyre shumave, u konstatua se, Subjekti i ka pjesërisht të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër. -Detyrimet e mbartura janë përpara vitit 2008 dhe kanë mundësi shumë të pakta arkëtimi		MESEM	Në lidhje me detyrimet e mbartura përpara vitit 2008 duke parë historikun e mundësive për arkëtim të tyre që është i ulët, bazuar në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12, pika 3g e cila specifikon se, „Nëpunësi zbatues duhet të garantoj mbledhjen e të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe në rastet kur <u>nuk është</u> i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta, rekomandoj të ndiqen edhe njëherë të gjitha hapat ligjore për rekuperimin e debitorëve dhe të vlerësohet mundësia e testimit për zhvlerësimin e tyre duke mos rënduar më pasqyrat financiare.
11	Nga auditimi i mjeteve të transportit, u konstatua se, prej vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 (katër) automjete. Në vitin 2018 janë nxjerrë në ankand 2 prej tyre Ford Mondeo dhe Opel Frontera por nuk ka patur ofertues. Për automjetin Land Rover Discovery nga na e servisit janë dhënë dy opsione, i pari është riparim i motorit me një kosto 238,000 lekë dhe i dyti blerja e një motori të përdorur me kosto 150,000 lekë por komisioni bazuar në gjendjen e amortizuar dhe koston teper të lartë për ta rikthyer në punë vendosi nxjerrjen jashtë përdorimit. Aktualisht këto automjete vazhdojnë të mbahen në hapsirën e INSTAT.		MESEM	Bazuar në faktin që automjetet nuk janë shitur në Ankand gjykojmë vlerësimin sa më shpejt të mundësisë që këto automjete të dalin jashtë përdorimit të shiten për skrap pas vlerësimit nga një ekspert i licencuar, (nisur nga fakti se përveç peshës së lëndës hekur, automjetet kanë edhe lëndë të ndryshme përbërëse si bakër, alumin etj., të cilat kanë çmime të ndryshme) referuar dhe faktit që ka shpenzime shtesë për transportin dhe asgjësimin e tyre duke qenë se janë të palëvizshme.
12	Nga auditimi në lidhje me rregullshmërinë e paraqitjes së paqyrave financiare, u konstatua se, -PF të konsoliduara të viteve 2017/2018 janë përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 552 prot, datë 13.04.2018 për vitin 2017 dhe nr. 730 prot, datë 19.04.2019 brenda afatit zyrtar, por ka parregullsi përsa i përket ekstremiteteve të tyre. Konkretisht për të dy vitet mungon <u>vula e konfirmimit nga dega e thesarit Tiranë</u>. -Pasqyrat financiare, si të aparatit ashtu edhe të konsoliduarat, për vitin 2017 dhe 2018 nuk janë shoqëruar me relacionin përkatës i cili është domosdoshmëri tu bashkangjitet dërgimit të tyre.		MESEM	Nga ana e Zv.Drejtorit Ekonomik, Drejtorit të Përgjithshëm si dhe Drejtorit të Financës të merren masa për të plotësuar mungesën e rregullshmërisë në lidhje me pasqyrat financiare. Pasqyrat e tilla pa ekstremitet e domosdoshme ligjore lënë vend për spekulime si dhe çënojnë sigurinë që marrin përdoruesit e tyre.
13	Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, u konstatua se, për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.		MESEM	Nga ana e INSTAT të merren masa nga Drejtoria e Financës të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.
14	Në rregulloren e brendshme të INSTAT apo edhe të secilës drejtori nuk parashikohet shprehimisht rruga që ndiqet për informimin që përgjegjësit e sektorëve i bëjnë Titullarit me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. - Nuk janë bërë pjesë e planit të trajnimeve temat në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.		MESEM	Të merren masa që të parashikohet qartë raportimi nga poshtë lartë, në rregulloren e brendshme. -Të merren masa që të përfshihen në planin vjetor të trajnimeve tema në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, për të gjithë stafin e INSTAT.
15	Në Institucionin INSTAT rezultoi se, sektori i auditimit është një strukturë jo e plotë me burime		MESEM	INSTAT duhet të marrë masat e menjëhershme për plotësimin e vendeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

njerëzore dhe si rrjedhje numri i auditimeve është ulur, duke mos plotësuar me auditim të gjitha subjektet dhe drejtoritë me risk. Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.			vakante në sektorin e auditimit si dhe të shqyrtohet mundësia e rritjes së numrit të audituesve në INSTAT, me qëllim mbulimin e të gjitha fushave me risk dhe rritjen e frekuencës së angazhimeve të auditimit. Sektori i auditimit të brendshëm, të marrë masa që të rrisë frekuencën e auditimeve të IT dhe auditimeve të performancës në INSTAT. Të merren masa nga menaxhimi i lartë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit të brendshëm.
---	--	--	---

II. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.63/1, datë 21.01.2020, në Institutin e Statistikave, Tiranë, nga data 21.01.2020 - 12.03.2020, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.12.2019, u krye auditimi i Financiar në INSTAT

a) Titulli:

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Financiar në Institutin e Statistikave (INSTAT).

b) Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i adresohet Zëvendëskryetares së Bordit Drejtues të Institutit të Statistikave, Znj. Elsa Dhuli

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

b) Identifikimi i çështjes:

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika cilësore, asnjënjë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpaket t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë e më rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor relativ, të sigurt dhe të krahasueshëm. Me dëshirën për të nxitur përdorimin gjithnjë e më shumë



të statistikave zyrtare në zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit si dhe identifikimin në vazhdimësi të nevojave të përdoruesve, INSTAT përdor të gjitha mjetet tradicionale dhe moderne që ka në dispozicion për shpërndarjen e informacionit statistikor. INSTAT punon në vazhdimësi në drejtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave zyrtare, duke respektuar parimet e cilësisë statistikore të parashikuara në ligjin shqiptar të statistikave, *acquis communautaire* dhe standardet e Kombeve të Bashkuara. Instituti i Statistikave është person juridik i pavarur në varësi të Kuvendit të Shqipërisë i cili siguron që statistikën janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas Programit të Statistikave Zyrtare si dhe jep ndihmën profesionale për interpretimin e drejtë të tyre. INSTAT e ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, si dhe është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare dhe koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. INSTAT përgjigjet për ruajtjen e të dhënave konfidenciale të mbledhura nga njësitë statistikore.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.63/1, datë 21.01.2020.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i Institutit të Statistikave është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomalitë materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumën dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Në rrethanat kur audituesi ka edhe përgjegjësinë për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm, në lidhje me 54 auditimin e pasqyrave financiare, audituesi duhet të mos shkruajë fjalinë, që marrja në konsideratë e kontrollit të brendshëm nga audituesi nuk ka si qëllim shprehjen e një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm; dhe Auditimi gjithashtu, përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi si edhe paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshkrimi i auditimit në raportin e audituesit duhet t'i referohet “përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare të subjektit” ose “përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”, që është e përshtatshme sipas rrethanave. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e marrë

e) Kriteret e vlerësimit:

- Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikën zyrtare";



- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.
- Ligji nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”;
- UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Ligji nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”;
- Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.114/2015 Për “Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

f) Standardet e Auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm

Sistemi statistikor në shtetin shqiptar është themeluar me Vendimin nr. 35, dt. 13/01/1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave. Më vonë kjo drejtori kaloi nën varësinë e Komisionit të Planit të Shtetit.

Sot, në zbatim të ligjit nr.9180, datë 05.02.2004 "Për statistikën zyrtare, ky sistem përbëhet nga një numër institucioneesh të ngarkuar për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucione të tjera, publike ose jo, të cilët nxjerrin statistika të fushave të ndryshme për monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese. Sistemi Kombëtar Statistikor e ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin e lartpërmendur dhe Programin shumëvjeçar të Statistikave i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë. Përgjegjës për zbatimin e Programit dhe monitorimin e Sistemit Statistikor është Instituti i Statistikave (INSTAT) si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare.

Miratimi i Strukturës dhe të organikës së Institutit të Statistikave është miratuar me anë të urdhrit Nr. 28 datë 08.03.2017, të Kryeministrit, ku është përcaktuar numri në total 216 punonjës.

Në datën 29.12.2018 është miratuar struktura e re organike dhe kategorizimi i pozicioneve të punës së Institutit të Statistikave me anë të Vendimit të Kuvendit Nr.127/2018, ku është përcaktuar numri në total 236 punonjës.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është auditimi i pasqyrave financiare të INSTAT për vitin 2017,2018 dhe 2019, auditimi i operacioneve financiare deri me datën 31.12.2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme të situatës financiare të institucionit në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të INSTAT me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.01.2017-31.12.2019

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)¹

Nga **auditimi i pasqyrave financiare**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përse i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Instituti i Statistikave (INSTAT), të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor 2017, deri më 31.12.2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyra e performancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, pasqyrën e amortizimit të aktiveve, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, shpenzimet, banka, janë përfshirë në pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e *opinionit të pakualifikuar*.²

Opinionin është i pakualifikuar

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700³, dhe ISSAI 1200⁴, si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH-së, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Institutit Statistikave në datën 01 Janar 2018 deri me 31.12.2019.

Përqejësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

¹ Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

² ISSAI 1700 - Audituesi do të shprehë një opinion i pakualifikuar kur ai arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

³ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

⁴ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.



Drejtimi i Institutit të Statistikave është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar mbi auditimin. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshkrimi i auditimit në raportin e audituesit duhet t'i referohet "përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare të subjektit" ose "përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë", që është e përshtatshme sipas rrethanave. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e marrë.

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT

1.a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2018 dhe 2019

- Insituti i Statistikave është institucion buxhetor Shtetërorë i është themeluar me Vendimin nr. 35, dt. 13/01/1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave, sot vepron me ligjin nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare". Të gjitha veprimet financiare që kryejnë bëhen direkt me thesarin.

Fondet e çelura nga Ministria, INSTAT i ka detajuar dhe përdorur për të mbuluar shpenzimet për fond page, sigurime shoqërore, për blerje mallra dhe shërbime si dhe për investime.

Viti 2018

Detajimi i buxhetit është bërë në zbatim të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar si dhe në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 19433/42, datë 10.01.2018, për shpenzimet korrente. Gjatë vitit buxheti ka pësuar ndryshime në zbatim të akteve normative, ku në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti INSTAT gjatë vitit 2018.

Shpenzimet korrente (mijë lekë)

Artikulli	Shuma	Komente
600	359.000	Shkresë e MF Nr. 19433/98, datë 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	10.000	Ndryshimi i akt normative nr 1, datë 26.07.2018
	-14.600	Ndryshimi i akt normative nr 2, datë 26.07.2019
	6.593	Ndryshim shkresa nr 19452/1 dt 07.11.2018, shtesë nga 601
	360.993	Buxheti (600) Dhjetor 2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Artikulli	Shuma	Komente
601	67.350	Shkrese e MF Nr. 19433/98, datë 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-3.000	Akti normativ nr. 2 datë 19.12.2018
	-7.693	Ndryshim shkresa nr 19452/1 dt 07.11.2018 shtese te 600+601
	56.657	Buxheti (601) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
602	86.600	Shkrese e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-4.000	Akti normativ nr. 2 datë 19.12.2018
	1.100	Ndryshim shkresa nr 19452/1 dt 07.11.2018 shtese nga 601
	83.700	Buxheti (602) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
604	1.300	Shkrese e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-750	Akti normativ nr. 2 datë 19.12.2018
	550	Buxheti (604) Dhjetor 2018

Artikulli	Shuma	Komente
606	545	Shtesa gjatë vitit
	545	Buxheti (606) Dhjetor 2018

Shpenzimet kapitale (investime te brendshme dhe investime te huaja)

Artikulli	Shuma	Komente
231	52.000	Shkrese e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	40.000	Ndryshimi i akt normative nr 1, datë 26.07.2018
	-4.000	Akti normativ nr. 2 datë 19.12.2018
	88.000	Buxheti (231) Dhjetor 2018

Burimi: Sektori i financës INSTAT

Nga auditimi i zërave të buxhetit u konstatua se ka pasë një fond të ngrirë për pajisje kompjuterike, ku pritej miratimi nga AKSHI, por me datën 01.11.2018, me shkresën nr 1492/1 është bërë transferimi i fondeve të investimit nga fondi i ngrirë tek blerje pajisje kompjuterike për Aparatin Qendror INSTAT në vlerën 2 milion lekë.

Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2018

Në udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, neni 43 parashikon se, NA i njësisë së qeverisjes qendrore i paraqet NPA sa here i kërkohet informacion lidhur me buxhetin, por jo me pak se 3 herë në vit lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program.

Mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 103, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, si dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, si edhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2018, dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të INSTAT, për periudhën Janar - Dhjetor 2018, paraqitet si më poshtë:

Shpenzimet korrente

në mijë lekë

Artikulli	Plan fillestar 2018	Plani me ndryshime	fakt 2018	% realizimit
-----------	---------------------	--------------------	-----------	--------------

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE**

600	359.000	360.993	349.979	97%
601	67.350	56.657	56.533	100%
602	86.600	83.700	81.195	97%
604	1.300	550	523	95%
606		543	515	95%
Totali	514.250	502.443	488.745	97%

Investimet

<i>Artikulli</i>	<i>plan 2018</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 1</i>	<i>Plan ndryshuar akt nr. 2</i>	<i>fakt 2018</i>	<i>% realizimit</i>
231 Financim i brendshëm	32.000	32.000	28.000	27.560	98%
231Financim i huaj	20.000	60.000	60.000	18.707	31%
Totali	52.000	92.000	88.000	46.267	53%

Burimi: Sektori i financës INSTAT

Nga auditimi rezultoi se, totali i shpenzimeve korrente për vitin 2018 janë realizuar në masën 488,745 mijë lekë, nga 502,445.2 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 97% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 13,697 mijë lekë. Mosrealizimi i llogarisë 600 “Paga” ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi i vendeve vakante. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime (llogaria 602) për vitin 2018 janë realizuar në shumën prej 81,195 mijë lekë ose rreth 97 % e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 2,505 mijë lekë, pjesë e mbetur e pashpenzuar, e cila i është kthyer buxhetit të shtetit. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të një procedure prokurimi të planifikuar për tu realizuar në vitin 2018 (nga 8 janë realizuar plotësisht 7 procedura prokurimi).

Nga auditimi rezultoi se, totali i investimeve të vitit 2018 janë realizuar në masën 27,560 mijë lekë, nga 28,000 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 98% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 439.7 mijë lekë. Mosrealizimi 100% i buxhetit të planifikuar ka ardhur si rezultat i blerjes së licencave me një çmim më të vogël se sa ishte parashikuar.

Për sa i përket realizimit të investimeve me financim të huaj në masën 18,707 mijë lekë, nga 60,000 mijë lekë që ishte parashikuar për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 31% të planit të parashikuar. Nga institucioni në raportin e monitorimit nuk janë shprehur në lidhje me arsyet ose faktet që kanë çuar në mosrealizimin e këtij fondi.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore

Ardhura Dytësore	Plan	Fakt	Derdhur në buxhet
Ardhura Dytësore	29.550	41.305	11,755

Viti 2019

Detajimi i buxhetit është bërë në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar dhe në vijim të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1/1, datë 11.04.2019 “Për një ndryshim në Udhëzimin plotësues nr. 1, datë 17.01.2019”. Gjatë vitit buxheti ka pësuar ndryshime në zbatim të akteve normative, ku në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti INSTAT gjatë vitit 2019.

Shpenzimet korrente*Në mijë lekë*

Artikulli	Shuma	Komente
600	379.000	Shkresë e MF Nr. 22760/70, datë 14.01.2019, Çelja e buxhetit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	80.000	Shkresa MFE 6523/1 datë 16.04.2019 Transferim fondi nga 602 te 600
	459.000	Buxheti (600) Dhjetor 2019

Artikulli	Shuma	Komente
601	72.350	Shkresa e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	6.000	Shkresa MFE 6523/1 datë 16.04.2019 Transferim fondi nga 602 te 601
	78.350	Buxheti (601) Dhjetor 2019

Artikulli	Shuma	Komente
602	178.416	Shkresa e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	-86.000	Ndryshimi i akt normative nr 1, datë 26.07.2018
	92.416	Buxheti (602) Dhjetor 2019

Artikulli	Shuma	Komente
604	1.574	Shkresa e MF Nr. 19433/98, date 18.01.2018, Çelja e buxhetit
	1.574	Buxheti (604) Dhjetor 2019

Shpenzimet kapitale (investime te brendshme dhe investime te huaja)

Artikulli	Shuma	Komente
231	26.000	Shkresa e MF Nr. 1895, date 28.12.2018 Çelja e buxhetit
	155.000	Akti normativ nr. 2 datë 02,10,2019
	181.000	Buxheti (231) Dhjetor 2019

Realizimi i planit të buxhetit për vitin 2019

Shpenzimet korrente

Në mijë lekë

Artikulli	Plan fillestar 2019	Plani me ndryshime	fakt 2019	% realizimit
600	379.000	459.000	416.524	91%
601	72.350	78.350	69.320	88%
602	172.416	92.416	80.367	87%
604	1.574	1.574	472	30%
606		600	595	99%
Totali	625.340	631.940	567.278	90%

Investimet

Artikulli	plan 2019	Plan ndryshuar akt nr. 2	Plani final 2019	fakt 2019	% realizimit
231 Financim i brendshëm	26.000	5.000	31.000	28.994	94%
231 financim i huaj		150.000	150.000	164.525	110%
Totali	26.000	155.000	181.000	193.519	107%

Nga auditimi rezultoi se, totali i shpenzimeve korrente për vitin 2019 janë realizuar në masën 567,278 mijë lekë, nga 631,940 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 90% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 64,662 mijë lekë. Mosrealizimi i llogarisë 600 “Paga” ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi i vendeve vakante rreth 30 vende. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime (llogaria 602) për vitin 2019 janë realizuar në shumën prej 80,367 mijë lekë ose rreth 87 % e buxhetit të rishikuar, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 12,049 mijë lekë, pjesë e mbetur e pashpenzuar, e cila i është kthyer buxhetit të shtetit. Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të 5 procedurave të planifikuara për tu realizuar brenda vitit 2019 (nga 71 janë realizuar plotësisht 66 procedura prokurimi). Mungesa e informacionit të detajuar në raportet e monitorimit për 8-mujor, çon në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

planifikimin jo të saktë të fondeve si dhe mosmarrjen e masave korrigjuese që institucioni duhet të marrë deri në përfundim të periudhës buxhetore.

Nga auditimi rezultoi se, totali i investimeve të vitit 2019 janë realizuar në masën 28,994 mijë lekë, nga 31,000 mijë lekë që ishte parashikuar buxheti për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 94% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 2,006 mijë lekë. Mosrealizimi 100% i buxhetit të planifikuar ka ardhur si rezultat i blerjes së licencave me një çmim më të vogël se sa ishte parashikuar. Ndërsa për investimet e tjera nuk është dhënë asnjë informacion shtesë se kush është arsyeja e mosrealizimit.

Për sa i përket realizimit të investimeve me financim të huaj në masën 164,525 mijë lekë, nga 150,000 mijë lekë që ishte parashikuar për këtë vit buxhetor, pra me një realizim prej 110% të planit të parashikuar. Nga institucioni në raportin e monitorimit nuk janë shprehur në lidhje me arsyet ose faktet që kanë çuar në tejkalimin e këtij fondi.

Konkluzione:

- Në raportet e monitorimin mungon relacioni shpjegues në lidhje me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli. Lidhur me masën e ndryshimit të planit të buxhetit në zbatim të akteve normative nga institucioni në raportet e monitorimit mungon informacioni i detajuar se kush nga zërat ka pësuar ndryshime dhe arsyet e ndryshimeve. Mungon një analizë detajuar në lidhje me investimet me financim të huaj. Veprime në kundërshtim me kapitulli IV pika 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,
- Në raportet e monitorimin për 8- mujor mungon informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, Veprime në kundërshtim me kapitulli III pika 42 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,
- Në raportet e monitorimit mungon evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi. Trajtimi i tyre duhet të konsiderohet si prioritar, e cila konsiston në paraqitjen e argumenteve lidhur me krijimin e tyre si dhe masat që parashikohet institucioni të marrë për likuidimin e tyre në të ardhmen. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”
- Në raportet e monitorimi mungon rakordimi me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për shpenzimet buxhetore të realizuara nga institucioni.

Titulli i Gjetjes 1:	<i>Analizë të monitorimit të shpenzimeve buxhetore</i>
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, në raportet e monitorimin mungon relacioni shpjegues në lidhje me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli. Mungon një analizë e detajuar në lidhje me investimet me financim të huaj. Veprime në kundërshtim me kapitulli IV pika 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, - Në raportet e monitorimin për 8- mujor mungon informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar. Veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, - Ne raportet e monitorimit mungon evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 1, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019” - Në raportet e monitorimi mungon rakordimi me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për shpenzimet buxhetore të realizuara nga institucioni.
Kriteri:	Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” dhe Udhëzimi Plotësues të Ministrisë të Financave nr. 1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”
Ndikimi/Efekti:	Mos monitorimi i saktë çon në planifikim jo real të fondeve buxhetore
Shkaku:	Planifikim të dobët të fondeve buxhetore
Rëndësia:	I mesëm

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 1:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi nuk kryejnë

Në lidhje me gjetjen nr.1 dhe rekomandimin 1.1

INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit për buxhetin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, çdo 4,8 dhe 12 muaj për periudhën e auditimit. Këto raporte ju janë dërguar titullarit të INSTAT brenda afateve të përcaktuara me qëllim monitorimin, miratimin e buxhetit dhe dërgimin e tyre në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë. Vlen të theksohet se relacionet shpjeguese kanë qenë pjesë e praktikës, por në të ardhmen do të përmirësohet duke shtuar informacion më të detajuar në lidhje me financimet e huaja dhe për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet.

Gjithashtu ju informojmë se në raportet e monitorimit mungon evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi, pasi INSTAT nuk ka të tilla detyrime veprime këto që janë të reflektuara tek Pasqyrat Financiare, për periudhën e auditimit.

Në lidhje me gjetjen nr.1 dhe rekomandimin 1.2

Drejtoria e Financës dhe Projekteve e INSTAT ne bashkepunim me sektorin e publikimeve në përmbushje të detyrimit në lidhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, ka dërguar informacionin e nevojshëm tek Koordinator për të Drejtën e Informimit brenda afateve të cili është i aksesueshëm nga të gjithë.

Në vijimi po ju dërgojmë linkun

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.1

Sqarojmë se, Në raportet e monitorimin mungon relacioni shpjegues në lidhje me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli. Lidhur me masën e ndryshimit të planit të buxhetit në zbatim të akteve normative nga institucioni në raportet e monitorimit mungon informacioni i detajuar se kush nga zërat ka pësuar ndryshime dhe arsyet e ndryshimeve. Mungon një analizë detajuar në lidhje me investimet me financim të huaj. Veprime në kundërshtim me kapitulli IV pika 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

Në raportet e monitorimin për 8- muaj mungon informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, Veprime në kundërshtim me kapitulli III pika 42 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

Përsa i përket gjetjes 1.2, u konstatua se raportet e monitorimit ishin publikuar në faqen e INSTAT, dhe gjithashtu u vërtetua që nuk kishte detyrime të prapambetura.

Ky observacion merret në konsideratë pjesërisht

2.ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Në bazë të auditimit të kryer në terren në zbatim të pikës 2 të drejtimeve kryesore të programit të auditimit Nr.63/1, datë 21.01.2020, mbi a. respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin; b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Miratimi i Strukturës dhe të organikës së Institutit të Statistikave është miratuar me anë të urdhrit Nr. 28 datë 08.03.2017, të Kryeministrit, ku është përcaktuar numri në total 216 punonjës.

Në datën 29.12.2018 është miratuar struktura e re organike dhe kategorizimi i pozicioneve të punës së Institutit të Statistikave me anë të Vendimit të Kuvendit Nr.127/2018, ku është përcaktuar numri në total 236 punonjës.

Më poshtë pasqyrohet realizimi i buxhetit për llog. 600 dhe 601



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

V.2017	Emertimi Llogarisë	Plani	Fakti	Diferenca	% realizimit	Argumentimi i mosrealizimit
600	Paga (Aparati + rrethet)	313,040,000	309,943,848	3,096,152	99.0	vendet vakante
601	Sigurime	55,205,000	51,242,133	3,962,867	92.8	vendet vakante

V.2018	Emertimi Llogarisë	Plani	Fakti	Diferenca	% realizimit	Argumentimi i mosrealizimit
600	Paga (Aparati + rrethet)	362,553,000	354,226,025	8,326,975	97.7	vendet vakante
601	Sigurime	58,879,000	58,765,709	-113,291	99.8	


V.2019	Emertimi Llogarisë	Plani	Fakti	Diferenca	% realizimit	Argumentimi i mosrealizimit
600	Paga (Aparati)	425,112,000	389,427,067	35,684,933	91.6	vendet vakante
601	Sigurime	72,728,661	65,118,400	-7,610,261	89.5	vendet vakante

Arsyeja e mos realizimit përgjatë të 3 viteve objekt auditimi kanë qenë vendet vakante.

Pasqyrimi i vendeve vakante përgjatë periudhës objekt auditimi:

Vendet Vakante			
	2017	2018	2019
Gjithësej	216	216	236
Vakante	30	23	27
%	14%	11%	11%

Referuar të dhënave reflektuar më poshtë evidentohet se ka një rënie të vogël të numrit të vendeve vakante por jo rënie e rëndësishme.





KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Për sa i përket përputhshmërisë ligjore në lidhje me pagat e punonjësve nga auditimi me për zgjedhje rastësore i listë pagesave u vu re se kategoritë e pagave janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi konkretisht VKM Nr.187 datë 8.03.2017.

Efektet Financiare që buxheti i shtetit ka pësuar nëpërmjet INSTAT, si pasojë e likuidimit të proceseve gjyqësore të humbura, gjatë vitit 2017, vitit 2018 dhe vitit 2019

Viti 2017		Urdhër shpenzimi	Shuma e likujduar
Vendim Gjyqi nr. 4887 datë 18.09.2014	458,100	Nr.237 datë 27.04.2017 Nr.577 datë 08.08.2017	254,500 203,600
Vendim Gjyqi nr. 183 datë 25.01.2013/ V.F.P 07.12.2016 <i>Rovena Domi</i>	450,560	Nr.354 datë 05.06.2020	450,560
Vendim Gjyqi nr.2090 datë 20.04.2015	1,639,272	Nr.645 datë 06.09.2017 Nr.852 datë 17.11.2017 Nr.667 datë 26.09.2017	1,367,910 91,194 180,168
Totali	2,547,932		

Viti 2018		Urdhër shpenzimi	Shuma e likujduar
Vendim Gjyqi nr.2090 datë 20.04.2015	226,000	Nr.24 datë 10.01.2018 Nr.136 datë 12.02.2018	113,000 113,000
Totali	226,000		

Viti 2019		Urdhër shpenzimi	Shuma e likujduar
Vendim Gjyqi nr.3931 datë 02.11.2018	63,024	Nr.13 date 18.01.2019	63,024
Vendim Gjyqi nr.95 datë 24.01.2019	3,480,753	Nr.457 date31.05.2019	3,480,753
Vendim Gjyqi nr.536 datë 21.02.2019	2,535,907	Nr.1121 date 08.10.2019	1,780,977
		Nr.1370 date03.12.2019	374,544
		Nr.1250 date11.11.2019	314,290
		Nr.1431 date 13.12.2019	66,096
Totali	6,079,684		Janë tatim ne burim

Ndërsa këto vendime janë dhënë gjatë periudhës objekt auditimi dhe janë likujduar gjithashtu.

Për periudhën objekt auditimi INSTAT i ka shpenzuar buxhetit të shtetit në total **8,853,616 lekë**, si pasojë e largimit nga puna për shkaqet si më poshtë:

- për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës
- për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës
- shpërblimin për vjetërsi në punë

Rekrutimet:

Gjatë vitit 2017 dhe 2018 INSAT ka vepruar me raportime mujore tek DAP në lidhje me të dhënat e organikës ku ndër të tjera raportohet edhe nr. i vendeve vakante me qëllim publikimin e mundësisë për rekrutime dhe plotësimin e strukturës.



Viti 2019

Me anë të vendimit Nr. 627 Prot., datë 24.04.2018 është miratuar Rregullorja e Rekrutimit të punonjësve që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Në planin vjetor për vitin 2019 është parashikuar se numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në INSTAT, si pjesë e shërbimit civil është 56 i ndarë sipas këtyre kategorive:

- 4 nëpunës civil, të Nivelit të Lartë Drejtues
- 2 nëpunës civil, për kategorinë e mesme drejtues
- 10 nëpunës civil, për kategorinë e ulët drejtues
- 40 nëpunës civil, për kategorinë ekzekutive

Në fund të vitit 2018 numri i vendeve vakante ka qenë 23 por planifikimi i rekrutimeve është bërë për 56 vende vakant pasi pas ristrukturimit, struktura e INSTAT mbart 50 vende vakante dhe 6 persona që do të dilnin në pension, totali i vendeve vakante shkontë në 56.

Me anë të shkresës Nr. 1291/10 Prot., datë 14.12.2018 INSTAT i ka dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për miratim të projektit për strukturën e re, bashkëlidhur së cilës është relacioni arsyetuar mbi ndryshimet kryesisht shtimin e strukturës në dobi të produktit të këtij institucioni, gjithashtu bashkëlidhur është miratimi i DAP dhe i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresës zyrtare Nr. 3547/5 Prot., 27.12.2018 dërgohet nga SP i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ku me vendimin nr. 127/2018 miratohet struktura e re organike me kategorizimet e pozicioneve të punës së INSTAT.

Me anë të shkresës Nr. 1291/13 Prot., datë 28.12.2018 është miratuar urdhri Nr. 37, datë 28.12.2018 me anë të të cilit është ngritur komisioni i ristrukturimit. Ky komison ka vendosur për secilin punonjës pozicionin e punës sipas strukturës së re, është evidente që për shkak se INSTAT është kategorizuar si institucion i pavaruar me anë të Ligjit Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” nga Kuvendi Shqipërisë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, ku INSTAT-i është person juridik publik i pavarur (neni 15), kategoria e pagave të pozicioneve të strukturës është rritur.

Pagat e reja të punonjësve i referohen Vendimit Nr. 187, datë 08.03.2017”, i ndryshuar, lidhja 1/1. Në këto kushte asnjë nga punonjësit nuk është liruar nga detyra dhe asnjërit prej tyre nuk i është ulur paga, si pasojë e ristrukturimit.

Punonjësit me kontratë:

Punonjësit me kontratë luajnë rol mbështetës për zbatimin e të gjitha hallkave që nevojiten për kryerjen e një vrojtimi statistikor, duke përfshirë kryesisht mbledhjen e të dhënave në terren, kontrollin në terren të cilësisë së të dhënave të siguruara nga njësia statistikore, hedhjen e të dhënave të mbledhura në bazën elektronike të të dhënave. Këta punonjës rekrutohen për mbulimin e aktiviteteve statistikore të parashikuara në “Planin Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare” veç punonjësve të organikës së miratuar më urdhër të veçantë të Kryeministrit, INSTAT rekruton punonjës mbështetës. Punonjësit që punosohen me kontratë pune brenda një viti kalendarik, ndahen në këto kategori: a) Specialist të anketimit; b) Kontrollorë anketimi; c) Anketues; ç) Operatorë.

Për vitin **2017** është miratuar udhëzimi i përbashkët midis Ministrisë së Financës dhe Institutit të Statistikave me nr. 70/3, datë 21.02.2017 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë nga INSTAT.

Sipas shkresës zyrtare të titullarit me nr.170 Prot., datë 27.01.2017, totali i punonjësve me kontratë përgjatë vitit 2019 ka qenë 1654, të cilat kanë punuar për periudha kohorë nga 1 muaj deri në 12 muaj.

Për vitin **2018** është miratuar udhëzimi i përbashkët midis Ministrisë së Financës dhe Institutit të Statistikave me nr. 276, datë 28.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave në marrjen e punonjësve me kontratë të përkoshme nga INSTAT.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Sipas shkresës zyrtare të titullarit me nr.565/1Prot., datë 19.04.2018, totali i punonjësve me kontratë përgjatë vitit 2019 ka qenë 1445, të cilat kanë punuar për periudha kohorë nga 1 muaj deri në 12 muaj.

Për vitin **2019** është miratuar udhëzimi i përbashkët midis Ministrisë së Financës dhe Institutit të Statistikave me nr. 639, datë 29.03.2019 “Për përcaktimin e rregullave në marrjen e punonjësve me kontratë të përkoshme nga INSTAT.

Sipas shkresës zyrtare të titullarit me nr.639/2Prot., datë 02.05.2019, totali i punonjësve me kontratë përgjatë vitit 2019 ka qenë 1611, të cilat kanë punuar për periudha kohorë nga 1 muaj deri në 12 muaj.

Për sa i përket përputhshmërisë ligjore në lidhje me pagat e punonjësve me kontratë nga auditimi me përzgjedhje rastësore i listë pagesave u vu re se kategoritë e pagave janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi konkretisht VKM Nr.717 datë 23.06.2009, i ndryshuar.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm:

Me anë të Urdhërit të Brendshëm Nr. 1118 Prot., datë 23.09.2016 është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm në INSTAT, me tre anëtarë, si ekspert të jashtëm në lidhje me legjislacionin, auditimin e brendshëm dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilët në bazë urdhrit nr. 668 Prot., datë 26.04.2017 janë paguar për pjesëmarrjen në mbledhjen në datën 30.01.2017, vetëm 2 prej tyre në vlerën 10,000 lekë secili.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave

Me anë të VKM Nr.671, datë 7.11.2018 është ngritur Komisioni Kombëtar i Nomenklaturës ku është përcaktuar funksionimi dhe detyrat. Krahas këtij vendimi është miratuar edhe rregullorja e për “Funksionimit për Përshtatjen dhe Zbatimin e Nomenklaturave”. Pjesë e këtij Komisioni janë përfaqësues 3 nga INSTAT, 1 përfaqësuese për secilën nga ministritë e linjës, konkretisht MEPJ, MB, MFE, MIE, MASR, MD, MBZHR, MSHMS, MTM, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen dhe Sipërmarrjen dhe nga disa institucione të tjera: Banka e Shqipërisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ISSH, QKB.

Për vitin 2018 janë realizuar 3 takime, në datat 26.04.2018, 03.10.2018, 21.12.2018.

Për secilin takim është mbajtur një dosje ku janë arkivuar listprezenca e pjesëmarrësve nga të gjitha institucionet që janë pjesë e këtij Komisioni. Në bazë të urdhrit Nr.749 Prot., datë 18.05.2018 është përcaktuar pagesa e anëtarëve të këtij komisioni, sipas parashikimit ligjor që ka bërë VKM nr.418, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësisë të qeverisjes qendrore” i ndryshuar. Bashkëlidhur këtij urdhri është edhe lista e pagesave të bëra në llogaritë bankare të anëtarëve dhe shumat përkatëse. Gjithashtu në dosje gjendet urdhërat e brendshëm të secilit institucion ku përcaktohet personi pjesëmarrës, rendi i ditës dhe slidet e temës së prezantuar. Për vitin 2019 janë realizuar 2 takime, në datat 10.05.2019 dhe 12.12.2019.

Titulli i Gjetjes:	Mbi efektin financiar <i>si pasojë e likuidimit të proceseve gjyqësore të humbura</i>
Situata:	Përgjatë periudhës objekt auditimi INSTAT ka paguar në total shumën 8,853,616 lekë si pasojë e humbjes së gjyqeve nga ish punonjës të INSTAT, të cilët janë liruar nga detyra para vitit 2017 dhe gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë në favor të ish punonjësve me kompesim monetar dhe/ose kthim në detyrë.
Kriteri:	8. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës.....Në rastet kur njëra nga palët, Punëdhënësi ose Punëmarrësi kërkon të zgjidhë kontratën e punës para afatit të përcaktuar në pikën 3, atëherë ai duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim duke respektuar afatet e njoftimit të parashikuara në Kodin e Punës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Ndikimi/Efekti:	Vendimet e formës së prerë të gjykatave, duke sjellë si pasojë kosto financiare karshi buxhetit të shtetit.
Shkak:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e lirimit të punonjësve nga detyra; për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës; për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Instituti i Statistikave të marri masa që lirimet nga detyra të kryhen duke respektuar afatin e njoftimit sipas parashikimit në Kodin e Punës në zgjidhjen e kontratës së punës

3.AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE TË APARATIT.

Pasqyrat financiare viti 2017.

Për këtë vit ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Drejtorisë së Financës.

Nga auditimi rezultoi se njësia ka operuar për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore të poshtë cituar:

me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, me planin kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për përgatitjen, paraqitjen dhe në njësitë e qeverisjes së përgjithshme,

Dokumentat justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin. Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc.

b. Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Ministrinë e Financave me shkresën nr.257 prot, datë 19.02.2018, konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2017 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formateve nr.1&2; Pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave (Formatet nr.3/1 & 3/2); Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr.4); Pasqyrën mbi lëvizjen “CASH” (Formati nr.5); Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme si dhe Amortizimin e tyre (Formati nr.6 &7); Pasqyrën e lëvizjes së fondeve (Formati nr.8); Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Pasqyra nr.9) si dhe Relacionin shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme për të dy vitet objekt auditimi:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- Aktivet ekzistojnë fizikisht;
- ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- janë regjistruar në mënyrë korrekte;
- është bërë mire ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivët e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivët e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivët e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivët e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2017 rezultoi:

Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2017, gjendja e këtyre llogarive një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2017-2016), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Grupimi i llogarive të aktivitetit	Ushtrimi për vitin		Pesha		Diferenca
	2017	2016	2017	2016	
Aktive të Qëndrueshme	135,613,620	118,433,382	62%	59%	17,180,238
Aktive Qarkulluese	82,486,216	81,648,169	38%	41%	838,047
Llogari të tjera	-	-	-	-	-
Totali i aktivitetit	218,099,836	200,081,551	100%	100%	18,018,285

Nga auditimi u konstatua se përsa i përket totalit të aktiveve nga viti 2016 në vitin 2017 konstatohet se Aktivët e Qëndrueshme kanë zënë 59% të totalit të Aktivitetit (ose 118 mijë lekë) dhe Aktivët Qarkulluese zinin 41% të totalit (ose rreth 81 mijë lekë). Gjatë vitit 2017 ky raport ka ndryshuar me trend rritës për Aktivët e Qëndrueshme, të cilat kanë zënë 62% të totalit të Aktivitetit (ose rreth 135 mijë lekë); me një shtim prej 17,180,238 lekë krahasuar me një vit më parë. Dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Aktivet Qarkulluese zënë 38% të totalit të aktiveve (ose rreth 82 mijë lekë), konkretisht me një shtim prej 838,047 lekë krahasuar me 2016.

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2017	Pakësime gjatë vitit 2017	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive të trupëzuara					
Ndërtim edhe konstruksione	67,113,938	-	-	67,113,938	0
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	13,105,396	-	916,123	12,189,273	-916,123
Mjete transporti	20,630,352	-	12,217,027	8,413,325	-12,217,027
Inventar Ekonomik	132,129,876	35,129,198	19,740,371	147,518,703	11,409,385
Totali	232,979,562	35,129,198	32,873,521	235,235,239	

Burimi: INSTAT

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Inventarit ekonomik” zë peshën më të madhe prej 62% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “Ndërtime e Konstruksione” e cila zë një peshë prej 29% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” zë peshën prej 5.3% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe ka ardhur në rënie nga viti 2016. Llogaria “Mjete transporti” është llogaria që ka pësuar më tepër rënie nga viti shkuar dhe zë një peshë prej 3.6% të totalit të Aktiveve të Qëndrueshme.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2017, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2017-2016), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2017	2016	Diferenca 2017 – 2016
A	AKTIVE TË QENDRUESHME	135,613,620	118,433,382	17,179,230
21,23,24,28	II. Aktive Të Qendrueshme Të Trupëzuara	130,224,106	114,485,676	15,738,430
212	Ndërtime e Konstruksione	67,113,938	67,113,938	0
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	12,189,273	13,105,396	(916,123)
215	Mjete transporti	8,413,325	20,630,352	(12,217,027)
218	Inventar Ekonomik	143,539,261	132,129,875	11,409,386
219	Amortizim AQT	(101,031,691)	(118,493,885)	(17,462,194)
B	AKTIVE QARKULLUESE	82,486,216	81,648,169	838,047
Klasa 3	Gjendja e Inventarit	23,461,109	26,132,350	(2,671,241)
31	Materiale	21,824,245	23,806,808	(1,981,963)
32	Objekte inventari	1,636,864	2,325,542	(688,678)
Klasa 4	II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët	20,973,121	20,206,239	766,882
4342	Të tjera operacione me shtetin	19,678,087	18,904,215	773,872
468	Debitore te ndryshem	1,295,034	1,302,024	(6,990)
50.59	III.Llogaritë financiare	38,051,986	35,309,580	2,742,406
520	Disponibilitete në thesar	38,051,986	35,309,580	2,742,406



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	TOTALI I AKTIVIT	218,099,836	200,081,551	18,018,285
--	------------------	-------------	-------------	------------

Burimi: INSTAT

Aktive Të Qëndrueshme paraqitet për 135,613,620 lekëKy post është i barabartë me shumën e postit “Aktive të Qëndrueshme të Pa Trupëzuara” plus “Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që kap shumën 130,224,106 lekë, e cila ka dalë si difference midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 101,031,691 lekë.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë e grupit 212,214,215,218,219:

Llogaria 212 “Ndërtim dhe konstruksione” e mbartur e pa ndryshuar nga viti shkuar në vlerën 67,113,938 lekë dhe përfaqëson projektin e rikonstruksionit të ndërtesës prej vitit 2009.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 12,189,273 lekë, pakësuar nga viti shkuar me 916,123 lekë për shkak të nxjerrjes jashtë përdorimit, është i zbërthyer në mënyrë analitike edhe i rakorduar me inventarët e kryer.

++12,217,027 lekë për shkak të nxjerrjes jashtë përdorimit të 4 automjeteve, është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Aktualisht INSTAT ka në posedim 3 automjete si më poshtë vijon:

Në lekë

Dt e hyrjes dhe dalja në përdorim	Emërtimi	Vlera
20.06.2007	HYNDAY-07	2,898,000
03.08.2010	TOYOTA 26-17	2,900,000
01.04.2013	Ford EVEREST 34	2,615,325

Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit të automjeteve ishte kryer në përputhje me udhëzimin 30.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 143,539,261 lekë dhe është shtuar me 11,409,386 lekë, veprim i ardhur si rrjedhojë e dy shtesave nga blerja me pagesë në vlerën 255,840 lekë dhe marrja pa pagesë si më poshtë me vlerë 30,893,916 lekë. Si dhe një pakësim me vlerë 19,740,371 lekë prej nxjerrjes jashtë përdorimit.

Në lekë

Emërtimi	Sasi	Cmim	Vlera
Kompjuter Ëorkstation Sida	20	193,616	3,872,328
Kompjuter Ëorkstation Sida	6	309,611	1,857,665
Kompjuter Destop Sida	200	107,542	21,508,320
Fareëall sida	1	688,500	688,500
Laptop practical 20fv sida	15	128,780	1,931,700
UPS-650VA sida	200	4,181	836,160
UPS-1250VA sida	26	7,663	199,243
			30,893,916

Përpunuar nga grupi i auditimit

Si dhe amortizimi i aktive të qëndrueshme me vlerën 101,031,691 lekë.

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” (Llog. nr. 219) prej 101,031,691 lekë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” për 101,031,691 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të “Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”.

Normat e amortizimit janë përlllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal “Për tatimin mbi të ardhurat” ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

15% për studime dhe kërkime;
1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
3% për inventarin ekonomik;
25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
6% për makineritë e pajisjet operationale, instrumente e vegla; dhe
14% për mjetet e transportit.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë,

Llog. nr. 2192 “Amortizim ndërtime dhe konstruksione” = 5,121,010 lekë.

Llog. nr. 2194 “Amortizim konstruksione” = 3,803,210 lekë.

Llog. nr. 2195 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 5,531,145 lekë,

Llog. nr. 2198 “Amortizim Mjete transporti” = 19,814,763 lekë,

Llog. nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = 66,761,563 lekë.

“Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara” (Llog. nr. 209) prej 1,453,122 lekë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

Në llogarinë 230 “Shpenzime për rritjen e AQTP” është përfshirë vlera e licencave 6,842,636 lekë. Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara nga viti 2017 e jo më parë.

Aktive Qarkulluese paraqiten më vlerën 82,486,216 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Disponibilitete”.

Përbërës të këtij posti janë:

“Gjendja e inventarit” paraqitet në shumën 23,461,109 lekë, duke pësuar një pakësim prej vitit të kaluar 2016 me 2,671,241 lekë. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën përkatëse 3/1 llogaritë debitorë. Në përbërje të kësaj llogarie janë llogaria 31 “materiale” e cila në fund të vitit pasqyrohet me vlerën 21,824,245 lekë, me një pakësim prej 1,982,563 lekë nga viti shkuar, si dhe llogaria 32 “objekte inventari” me vlerën 1,636,864 lekë, e cila përfaqëson gjendjen e inventarit, i cili është pakësuar nga viti kaluar me 688,678 lekë, pakësim i shkaktuar kryesisht nga dalja jashtë përdorimit e objekteve të inventarit në shumën 748,328 lekë dhe shtuar nga blerjet (59,640 lekë). Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është pakësuar 2,671,241 lekë, e barabartë me llogarinë 63 evindentuar në pasqyrën 3/1.

“Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” paraqitet në shumën 20,973,121 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 4342 “të tjera operatione me shtetin” përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2016, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detyrimet ndaj furnitorëve për blerjet e bëra dhe kreditorëve për shërbimet e kryera, të cilat për këtë vit janë 773,872 më shumë se në vitin 2016. I gjithë ky zë është shtuar si rrjedhojë e shtimit kryesisht të detyrimeve për tatim taksa dhe sigurime shoqërore për shkak të vet natyrës së institucionit që merr punonjës me kontratë dhe sezonal.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 1,295,034 lekë pasqyrohet e pakësuar krahasuar me një vit më parë. Diferencë prej 6,990 lekë si e rrjedhojë e arkëtimit të detyrimit të tre punonjësve.

N r	Emri Mbiemri	Gj.01.01.17	Totali	Shenime	Ark. 2017	Ark. 2018	Gj.31.12/18
1	G.K	37,127		Para V.2008			37,127
2	A P	4,660		Para V.2008			4,660



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

3	P A	5,100		Para V.2008			5,100
4	H.B	3,375		Para V.2008			3,375
5	K. B	6,800		Para V.2008			6,800
6	S. P	1,000		Para V.2008			1,000
7	M . M	6,800		Para V.2008			6,800
8	P. B	1,995		Para V.2008			1,995
9	L k	4,660		Para V.2008			4,660
10	L B	4,660		Para V.2008			4,660
11	F B	37,127		Para V.2008			37,127
12	X C	37,127		Para V.2008			37,127
13	A M	1,700		Para V.2008			1,700
14	F P	149,497		Para V.2008			149,497
15	M E	562,947		Para V.2008			562,947
16	B S	42,690		Para V.2008			42,690
17	G T	37,127		Para V.2008			37,127
18	G C	37,127		Para V.2008			37,127
19	I H	3,400	984,919	Para V.2008			3,400
20	I N	72,341		A.Brendshem			72,341
21	A D	9,760		A.Brendshem			9,760
22	F A	6,370		A.Brendshem			6,370
23	I A	2,238		A.Brendshem			2,238
24	P M	2,000		A.Brendshem			2,000
25	S M	2,076		A.Brendshem			2,076
26	A R	4,132		A.Brendshem			4,132
27	A D	3,000		A.Brendshem			3,000
28	S Z	600		A.Brendshem	600		0
29	G H	10,071		A.Brendshem			10,071
30	M P	48,019		A.Brendshem			48,019
31	E Z	4,075	164,682	A.Brendshem			4,075
32	L Sh	20,985		D. Vodafon V.Gjykate			20,985
33	Zh N	25,127		D. Vodafon V.Gjykate			25,127
34	V K	1,581		D. Vodafon V.Gjykate			1,581
35	F N	53,132		D. Vodafon V.Gjykate			53,132
36	K A	10,548		D. Vodafon V.Gjykate			10,548
37	R L	32,330		D. Vodafon V.Gjykate	2,000	8,000	22,330
38	A Y	1,643		D. Vodafon V.Gjykate			1,643
39	M V	2,687		D. Vodafon V.Gjykate			2,687
40	F H	4,390	152,423	D. Vodafon V.Gjykate	4,390		0
	TOTALI	1,302,024.00	1,302,024.00		6,990.00	8,000.00	1,287,034.00

Burimi: INSTAT

Nga auditimi rezultoi se subjekti i ka pjesërisht të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 38,051,986 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë 38,051,986 lekë vlerë e cila është shtuar prej vitit 2016 me 2,742,406 lekë, dhe përfaqëson rritjen e sponsorizimeve që do të trashëgohen në vitin 2018 si dhe rritjen e detyrimeve të shpenzimeve të njohura për vitin 2017 dhe që do të likujdohen në vitin 2018. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF “Procedurat e mbylljes së llogarive”, Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme. Teprica në këtë llogari vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin, ku paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara në shumën 35,080,798 (e ardhur si efekt i sponsorizimeve).

Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 38,051,986 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga sponsorizimet, në pasivin e bilancit është paraqitur në llogarinë nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 35,080,798 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kësaj llogarie.

Vlera e mësipërme prej 38,051,986 lekë e kontabilizuar në llogarinë “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” e denatyrton këtë llogari dhe vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “Detyrimet afat shkurtër” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër specifikisht të analizuar sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe “Llogari të tjera” që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor, kryesisht 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”.

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2017, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2017-2016), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2017	2016	Diferenca 2017 – 2016
A	FONDE TË VETA	159,074,740	144,565,732	14,509,008
101	Fonde bazë	159,074,740	144,565,732	14,509,008
B	DETYRIME	23,944,298	21,488,585	2,455,713
Klasa 4	Detyrime afatshkurtër	23,944,298	21,488,585	2,455,713
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	562,502	3,667,814	(3,105,312)
42	Personeli e llogari të lidhura me to	8,580,960	8,928,470	(347,219)
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	1,989,443	867,029	1,122,414
4341	Të tjera operacione me shtetin	1,295,033	1,302,024	(6,991)
435	Sigurime shoqërore	2,999,743	2,399,470	600,273
436	Sigurime shëndetsore	375,769	316,555	59,214
437.438	Organizma të tjerë shoqëror	482,382	1,923,101	(1,449,719)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	1,382,746	1,382,746	0
467	Kreditorë të ndryshëm	6,275,720	701,667	5,574,053
85	Rezultati i ushtrimit	35,080,798	34,027,234	1,053,564
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	218,099,836	200,081,551	18,018,285

Burimi: INSTAT

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 18,018,285 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 101“Fonde bazë”, është shtuar këtë vit me vlerën 14,509,008 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, ndryshuar nga 23,966,161 lekë një vit më parë, në 26,994,549 lekë, pra janë shtuar këtë vit me shumën prej 3,028,388 lekë, si më poshtë:

Llogaria 401-408” Furnitore e llogari të lidhura me to” është pakësuar këtë vit me 2,243,850 lekë si rrjedhojë e likuidimit të muajt dhjetor duke arrit në vlerën 3,111,420 lekë. (si psh vlera likuidim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

për shtypshkronjën “Albdesign” me vlerë 1,996,308 lekë, për subjektin “Duna” për pjesë ndërimi për printera me vlerë 978,206,29 lekë, shtypshkronjës “Media print” për 489,354 lekë, shtypshkronjën “Media print” për vlerën 709,201 lekë, pjesë këmbimi për kompjutera e servera “pc store” për 1,153,200 lekë e likujtime të tjera me vlera më të vogla).

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve. Nisur nga numri relativisht i lartë u veprua duke zgjedhur për të audituar një pjesë të veprimeve si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzimi nr. 325, dt. 02.06.17 për vlerën 489,354 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 682, dt. 26.09.17 për vlerën 709,201 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 21, dt. 26.01.17 për vlerën 978,206 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 15, dt. 26.01.17 për vlerën 1,996,308 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 288, dt. 10.05.17 për vlerën 1,153,200 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2017 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2017 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, është pakësuar këtë vit me 347,219 lekë si rrjedhojë e punonjësve sezonal për shkak të natyrës së punës së institucionit.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor 2016, edhe është shtuar këtë vit me vlerën 1,122,414 lekë.

Llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin” përfaqëson detyrimet e konstatuara të institucionit ndaj Shtetit për operacione të ndryshme buxhetore që lidhen me të. Në këtë llogari evidentohet edhe pjesa e buxhetit për të ardhurat e konstatuara që në mbyllje të ushtrimit rezultojnë të paarketuara edhe është pakësuar këtë vit me vlerën 6,991 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vitsirjedhojë e punonjësvesezonalpërshkaktë natyrës së punës së institucionit me vlerën 600,273 lekë, duke arritur vlerën prej 2,999,743 lekë.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, është shtuar këtë vit me vlerën 59,214lekë, duke arritur vlerën prej 455,528 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është mbartur e pandryshuar nga viti i shkuar, me vlerën 1,382,746 lekë dhe përfaqëson pjesën e mbetur të sponsorizimeve nga viti 2013, pasi është përdorur sipas kontratave.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është shtuar për 5,574,053lekë, përfaqëson detyrimin e institucionit për shpenzime të konstatuara në muajin dhjetor si energji elektrike, ujë, shërbime postare, telefonike etj të cilat do të likujdohen në vitin 2018 .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 35,080,798 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit të cilat do të trashëgohen në vitin 2018. Kjo tepriçë kreditore përfaqëson rezultatin nga funksionimi që rrjedh nga të ardhurat që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trasheguar në ushtrimet e mëpasme.

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogaritë vjetore të vitit 2017, janë plotësuar si më poshtë:

Formati 3/1 “Shpenzimet e ushtrimit”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2017. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2017 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2016.

1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	Viti 2017	Viti 2016
2	60	I. ShpenzimeKorrente	433,062,777	323,917,906
3	600	Paga,shperblime e tetjrapersoneli	280,903,515	214,034,714
4	6001	Paga, personeli i perhershëm	125,758,089	108,790,596
5	6002	Paga, personel i perkohshëm	155,145,426	110,244,118
8	601	Kontrib.tesig.shoq.eshendets.	46,376,514	36,464,309
9	6010	Kontribute per sigurimetshoqerore	41,654,196	32,577,104
10	6011	Kontribute per sigurimetshendetesore	4,722,318	3,887,205
11	602	Mallradhesherbimetetjera	102,235,507	67,363,293
12	6020	Materialezyre e tepergjitheshme	8,124,833	7,874,504
13	6021	Materialedhesherbimespeciale	4,915,264	5,975,093
14	6022	Sherbimengatetrete	72,023,500	36,715,233
15	6023	Shpenzimtransporti	895,906	3,507,022
16	6024	Shpenzimeudhetimi	6,987,717	4,144,103
17	6025	Shpenzime per mirembajtjetezakonshme	4,178,721	1,502,093
18	6026	Shpenzime per qeramarrje	2,196,176	6,135,585
19	6027	Shpenzime per detyrime per kompesimelegale	2,547,932	1,397,373
21	6029	Shpenzimetetjera operative	365,458	112,287
22	603	Subvencionet	0	0
28	604	Transferimekorrentetebrendshme	198,000	360,000
38	606	Transferta per buxh.familjare e individe	678,000	603,300
41	63	II. Ndryshimi I gjendjeveinventarit (+ -)	2,671,241	16,092,290
42	68	III. Kuotaamortizimidheshumateparashikuara	0	0

Burimi: INSTAT

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën 433,062,777 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzime personeli” për 280,903,515 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 46,376,514 lekë, llogaria 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për 102,235,507 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 8,124,833 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 4,915,264 lekë paraqet shumën e shpenzimeve specifike të Institucionit.
- 6022 Shërbime për shumën 72,023,500 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje me roje civile.
- 6023 Shërbime transporti për shumën 895,906 lekë përfaqësojnë shpenzime për shërbimet e automjeteve të institucionit si naftë, vaj , pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 6,987,717 lekë përfaqësojnë përfaqësojnë shpenzimet që institucioni kryen për pagesën e dietave të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 4,178,721 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre dhe kryesisht mirëmbajtja e faqes së internetit, e rrjetit kompjuterik, riparimet e automjeteve të INSTAT
- 6026 Shpenzime për qeramarrje për shumën 2,196,176 lekë.
- 6027 Shpenzime për detyrime për kompensime legale për shumën 2,547,932 lekë përfaqësojnë shpenzimet që institucioni kryen për ekzekutimet vendimeve gjyqësore

Në lekë

Ekzekutim Vendime Gjyqi	Shpenzime
C.M	254,500
A.G	450,560
C.M	203,600
V.M	1,367,910
D.M	91,194
V.M	180,168
Total	2,547,932

Burimi: INSTAT

- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 365,458 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor por që janë të nevojshme të kryhen gjatë periudhës buxhetore.

Llogaria 604 "Transferime korrente të brendshme" për shumën 198,000 lekë dhe janë përfshirë pagesa të kryera për anëtarët e Këshillit të statistikave, Komitetit të Auditit të Brendshëm dhe K.Nomeklaturës.

Llogaria 606 "Transferta tek buxhetet familjare" për shumën 678,000 lekë përfaqëson mbështetje për raste fatkeqësish, sëmundjesh apo dalje në pension ku për këtë vit ka patur një total prej 14 rastesh të tilla, detajuar si më poshtë vijon:

Nr	Specifikimi	Vlera	Shkresa
1	Raste fatkeqësish	30,000	nr.1548, dt 22.12.16
2		30,000	nr.66, dt 13.01.17
3		30,000	nr.117, dt 23.01.17
4		30,000	nr.312, dt 24.02.17
5		30,000	nr.388, dt 13.03.17
6		30,000	nr.1578, dt 14.12.17
7		30,000	nr.1114, dt 15.09.17
8	Rast vdekje	80,000	nr 1215 dt 15.09.2017
9	Rast sëmundje	50,000	nr 904 dt 12.06.17
10		50,000	nr 1124 dt 17.08.2017
11	Dalje në pension	66,800	nr 880/1 dt 13.06.2017
12		50,700	nr 951/1 dt 24.08.2017
13		69,000	nr 1037/2 dt 18.09.2017
14		101,500	nr 1031/2 dt 14.08.2017
Total		678,000	

Burimi: INSTAT

Gjithashtu pjesë e pasqyrës 3/1 "shpenzime të ushtrimit" janë edhe llogaritë: Llogaria 8420 "derdhje të ardhura në buxhet" me vlerë 16,415,713 lekë dhe që përfaqëson atë pjesë të të ardhurave që sipas dispozitave ligjore arkëtohet në institucion por shuma i përket buxhetit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

shtetit. Per kete, krahas kontabilizimit te arketimit te te ardhurave, per te mos ndikuar ne rezultat, institucioni ben veprimin kontabel ne debi te llogarise se mesiperme me kunderparti kreditin e llogarise 4341 "Te tjera operacione me shtetin kreditor".

Llogaria 8421 "derdhje në buxhet e të ardhurave të papërdorura" përfshihen derdhje e tepricave të shpenzimeve operative.

Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën 2,671,241 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes se inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 85 "Rezultate nga funksionimi" me vlerë 35,080,798 lekë pëfaqëson diferencën pozitive midis totalit të operacioneve të njësisë me totalin shpenzimeve, në përputje me Udhëzimin 14 datë 28.12.2016 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 "Saldo kreditor" e pasivit të pasqyrave financiare.

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, "Shpenzimet korrente" sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 430,391,536 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 448,520,652 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 "Procesimi i transaksioneve në fund të vitit" dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.20112 "Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" "Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike" "Rakordimi mujor i shpenzimeve":

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitet e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave" dhe UMF nr. 8, dt. 13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017",.

UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014" pika 34 "Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitet e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit ne ë degë në zbatim të manualeve përkatës".

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Nr. llog.		Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
	SHPENZIMET E USHTRIMIT			
60	I. Shpenzime Korrente	430,391,536	448,520,652	- 18,129,116
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	280,903,515	282,460,498	-5,556,983
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	46,376,514	46,930,154	-553,640
602	Mallra dhe shërbime te tjera	102,235,507	99,333,712	+2,901,795
604	Transferta korente të brendshme	198,000	215,300	-17,300
606	Transferta për buxh. familjare e individë	678,000	678,000	0

Burimi përpunuar nga grupi i auditimit

Formati 3/2 "Të ardhurat e ushtrimit",

Kjo pasqyrë paraqitet në shumën 482,312,634 lekë dhe është e rakorduar me pasqyrën nr.3/1 "Shpenzime të shfrytëzimit" "Llogaritë Debitore".

Të ardhurat e INSTAT janë të karakterit "Të ardhura jo Tatimore" dhe kapin shumën 46,345,713 lekë dhe rakordon me vlerën e paraqitur në akt rakordim me thesarin. Këto të ardhura



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

përfaqësohen nga llogaria 7111 “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” me vlerë prej 46,345,713 lekë si dhe nga llogaria 72 “Grante Korrente” që paraqitet me shumën 435,966,921 lekë që përfshijnë llogarinë 720 “Grant korrent i brendshëm” për vlerën 380,546,294 lekë të përbërë nga llogaria 7200 “Grant korrent i brendshëm nga i njëjti nivel qeverisje” për vlerën 360,868,207 lekë, shtuar nga viti kaluar me 77,205,331 lekë si rrjedhojë e shtimit të fondeve buxhetore dhe sipas argumentimit nga ana e institucionit përfaqëson shpenzimet korrente të korektuara pasi janë zbritur detyrimet për vitin e ardhshëm dhe pjesa e sponsorizimit. Si dhe llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” me vlerën 19,678,087 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për tu paguar në vitin e ardhshëm dhe është pakësuar nga viti i shtuar me 773,872 lekë si rrjedhojë e arkëtimit të një pjesë të detyrimeve. Kjo llogari pasqyron si kundërparti ato lloj shpenzimesh të konstatuara nga institucioni në vitin ushtrimor që përballohen me fondet e buxhetit të vitit të mëpasshem (pagat, sigurimet shoqërore, shëndetsore dhe tatimet e muajit Dhjetor). Mbi bazën e këtij informacioni në fund të periudhës ushtrimore Institucioni ka kryer veprimin kontabël mes llogarive 4342 “Marrdhënie me shtetin debitor” dhe 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Nga auditimi konstatohet se kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të 2017.

Formati nr.4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet”. Përsa i përket formatit të kësaj pasqyre për INSTAT konstatohet se ajo përfaqëson burimet për investime të kryera gjatë vitit 2017 dhe janë realizuar nga granti i brendshëm kapital nga i njëjti nivel qeverisje. Sa më sipër përfaqëson investimet me fonde buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave si dhe dhurimet nga Donatorët. Zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 1,854,600 lekë në analizë rakordon me vlerën prej 1,854,600 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6. Zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 1,854,600 lekë në analizë rakordon me vlerën prej 1,854,600 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6.

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica Në çelje	Transaksionet e vitit		Teprica në Fund
				Debi	Kredi	
A		B	c	D	e	F
	II	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	18,902,988	18,902,988	0
34	230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara		18,902,988	18,902,988	0
35	231	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara	0	18,902,988	18,902,988	0
36	2310	Toka, troje e terrene				0
37	2311	Pyje, kullota, plantacione				0
38	2312	Ndërtime e konstruksione				0
39	2313	Rruge, rrjete dhe vepra ujore		14,667,707	14,667,707	0
40	2314	Instalime teknike, pajisje, instrum dhe vegla pune				0
41	2315	Mjete te transportit				0
42	2316	Rezerva shtetërore				0
43	2317	Kafshe pune e prodhimi				0
44	2318	Inventar ekonomik		4,235,281	4,235,281	0
45	232	Transferimet kapitale				0
46	25	Huadhënie dhe nën huadhënie	0			0
47	255	Të dala për huadhënie dhe nenhuadh të brendsh				0
48	256	Të dala për transaksionet e huadhenies se huaj				0
49	250	Të hyra nga principali i huadhënieve te brendshme				0
50	251	Të hyra nga principali i transaks. të huadhe së huaj				0
51	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0			0
52	265	Të dala për kapitale te veta ne nd. publike jofitimp				0
53	266	Të dala për kapitale te veta ne instituc financiare				0
54	267	Të dala për kapitale te veta ne jointventure				0
55	269	Të dala për kapitale te veta te tjera				0

Burimi: INSTAT

Vlera e mësipërme në pasqyrat financiare formati 4/e është paraqitur e gjithë vlera për, “Inventar ekonomik” për 4,235,281 lekë kur edhe në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” në formatin 6, kolona e dytë shuma është e ndarë sipas zërave të investimeve në vlerat e mësipërme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Formati nr.5 “Pasqyra e lëvizjes “Cash” për vitin 2017”, është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të regjistruar fondet buxhetore korrente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korrente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadruara nga dega e thesarit. Nga auditimi konstatohet se, “Teprica ne mbyllje” rakordon me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.

Formati nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlера bruto) 2017”, është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Në zërin shtesa janë përfshirë dy shuma për blerje të realizuara gjatë vitit për 4,235,282 lekë dhe një për shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit për 30,893,916 lekë. Si dhe janë katër shuma të tjera për nxjerrje jashtë përdorimit.

Formati nr.7 “Pasqyra e amortizimit vjetor”, pasqyra është plotësuar konform kërkesave të VKM nr.401 të vitit 1989 dhe shumat e kësaj pasqyre kanë korrespondencë me shumat e sistemuara në pasiv të bilancit.

Formati 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në çelje dhe përfundim të ushtrimit të vitit 2017 ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime duhet të rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim është kryer konform kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël.

Nga një analizë e kryer mbi rakordimin e këtyre dy formateve shprehemi si më poshtë vijon:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	A	FONDE TE VETA	159,074,740	144,565,732
2	10	I. Fonde të veta	159,074,740	144,565,732
3	101	Fonde bazë	159,074,740	144,565,732
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend. të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Burimi: INSTAT

Përsa i përket formatit nr.8 tepricat në çelje dhe në mbyllje të llogarive respektive të fondeve duhet detyrimisht të jenë të rakorduara me të dhënat e këtyre llogarive të pasqyruara në grupin A të pasivit të bilancit kontabël.

Formati nr.9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Formati nr.12 “Pyetësor dhe shënime shpjeguese”, u konstatua se në Pasqyrat Financiare të Aparatit mungonte prania e këtij formati.

Mbyllja e bilancit për vitin 2017 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse.

Veprimet për vitin 2017 janë axhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2017:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 218,099,836 lekë në vitin 2017 dhe 200,081,551 lekë për vitin 2016;
U audituan të dhënat mbi vlerat bruto të aktiveve, sa pasqyruar në aktiv të bilancit (formati nr. 1) dhe gjendjen e ndryshimit të AQT në vlerën bruto, (formati nr.6), sipas periudhave dhe konstatim se ka mospërputhje materiale mes dy formateve.

	AQT (kolona nr.9 + amortizimi i akumuluar nga llog 209 dhe 219, kolona nr. 7 dhe19). -sipas Formularit nr.1 të Pasqyrave Financiare Vjetore-	Gjendja në fund të vitit e AQT, për vlerën e tyre bruto -sipas Formularit nr. 6 të Pasqyrave Financiare Vjetore -
Viti 2016	114,485,676 + 0 + 118,493,885	
	Sipas bilancit 31.12.2016= 232,979,561	Çelja me 1.1.2016 = 232,979,562
Viti 2017	130,224,106 + (1,453,122) + 101,031,691	
	Sipas bilancit 31.12.2017= 229,802,675	Gjendja 31.12.2017 sipas F6: 235,235,239

Burimi: përpunuar nga grupi i auditimit

Auditimi në aktivin dhe pasivin e bilancit për këto formate dhe llogari:

- Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 484,983,875 lekë;
- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 2,671,241 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e inventarit” (kolona nr. 28) në aktivin e bilancit. Pra, (26,132,350-23,461,109) dhe janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 2,671,241 lekë.
- Llogaria 841 “Transferimi i ndryshimit të gjendjes” në **Formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit”**, duhet të jetë e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në të njëjtën pasqyrë, me shenjë të kundërt. Konkretisht, në Formatin nr. 3/1 llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” evidentohet për -2,671,241 lekë, (kolona nr. 41), ndërkohë llogaria nr. 8423 “Transferim për ndryshim gjendje” evidentohet me vlerën 0 lekë. (kolona nr.67).

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 3/2** me Formatin nr. 3/1, si:
Formati nr. 3/2 është i barabartë me Formatin nr. 3/1 nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 484,983,875 lekë në vitin 2017 dhe 389,951,253 lekë për vitin 2015.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 4 “Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet”**:
llogaria 231 “Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara” në zërin ndërtesa (kolona nr. 35, në Formatin nr. 4) janë 0.00 lekë më 31 dhjetor 2017 dhe nga shqyrtimi i të dhënave të pasqyruara mbi gjendjen e nënllogarise për shtesat gjatë vitit (në formatin nr.6, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme me vlerën bruto”, kolona nr.10), këto shtesa janë të barabarta me shumën e mësipërme.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 5, “Pasqyra e lëvizjes (CASH)”** :
Rubrika “Teprica në mbyllje të ushtrimit” tek Formatin nr. 5/ kolona 26, e pasqyrës së lëvizjes së CASH-it është e njëjtë me tepricën e llogarisë 520, kolona 26 e aktivit të bilancit, “Disponibilitete në thesar”, në kolonën nr. 58, llogaritë financiare, në aktiv të bilancit kontabël, barazi me 38,051,986 lekë.
- Auditimi i llogaritjes së amortizimit: “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” (llog. nr. 219) është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9. “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” për -306,063 mijë lekë. Kjo vlerë përfaqson amortizimin e akumuluar, nga e cila 24,389 mijë është shtesa vjetore e amortizimit të ushtrimit. Amortizimi është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përfutur me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 “Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual “Për tatimin mbi të ardhurat” ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur.

Bazuar në Kreun II, të UMF nr. 14, datë 18.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe njësitë e menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, u kryen disa testime të artikujve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, mbi aplikimin e rregullt të amortizimit vjetor. Nga testimi i kryer, nga grupi i auditimit rezulton se shumatat e llogaritura janë referuar sipas normave të miratuara.

Përsa i përket regjistrit të aktiveve, në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pasi regjistri është prezent në form elektronike, në përputhje me pikën 30 të udhëzimit i hartuar në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Mirëpo, ky regjistër duhet të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, ku kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Titulli i Gjetjes 7:	<i>Analizë e regjistrit të aktiveve</i>
Situata:	Nga auditimi i regjistrit të aktiveve, u konstatua se në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pasi regjistri është prezent në form elektronike, në përputhje me pikën 30 të udhëzimit i hartuar në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit por pa specifikimet e tjera sikundër kërkon Udhëzimi i sipërcituar. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.29 të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Regjistri i aktiveve jo i plotë në përputhje në përputhje me kërkesat që duhet të sipas UMF 30
Shkaku:	Neglizhenc gjatë plotësimit të tij
Rëndësia:	E mesme

Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 6**, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlera bruto) 2017”, është plotësuar sipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit. Nga auditimi konstatohet se, gjendjet në çelje dhe në mbyllje të ushtrimit për çdo kategori të aktiveve të qëndrueshme janë të barabarta me të dhënat e evidentuara për to në postet e aktiveve të qëndrueshme në aktiv të bilancit kontabël.

Në zërin shtesa janë përfshirë dy shuma për blerje të realizuara gjatë vitit për 4,235,282 lekë dhe një për shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit për 30,893,916 lekë. Si dhe janë katër shuma të tjera për nxjerrje jashtë përdorimit. Gjatë këtij viti INSTAT bazuar në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe në Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave ka ngrit komisionet për vlerësimin aktiveve Mbështetur mbi këta urdhëra vlere e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në fund të vitit 2017 rezulton të jetë 32,499,145 lekë.

Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të njësisë, shprehemi gjerësisht në pikën : Të tjera nga pasqyrat financiare, Inventarizimi , nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi.

Sa më sipër, u konstatuan parregullsi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 7**, “Pasqyra e amortizimit vjetor”, është plotësuar konform kërkesave të VKM nr.401 të vitit 1989 dhe shumat e kësaj pasqyre kanë korrespondencë me shumat e sistemuara në pasiv të bilancit.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 8** “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në çelje dhe përfundim të ushtrimit të vitit 2017 ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime duhet të rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim është kryer konform kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël.

Nga një analizë e kryer mbi rakordimin e këtyre dy formateve shprehemi si më poshtë vijon:

Formati nr.2

në lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	A	FONDE TE VETA	159,074,740	144,565,732
2	10	I. Fonde të veta	159,074,740	144,565,732
3	101	Fonde bazë	159,074,740	144,565,732
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend. të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Burimi: INSTAT

Formati nr.8

Në lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Teprica në mbyllje	Teprica në celje
1	A	FONDE TE VETA	159,074,740	144,565,732
2	10	I. Fonde të veta	159,074,740	144,565,732
3	101	Fonde bazë	159,074,740	144,565,732
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend. të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Burimi: INSTAT

Përsa i përket formatit nr.8 tepricat në celje dhe në mbyllje të llogarive respektive të fondeve duhet detyrimisht të jenë të rakorduara me të dhënat e këtyre llogarive të pasqyruara në grupin A të pasivit të bilancit kontabël.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr. 9** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, për numrin e punonjësve dhe fondin e pagave janë të pasqyruara të gjitha lëvizjet në lidhje me rekrutimin e punonjësve si dhe fondi i pagave, shpërblime të tjera dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të cilat janë të barabarta me pasqyrën 3/1 me zërin paga e shpërblime të tjera personeli (për 280,903,515 lekë), me kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Janë evidentuar 147 punonjës në pasqyrën nr. 9, sipas strukturës organike të miratuar nga Urdhër i Kryeministrit nr.28 datë 08.03.2017. Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në Pasqyrën nr.3/1 Shpenzime të Shfrytëzimit, përjashton kollonën 8 të saj e cila ka 27.9% për Sigurimet Shoqërore.

Sa më sipër, nuk u konstatua ndonjë parregullsi apo mospërputhje.

- Auditimi i barazimeve të **Formatit nr.12** “Pyetësor dhe shënime shpjeguese”, u konstatua se në Pasqyrat Financiare të Aparatit mungonte prania e këtij formati.

Në kushtet se ky format përmban rregullat që lidhen me përgjigjet për hartimin e një llogarie sa më të saktë si dhe mundësitë për të relatuar problemet e tjera që kanë dal nga pregatitja e llogarive vjetore të vitit, (si për metodat e përdorura nga institucioni për vlerësimin dhe paraqitjen në bilanc të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese, detyrimet dhe të drejtat afatgjatë dhe afatshkurtër të institucionit, etj., gjykojmë se mungesa e këtij formati cënon sigurinë që merret nga këto pasqyra si dhe vështirëson leximin e tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Sa më sipër, u konstatua parregullsi.

Nga ana e institucionit janë mbajtur aktet e rakordimit për shpenzimet dhe të ardhurat e kryera gjatë vitit 2017,

Mbi shpenzimet:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas bilancit paraqiten në vlerën 430,391,536 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 448,520,652 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.20112 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 8, dt. 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”,.

UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	430,391,536	448,520,652	-18,129,116
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	280,903,515	282,460,498	-5,556,983
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	46,376,514	46,930,154	-553,640
602	Mallra dhe shërbime te tjera	102,235,507	99,333,712	+2,901,795
604	Transferta korente të brendshme	198,000	215,300	-17,300
606	Transferta për buxh. familjare e individë	678,000	678,000	0

Burimi:përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.

Në lekë

Art	Plan vjetor	Shpenzime thesari
231	2,000,000	
	4,744,160	3,979,441
	255,840	255,840
2319999	20,000,000	14,667,707
231	1,781,000	
Total	28,781,000	18,902,988

Burimi:INSTAT



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Pasqyrimi i krahasimit mes dy formateve, pasqyrave financiare dhe situacionit të shpenzimeve:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	2017	
		Pasqyrat financiare	Situacion i shpenzimeve
231	Shpenzime në proces për rritjen e AQT		18,902,988

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

Mbi të ardhurat:

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2017, nënshkruar nga specialistja e financës znj. L. B dhe specialistja e Degës së Thesarit znj. Sh .C. Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë për 67,739,115.95 lekë, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2017 , nga e cila janë derdhur në buxhet 16,176,719 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin 2018 prej 0.00 lekë.

Në lekë

Kod Institucion i	Klasifikim i Buxhetor	Përshkrimi	Shuma e arkëtuar	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1050001	7113099	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	46,345,713.00	41,711,141.70	30,168,994.00	16,176,719.00	0.00
1050001	7211100	Grant nga org ndërkombëtare	21,393,402.95	21,393,402.95	21,393,402.95		
		Totali	67,739,115.95	63,104,544.65	51,562,396.95	16,176,719.00	0.00

Burimi: INSTAT, Sektori i Financës.

Konstatohet se, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 3/2 të Bilancit “Të ardhurat e ushtrimit 2017”, me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezulton se ka mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik. Më konkretisht:

Klasifikimi Buxhetor	Përshkrimi i të ardhurave	Sipas formatit nr. 3/2 të bilancit vjetor	Sipas të dhënave të akt rakordimit vjetor me degën e thesarit
71	Te ardhura jo tatimore	46,345,713	27,240,114
7200105	Grant nga i njëjti nivel qeverisjeje	360,868,207	0.00
7207011	Grant nga org ndërkombëtare	55,420,627	21,393,402.95

Burimi: përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se në bilancin kontabël (Formati 3/2), në llogarinë ekonomike 720 “Grant korrent i brendshëm” është vënë shuma 380,546,294 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “Grant nga organizma ndërkombëtare” pasqyrohet me vlerën 55,420,627 lekë në PASH ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 21,393,403 lekë. Ky veprim i regjistrimit të këtyre dy zërave si sponsorizime në pasqyrat e bilancit është e gabuar. Sa sipër, sjellim në vëmendje se:

Në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,

“Grant” është e ardhura, e përftuar në formën e dhurimit, për një qëllim të përcaktuar ose jo, pa kusht kthimi dhe pa interes, që përdoret për financimin e veprimtarive ekonomike.”

Nga ana tjetër, në pikën nr.1 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligjin Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007, përcaktohet që:

“Ky ligj rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim “sponsorizime”, të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit.” dhe sipas nenit 3, sponsorizues në kuptim të këtij ligji “janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët. Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Sikundër jemi shprehur më lartë, nga analiza e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, rezulton se me 31.12.2017 ajo ka të regjistruar në debi vlerën 38,051,986 lekë, e pasqyruar kjo në llogarinë 85 “Rezultat i ushtrimit” në vlerën 35,080,798 lekë dhe një diferencë prej 2,971,188 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kësaj llogarie. Pasqyrimi i këtyre fondeve në këtë llogari për 35,080,798lekë e denatyon kuptimin e kësaj llogarie dhe nga sektori financiar si kundërparti duhet të ishin llogaritë e klasës së 4-rt, kjo bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar, që përcakton detyrimin e rakordimit të debisë së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, (ku janë të kontabilizuar të gjitha autorizimet buxhetore si dhe shtesat apo paksimet e bëra gjatë vitit), me kundër parti llogarinë 476 “të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

INSTAT nuk ka arritur ti shfrytëzoj të gjitha mjetet nga grantet dhe subvencioni, përkatësisht për 35,080,798 lekë. Gjykojmë të nevojshme rikonsiderimin dhe përdorimin e këtyre shumave. Konkluzioni është se nuk është arritur të realizohen objektivat lidhur me përdorimin e disa fondeve, pavarësisht faktit se kishte mjete në dispozicion për qëllime të caktuara.

Pasqyrat financiare viti 2018.

Edhe për këtë vit ky institucion, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka të organizuar brenda Drejtorisë së Financës.

Regullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore.

Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Ministrinë e Financave me shkresën nr.390 prot, datë 26.02.2019, konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2017 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formatit nr.1; Pasqyrën e performancës financiare sipas formatit nr.2; Pasqyrën e flukseve monetare sipas formatit nr.3; Pasqyrën e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Netosipas formatit nr.4; Pyetësorin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.5 dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën e Investimeve dhe Burimet e financimit sipas formatit nr.6, Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Afatgjata(Kosto Historike) sipas formatit nr.7/a Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata(Vlerë Neto) sipas formatit 7/b; si dhe Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.8

Munqon relacionin shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

Titulli i Gjetjes 12:	<i>Analizë mbi rregullshmërinë e paraqitjes së paqyrave financiare</i>
Situata:	Pasqyrat financiare, si të aparatit ashtu edhe të konsoliduarat, për vitin 2017 dhe 2018 nuk janë shoqëruar me relacionin përkatës i cili është domosdoshmëri të bashkangjitet dërgimit të tyre.
Kriteri:	<i>Udhëzimi nr. 39, datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018”</i>
Ndikimi/Efekti:	Përveçse kërkesë ligjore është domosdoshmëri për shpjegimin e plotësimit të pasqyrave financiare.
Shkaku:	Mos pasqyrim i plotë i situatës së njësisë
Rëndësia:	E lartë

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 12 sqaroj se :

Pasqyrat financiare të konsoliduara nuk vulosen nga Dega e Thesarit Tiranë pasi ato janë përmbledhese të pasqyrave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

financiare individuale të 11 Zyrrave Rajonale Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë dhe Aparatit Qëndror INSTAT të vulosura nga Degët e juridiksionit që i përkasin.

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.12

Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara duhet të kryhet në përputhje me pikën 102 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave numër 8, datë 09.03.2018.

Ky observacion merret pjesërisht në konsideratë

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2018 rezultoi:

Analiza e pozicioneve të llogarive në pasqyrat financiare.

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2018, gjendja e këtyre llogarive një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2018-2017), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Grupimi i llogarive të aktivitetit	Ushtrimi për vitin		Pesha		Diferenca
	2018	2017	2018	2017	
Aktive të Qëndrueshme	241,698,376	135,613,620	70%	62%	106,084,756
Aktive Qarkulluese	104,467,139	82,486,216	30%	38%	21,980,923
Llogari të tjera	-	-	-	-	-
Totali i aktivitetit	346,165,515	218,099,836	100%	100%	128,065,679

Nga auditimi u konstatua se përsa i përket totalit të aktiveve nga viti 2017 në vitin 2018 konstatohet se Aktivitetet e Qëndrueshme kanë zënë 62% të totalit të Aktivitetit (ose 135 mijëlekë) dhe Aktivitetet Qarkulluese zinin 38% të totalit (ose rreth 82 mijë lekë). Gjatë vitit 2018 ky raport ka ndryshuar me trend rritës për Aktivitetet e Qëndrueshme, të cilat kanë zënë 70% të totalit të Aktivitetit (ose rreth 242 mijë lekë); me një shtim prej 104,084,756 lekë krahasuar me një vit më parë. Dhe Aktivitetet Qarkulluese zënë 30% të totalit të aktiveve (ose rreth 104 mijë lekë), konkretisht me një shtim prej 21,980,923 lekë krahasuar me 2017.

Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2018	Pakësime gjatë vitit 2018	Gjendja në mbyllje	Ndryshimi
Aktive të trupëzuara					
Ndërtim edhe konstruksione	67,113,938	108,421,078	-	175,535,016	+108,421,078
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	12,189,273	22,496,392	2,179,543	32,506,122	+20,316,849
Mjete transporti	8,413,325	-	-	8,413,325	0
Inventar Ekonomik	143,539,261	40,757,742	13,305,743	170,991,260	27,451,999
Totali	231,255,797	171,675,212	15,485,286	387,445,723	

Burimi: INSTAT

Nga auditimi në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “Ndërtime e Konstruksione” zë peshën më të madhe prej 45% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “Inventarit ekonomik” e cila zë një peshë prej 44% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara, llogaria “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” zë peshën prej 8.4% ndaj totalit të Aktiveve të Qendrueshme të Trupëzuara, llogaria “Mjete transporti” është llogaria që është mbartur e pandryshueshme nga viti 2017 dhe zë një peshë prej 2.2% të totalit të Aktiveve të Qendrueshme.

Të gjitha llogaritë e tjera nga viti i paraardhës në vitin 2018 kanë pësuar rritje.

Gjendja e llogarive aktive në fund të vitit 2018, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2018-2017), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivitetit	2018	2017	Diferenca 2017 – 2016
A	AKTIVE	241,698,376	135,613,620	106,084,756
21,23,24,28	Aktive Afatshkurtra	104,467,139	82,486,216	21,980,923
	1.Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	60,480,888	38,051,986	22,428,902
520	Disponibilitete në thesar	60,480,888	38,051,986	22,428,902
	2.Gjendja e Inventarit Qarkullues		23,461,109	(23,461,109)
31	Materiale	21,776,754	21,824,245	(47,491)
32	Inventar i imët	1,328,734	1,636,864	(308,130)
	3. Llogari të arkëtueshme	20,880,763	20,973,121	(92,358)
4342	Të tjera operacione me shtetin	19,593,729	19,678,087	(84,358)
468	Debitore të ndryshme	1,287,034	1,295,034	(8,000)
	II. Aktive Afatgjata	241,698,376	135,613,620	106,084,756
20	Aktive Afatgjata Jomateriale	7,263,243	5,389,513	1,873,730
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	7,263,243	5,389,513	1,873,730
21	Aktive Afatgjata Materiale	234,435,133	130,224,107	104,211,026
212	Ndërtime e Konstruksione	133,772,219	61,992,928	71,779,291
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	10,491,281	8,386,063	2,105,218
215	Mjete transporti	2,738,071	2,882,180	(144,109)
218	Inventar Ekonomik	87,433,562	56,962,936	30,470,626
	IAKTIVE AFATSHKURTRA	104,467,139	82,486,216	21,980,923
	TOTALI I AKTIVIT	346,165,515	218,099,836	128,065,679

Burimi: INSTAT

Zëri Aktive paraqitet për 346,165,515 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive afatshkurta” plus “Aktive afatgjata”.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe kap shumën 104,467,139 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “mjeteve monetare dhe ekuivalentet të tyre” me “gjendje inventarit qarkullues” dhe “llogarive të arkëtueshme”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare dhe ekuivalentet të tyre me vlerë 60,480,888 lekë e cila përbëhet nga: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerë 60,480,888 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 22,428,902 lekë.

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 60,480,888 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë e cila është shtuar prej vitit 2017 me 22,428,902 lekë, dhe përfaqëson rritjen e sponsorizimeve që do të trashëgohen në vitin 2019 si dhe rritjen e detyrimeve të shpenzimeve të njohura për vitin 2018 dhe që do të likujdohen në vitin 2019. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF “Procedurat e mbylljes së llogarive”, Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme. Teprica në këtë llogari duhet të vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin, e cila duhet të paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve).

Nga auditimi u konstatua se, në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 60,480,888 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga sponsorizimet, në pasivin e bilancit është paraqitur në llogarinë nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 51,714,902 lekë si dhe një diferencë prej 8,765,986 lekë e cila nuk



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

pasqyrohet. Po ashtu, teprica në llogarinë 520 duhet të vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin, e cila duhet të paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve) për vitin 2018 mungon.

Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kësaj llogarie.

Titulli i Gjetjes 3:	<i>Analizë e zërave të aktivitetit</i>
Situata:	Në pasqyrat financiare të vitit 2018 në aktiv të bilancit kontabël llogaritë financiare paraqiten në shumën 60,480,888 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 "Disponibilitete në thesar" për të njëjtën vlerë e cila është shtuar prej vitit 2017 me 22,428,902 lekë, dhe përfaqëson rritjen e sponsorizimeve që do të trashëgohen në vitin 2019 si dhe rritjen e detyrimeve të shpenzimeve të njohura për vitin 2018 dhe që do të likujdohen në vitin 2019. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF "Procedurat e mbylljes së llogarive", Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme. Nga auditimi u konstatua se, në aktiv llog. 520 "Disponibilitete në thesar" paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 60,480,888 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga <i>sponsorizimet</i>, në pasivin e bilancit është paraqitur në llogarinë nr. 85 "Rezultati ushtrimor nga funksionimi" në vlerën 51,714,902 lekë si dhe një diferencë prej 8,765,986 lekë e cila nuk pasqyrohet. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, teprica në llogarinë 520 duhet të vërtetohet me aktrakordimin me Thesarin, e cila duhet të paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve) për vitin 2018 mungon. Vlerat e mësipërme të kontabilizuara në llogaritë "Rezultati i mbartur nga funksionimi" dhe "Rezultati ushtrimor nga funksionimi" e denatrojnë këto llogari dhe vlera e mësipërme duhet të paraqitet në klasën 4 "Detyrimet afat shkurtra" që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër (specifikisht të analizuar sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" dhe "Llogari të tjera" që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor). Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 "Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur", bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar. Llogaria 12 "Rezultate të mbartura nga funksioni", është llogari rregulluese që përfaqëson rezultatin e trashëguar nga viti ose vitet e mëparshme. Në të dhënat shpjeguese të llogarisë vjetore nuk shpjegohet besueshmëria ligjore e rezultatit të trashëguar dhe të sqarohet përbërja e tij (në ndarjen të konstatuara dhe të arkëtuara). Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe në pasqyrën financiare të vitit 2017).
Kriteri:	<i>Udhëzimi nr. 39, datë 24.12.2018 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018"</i> <i>Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar.</i>
Ndikimi/Efekti:	Vlerat e mësipërme të kontabilizuara në llogaritë "Rezultati i mbartur nga funksionimi" dhe "Rezultati ushtrimor nga funksionimi" e denatrojnë këto llogari. <i>Llogaria 12 "Rezultate të mbartura nga funksioni", është llogari rregulluese dhe si e tillë duhet pasqyruar.</i>
Shkaku:	Regjistrim i shumave në llogari të ndryshme
Rëndësia:	E lartë

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 3:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi nuk kryejnë mbylljen e llogarisë 520 "Disponibiliteteve në Thesar". Gjithashtu llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve monetare në ruajtje të evidentuara në llogarinë 466 si dhe sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Për vitin 2018:

Diferenca prej 8,765,986 lekë për vitin 2018 përbëhet nga llogaria 466 me vlerë 1,672,857 lekë nga të cilat 1,382,746 lekë të trashëguara nga viti 2017 dhe 290,111 lekë të krijuara në vitin 2018 sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarit si dhe shuma 7,093, 129 lekë e cila përfaqëson shumën e U. shpenzimeve tënjohura dhe rregjistruar në sistem të cilat do të likujdohen në vitin 2019 me fondet e vitit 2018 sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarit të kontabilizuar në llogarinë 467 kreditor të tjerë.

Nga sa më sipër teprica e llogarisë 520 “Disponibiliteteve në Thesar” përbëhet nga vlera e llogarisë 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” 51,714,902 lekë, nga llogaria 466 “Kreditor përmjete në ruajtje” me vlerë 1,672,875 lekë dhe nga vlera 7,093,129 lekë përfshirë në llogarinë 467 “Kreditor të tjerë”.

Për vitin 2017:

Diferenca prej 2,971,178 lekë përbëhet nga llogaria 466 me vlerë 1,382,746 lekë të cilat janë të trashëguara nga viti 2016 si dhe shuma 1,588, 432 lekë e cila përfaqëson shumën e U. shpenzimeve tënjohura dhe rregjistruara në sistem të cilat do të likujdohen në vitin 2018 me fondet e vitit 2017 sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarit të kontabilizuar në llogarinë “Kreditor të tjerë”.

Nga sa më sipër teprica e llogarisë 520 “Disponibiliteteve në Thesar” është 38,051,986 lekë e cila përbëhet nga vlera e llogarisë 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” 35,080,800 lekë, nga llogaria 466 “Kreditor përmjete në ruajtje” me vlerë 1,382,746 lekë dhe nga vlera 1,588,432 lekë përfshirë në llogarinë 467 “Kreditor të tjerë”.

Nga ana e Drejtorisë së financës janë bërë rakordimet me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat çdo muaj, gjë e cila mund të konfirmohet edhe nga Dega e Thesarit. Bashkëngjitur keni rakordimet mujore.

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.3

Sqarojmë se, në aktin e rakordimit me degën e thesarit mbi të ardhurat për vitin 2017 dhe 2018, janë cilësuar të ardhurat që mbeten për tu trashëguar, konkretisht për vitin 2018 në vlerën 8,090,685.48 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 0.00 lekë.

Për vitet 2017 dhe 2018 me emërtimin e llogarisë “Grante nga organizma të tjerë” ndërkohë në formatin e shpenzimeve të bilancit kontabël dhe relacionet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk pasqyrohet informacioni i mësipërm.

Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njëjstëve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar. Llogaria 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, është llogari rregulluese që përfaqëson rezultatin e trashëguar nga viti ose vitet e mëparshme.

Ky observacion nuk merret në konsideratë

2. Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 23,105,488 lekë e cila përbëhet nga:

Totali i zërit gjendje Inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 355,621 nga viti i shkuar 2017. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve” në Pasqyrën përkatëse. Në përbërje të kësaj llogarie janë:

Llogaria 31 “Materiale” me vlerë 21,776,754 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 47,491 lekë.

Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 1,328,734 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 308,130 lekë kryesisht nga dalja jashtë përdorimit e objekteve të inventarit në shumën 370,947 lekë dhe shtuar nga blerjet (62,817 lekë).

Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është pakësuar 2,671,241 lekë, e barabartë me llogarinë 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare.

3. Llogari të arkëtueshme me vlerë 20,880,763 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 468 “Debitor” me vlerë 1,287,034 lekë pakësuar nga viti shkuar me 8,000 lekë si e rrjedhojë e arkëtimit të detyrimit të tre punonjësve.

Në lekë

N r	Emri Mbiemri	Gj.01.01.17	Totali	Shenime	Ark. 2018	Gj.31.12/18
37	R. L	32,330		D. Vodafon V.Gjykate	8,000	22,330
	TOTALI	1,302,024.00	1,302,024.00		8,000.00	1,287,034.00

Burimi: INSTAT



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Sa më sipër nga auditimi rezultoi se subjekti i ka pjesërisht të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Titulli i Gjetjes 10:	<i>Analizë mbi llogarinë e debitorëve</i>
Situata:	Përsa i përket debitorëve të ndryshëm, pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 1,295,034 lekë, pas auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit mbi korrrespondencën e mbajtur me këta debitorë, si dhe pas diskutimit me financën e INSTAT përsa i përket mundësisë së arkëtimit të këtyre shumave, u konstatua se, subjekti i ka pjesërisht të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër. Detyrimet e mbartura janë përpara vitit 2008 dhe kanë mundësi shumë të pakta arkëtimi (Trajtuar më hollësisht në faqet 20-21 për vitin 2017 dhe 36 për vitin 2018, të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	<i>Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”</i>
Ndikimi/Efekti:	Prania e debitorëve mundësia e arkëtimit të së cilëve është shumë e ulët rëndon pasqyrat financiare, si dhe bën një paraqitje jo reale të tyre.
Shkaku:	Shuma të mbartura në vite si rrjedhojë e mundësive shumë të pakëta për arkëtim.
Rëndësia:	E mesme

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 19,593,729 lekë pakësuar nga viti shkuar me 84,358 lekë, kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2017, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj, detyrimet ndaj furnitorëve për blerjet e bëra dhe kreditorëve për shërbimet e kryera.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe kap shumën 241,698,376 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale” dhe “aktive afatgjata materiale”.

Përbërës të postit aktive afatgjata janë llogaritë:

1. Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 7,263,243 lekë shtuar nga viti i shkuar me 1,873,730 lekë përbëhet nga:

Llogaria 203 “Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme” shtuar nga viti i shkuar me 1,873,730 lekë

Nga auditimi u konstatua se, në bilancin e vitit 2017 vlera e kësaj llogarie figuronte 0 lekë ndërsa në bilancin e vitit 2018 tek rreshti ‘ushtrim paraardhës’ rezulton me vlerën 5,389,513 lekë, shifër e cila as në shënimet shpjeguese nuk justifikohet se nga vjen.

Titulli i Gjetjes 6:	<i>Analizë e zërave të aktivitetit</i>
Situata:	Në pasqyrat financiare të vitit 2018 (të aparatit edhe ato të konsoliduara) në zërin e aktiveve afatgjata, llogaria 203 “Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme” shtuar nga viti i shkuar me 1,873,730 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në bilancin e vitit 2017 vlera e kësaj llogarie figuronte 0 lekë ndërsa në bilancin e vitit 2018 tek rreshti ‘ushtrim paraardhës’ rezulton me vlerën 5,389,513 lekë, shifër e cila as në shënimet shpjeguese nuk justifikohet se nga vjen. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.36 të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	<i>Udhëzim nr.23, datë 22.12.2017 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2017”, Udhëzim nr.39, datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2018”,</i>
Ndikimi/Efekti:	Mungesë e rakordimit dhe unifikimit të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare. Ulje të besueshmërisë në vërtetin dhe saktësinë e vlerave të pasqyruara në Pasqyra Financiare.
Shkaku:	Gabim njerëzor gjatë inkorporimit dhe hedhjes së të dhënave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Rëndësia:

E mesme

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 6 sqaroj se :

Në pasqyrat financiare të vitit 2017 (të aparatit edhe ato të konsoliduara) në zërin e aktiveve afatgjata, llogaria 203 “Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme” paraqitet me vlerën 6,842,636 lekë dhe llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupezuara(-)” paraqitet me vlerën 1,453,122 lekë.

Në pasqyrat financiare të vitit 2018 (të aparatit edhe ato të konsoliduara) në zërin e aktiveve afatgjata, te kollona ‘ushtrim paraardhës’ paraqitet llogaria 203 “Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme” paraqitet me vlerën neto 5,389,514 (6,842,636-1,453,122) lekë sipas të udhëzimit nr 8 datë 09.03.2018 “Për proçdurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.6

Risjellim në vëmendjen tuaj, në pasqyrat financiare të vitit 2017 protokolluar me nr.257 prot datë 19.02.2018, vendosura në dispozicion të grupit të auditimit, llogaria ekonomike nr 203 me emërtesë “Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme” figuron me vlerën 0 lekë.

Ky observacion nuk merret në konsideratë

2. Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 234,435,133 lekë shtuar nga viti i shkuar me 104,211,026 lekë përbëhet nga:

Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” shtuar nga viti shkuar me vlerën 71,779,291 lekë duke arrit vlerën 133,772,219 lekë. Ky shtim ka ardh si rrjedhojë e kalimit në përgjegjësi administrimi të godinës. Vlera e përcaktuar në Urdhrin e përbashkët për kalim kapital, pikën 1 të tij, specifikohet tëjetë 99,018,247 lekë. Nga ana e financës shpjegohet se kësaj shume i janë shtuar edhe vlerat e ashensorit për 3,695,850 lekë dhe sisitemit ngrohje ftohje për 5,706,981 lekë, megjithëse në detajimin bashkangjitur urdhërit specifikohen si zëra të llogarisë 214 pra instalimet teknike.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” me vlerën e 10,491,281 lekë, shtuar nga viti shkuar me 2,105,218 lekë si rrjedhojë e dy shtesave pa pagesë dhe nxjerrjes jashtë përdorimit, është i zbërthyer në mënyrë analitike edhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 2,738,071 lekë e pakësuar nga viti 2017 me 144,109 lekë për shkak të amortizimit.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 87,433,562 lekë dhe është shtuar me 30,470,626 lekë, veprim i ardhur si rrjedhojë e dy shtesave nga blerja me pagesë në vlerën 2,365,883 lekë dhe marrja pa pagesë si më poshtë me vlerë 38,391,859 lekë. Si dhe një pakësim me vlerë 13,305,743 lekë prej nxjerrjes jashtë përdorimit.

Në lekë

Nr I llog	Emertimi	Sasi	Cmim	Vlera
218	Karrige sida	32	10,740	343,680
218	Tavoline Sida	26	9,360	243,360
218	Dere falas sida	1	398,640	398,640
218	Sistem MKZ sida	1	418,800	418,800
218	Kompjuter Destop sida	20	94,800	1,896,000
218	Server Dell sida	5	2,615,306	13,076,530
218	Storage sistem dell	1	15,947,352	15,947,352
218	Central Sëich Sida	2	1,674,000	3,348,000
218	Terminal Sëich Sida	5	423,288	2,116,440
218	Set asset control sida	1	218,400	218,400
218	UPS- 1000VA sida	20	8400	168,000
218	Printer zvicra	1	25,000	25,000
218	Totali Falas			38,200,202
Blerje	Tablet lenova	40	48,549	1,941,940
218	Tablet lenova	15	41,040	615,600



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

218	Totali Blerje			2,557,540
	Totali			40,757,742
214	Pompe uji blerje	1	132,000	132,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2018, gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2018-2017), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2018	2017	Diferenca 2018 – 2017
A	FONDE TË VETA		159,074,740	14,509,008
101	Fonde bazë		159,074,740	14,509,008
B	DETYRIME		23,944,298	2,455,713
Klasa 4	Detyrime afatshkurtër		23,944,298	2,455,713
401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to		562,502	(3,105,312)
42	Personeli e llogari të lidhura me to		8,580,960	(347,219)
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa		1,989,443	1,122,414
4341	Të tjera operacione me shtetin		1,295,033	(6,991)
435	Sigurime shoqërore		2,999,743	600,273
436	Sigurime shëndetsore		375,769	59,214
437.438	Organizma të tjerë shoqëror		482,382	(1,449,719)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje		1,382,746	0
467	Kreditorë të ndryshëm		6,275,720	5,574,053
85	Rezultati i ushtrimit		35,080,798	1,053,564
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)		218,099,836	18,018,285

Burimi: INSTAT

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 128,065,679 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

B.Pasivet

I.Pasivet Afatshkurtëra, ndryshuar nga 23,944,296 lekë një vit më parë, në 29,646,740 lekë, pra janë shtuar këtë vit me shumën prej 5,702,444 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie përbëhet si më poshtë:

1. Llogari të pagueshme, e cila ka pësuar një shtim prej 5,702,444 lekë nga viti shkuar, në përbërje të saj janë:

Llogaria 401-408 "Furnitore e llogari të lidhura me to" është shtuar këtë vit me 123,599 lekë si rrjedhojë e likuidimit të muajt dhjetor duke arrit në vlerën 3,111,420 lekë. (si psh vlera likuidim për shtypshkronjën "Albdesign" me vlerë 1,996,308 lekë, për subjektin "Duna" për pjesë ndërimi për printera me vlerë 978,206,29 lekë, shtypshkronjës "Media print" për 489,354 lekë, shtypshkronjën "Media print" për vlerën 709,201 lekë, pjesë këmbimi për kompjutera e servera "pc store" për 1,153,200 lekë likuidime të tjera me vlera më të vogla).

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve "Furnitorë e llogari të lidhura me to" ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve. Nisur nga numri relativisht i lartë u veprua duke zgjedhur për të audituar një pjesë të veprimeve si më poshtë vijon:

Urdhër shpenzimi nr. 372, dt. 03.05.18 për vlerën 2,661,750 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si faturë e likuiduar brenda



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

vitit ushtrimor të vitit 2018 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 620, dt. 16.07.18 për vlerën 2,137,185 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2018 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 160, dt. 20.02.18 për vlerën 2,662,635 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2018 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 1021, dt. 21.11.18 për vlerën 2,163,037 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2018 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Urdhër shpenzimi nr. 377, dt. 03.05.18 për vlerën 1,309,800 lekë i aprovuar dhe kaluar nga dega e thesarit Tiranë është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2018 si faturë e likuiduar brenda vitit ushtrimor të vitit 2018 e cila është rakorduar dhe pasqyruar në aktin e rakordimit të mbajtur midis INSTAT dhe Degës së thesarit Tiranë për të njëjtat vlera.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, është shtuar këtë vit me 296,697 lekë si rrjedhojë e punonjësve sezonal për shkak të natyrës së punës së institucionit.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat e muajt dhjetor 2017, edhe është shtuar këtë vit me vlerën 185,684 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, është shtuar këtë vit si rrjedhojë e punonjësve sezonal për shkak të natyrës së punës së institucionit me vlerën 87,429 lekë, duke arritur vlerën prej 3,087,172 lekë.

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, është shtuar këtë vit me vlerën 10,988 lekë, duke arritur vlerën prej 386,754 lekë.

Llogaria 437,438 “Organizma të tjerë shtetërore”, është shtuar këtë vit me vlerën 3,189,365 lekë, duke arritur vlerën prej 3,671,747 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është shtuar nga viti i shkuar, me vlerën 290,111 lekë dhe përfaqëson pjesën e mbetur të sponsorizimeve nga viti 2013, pasi është përdorur sipas kontratave.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është shtuar për 1,526,571 lekë, përfaqëson detyrimin e institucionit për shpenzimet e konstatuara në muajin dhjetor si energji elektrike, ujë, shërbime postare, telefonike etj. të cilat do të likuqjohen në vitin 2019.

Llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin” përfaqëson detyrimet e konstatuara të institucionit ndaj Shtetit për operacione të ndryshme buxhetore që lidhen me të. Në këtë llogari evidentohet edhe pjesa e buxhetit për të ardhurat e konstatuara që në mbyllje të ushtrimit rezultojnë të paarketuara edhe është pakësuar këtë vit me vlerën 8,000 lekë e cila përkon me arkëtimin e një pjesë të detyrimeve ndaj institucionit.

C. Aktive Neto/Fondet në total zëri ka ardhur me një shtim prej 122,363,235 lekë dhe në përbërje të tij përfshihen:

D. Fondi i Konsoliduar i cili përbëhet nga:

Llogaria 101 “Teprica/Deficiti i akumuluar”, është shtuar këtë vit me vlerën 105,729,133 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivit të bilancit.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 51,714,902 lekë dhe përfaqëson fondet jashtë buxhetore të ngelura pranë Institucionit të cilat do të trashëgohen në vitin 2019. Kjo tepricë kreditore përfaqëson rezultatin nga funksionimi që rrjedh nga të ardhurat që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në ushtrimet e mëpasme.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Formatet e miratuara që shoqërojnë llogaritë vjetore të vitit 2018, janë plotësuar si më poshtë:

Formati 2 “Pasqyra e performancës financiare”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Si dhe zërat përkatës së klasës 7 pra të ardhurat e ushtrimit.

Në këtë pasqyrë të ardhurat paraqiten në shumën 522,966,841 lekë, ky total është i rakorduar me pasqyrën “Shpenzime të shfrytëzimit” dhe “Llogaritë Debitore”.

Të ardhurat e INSTAT janë të karakterit “Të ardhura jo Tatimore” dhe kapin shumën 29,353,280 lekë dhe rakordon me vlerën e paraqitur në akt rakordim me thesarin. Këto të ardhura përfaqësohen nga:

Llogaria 71. III “Të ardhura jotatimore”

- llogaria 7111 “të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh” me vlerë prej 29,353,280 lekë, e cila nga viti i shkuar është pakësuar me 152,135 lekë.

Llogaria 72. V “Grante Korente” në total prej 493,613,561 lekë shtuar nga viti i shkuar me 57,646,640 lekë. Kjo llogari përbëhet nga:

- llogaria 720 “Grant korrent i brendshëm” për vlerën 418,809,308 lekë të përbërë nga llogaria 7200 “Nga buxheti për NjQPQ” për vlerën 399,215,579 lekë, shtuar nga viti kaluar me 38,347,372 lekë si rrjedhojë e shtimit të fondeve buxhetore dhe sipas argumentimit nga ana e institucionit përfaqëson shpenzimet korrente të korektuara pasi janë zbritur detyrimet për vitin e ardhshëm dhe pjesa e sponsorizimit. Si dhe llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” me vlerën 19,593,729 lekë, e cila përfaqëson detyrimet për tu paguar në vitin e ardhshëm dhe është pakësuar nga viti i shtuar me 84,358 lekë si rrjedhojë e arkëtimit të një pjesë të detyrimeve. Kjo llogari pasqyron si kundërparti ato lloj shpenzimesh të konstatuara nga institucioni në vitin ushtrior që përballohen me fondet e buxhetit të vitit të mëpasshem (pagat, sigurimet shoqërore, shëndetsore dhe tatimet e muajit Dhjetor). Mbi bazën e këtij informacioni në fund të periudhës ushtrimore Institucioni ka kryer veprimin kontabël mes llogarive 4342 “Marrdhënie me shtetin debitor” dhe 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Nga auditimi konstatohet se kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabartë me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim.
- Llogaria 721 “Grante Korente i huaj nga org.ndërkombëtare” në total prej 74,04,253 lekë shtuar nga viti i shkuar me 19,383,626 lekë.

Shpenzimet

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2018. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë për muaj dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2018 në bilancin kontabël dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur si detyrim nga 31.12.2017.

Në lekë

		Viti 2018	Viti 2017
	I. Shpenzime Korrente	471,607,560	433,062,777
600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	323,373,706	280,903,515
6001	Paga, personel I perhershëm	136,944,931	125,758,089
6002	Paga personel I Perkohshëm	186,428,775	155,145,426
601	ILKONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	53,608,023	46,376,514
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	47,857,649	41,654,196
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	5,750,374	4,722,318
602	II.BLERJE MALLRA E SHERBIME	93,133,000	102,235,507
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	7,459,649	8,124,833
6021	Materiale dhe sherbime special	3,427,153	4,915,264



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

6022	Sherbime nga te trete	61,014,359	72,023,500
6023	Shpenzime transporti	5,505,087	895,906
6024	Shpenzime udhëtimi	8,555,512	6,987,717
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	6,252,320	4,178,721
6026	Shpenzime per qeramarrje	409,700	2,196,176
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	226,000	2,547,932
6029	Shpenzime te tjera operative	283,220	365,458
6041	Transferime korente te brendshme	622,000	198,000
606	Transferime per Buxhetet familjare e Individe	515,210	678,000
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	355,621	2,671,241
	IX.SHPENZIME TE TJERA	-355,621	-2,671,241

Burimi: INSTAT

Analizuar si më poshtë vijon:

Kjo rubrikë paraqitet në shumën 471,251,939 lekë dhe përbëhet nga këto poste:

Llog.600 “paga e shpenzime personeli” për 323,373,706 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, e marra nga dokumentat justifikuese sipas detyrimeve të konstatuara dhe listë pagesat e ekzekutuara. Llogaria 601 “kontribute të sigurimeve shoqërore” për 53,608,023 lekë, llogaria 602 “mallra dhe shërbime të tjera” për 93,133,000 lekë e përbërë nga:

- 6020 Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme për 7,459,649 lekë e cila nga vetë emërtimi paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për blerje dhe kancelari etj gjatë vitit 2018.
- 6021 Materiale dhe shërbime speciale për shumën 3,427,153 lekë paraqet shumën e shpenzimeve specifike të Institucionit.
- 6022 Shërbime për shumën 61,014,359 lekë përfaqëson shpenzimet që institucioni kryen për shërbime nga të tretët energji elektrike, ujë, postë, komunikim si dhe ruajtje me roje civile.
- 6023 Shërbime transporti për shumën 5,505,087 lekë përfaqësojnë shpenzime për shërbimet e automjeteve të institucionit si naftë, vaj , pjesë këmbimi etj.
- 6024 Shpenzime udhëtimi për shumën 8,555,512 lekë përfaqësojnë përfaqësojnë shpenzimet që institucioni kryen për pagesën e dietave të punonjësve që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre.
- 6025 Mirëmbajtje të zakonshme për shumën 6,252,320 lekë janë shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të tyre dhe kryesisht mirëmbajtja e faqes së internetit, e rrjetit kompjuterik, riparimet e automjeteve të INSTAT
- 6026 Shpenzime për qeramarrje për shumën 409,700 lekë.
- 6027 Shpenzime për detyrime për kompensime legale për shumën 226,000 lekë përfaqësojnë shpenzimet që institucioni kryen për ekzekutimet vendimeve gjyqësore.

Në lekë

Data	Përshkrimi	Vlera
04.01.2018	Ko.page dhjetor 2017 V.Mina	113,000
01.02.2018	Ko.page21.12.17-20.02.18 V.Mina	113,000
Totali		226,000

- 6029 Shpenzime të tjera Operative për shumën 283,220 lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kriterëve të klasifikimit buxhetor por që janë të nevojshme të kryhen gjatë periudhës buxhetore.

Llogaria 604 ”Transferime korrente të brendshme” për shumën 622,000 lekë dhe janë përfshirë 4 pagesa të kryera për anëtarët e Këshillit të statistikavedhe 3 për anëtarët e Këshillit të Nomenclaturës. Shtuar nga viti i shkuar me 424,000 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Llogaria 606 “Transferta tek buxhetet familjare” për shumën 515,210 lekë përfaqëson mbështetje për raste fatkeqësish, sëmundjesh apo dalje në pension ku për këtë vit ka patur një total prej 14 rastesh të tilla, detajuar si më poshtë vijon:

Në lekë			
Nr	Specifikimi	Vlera	Shkresa
1	Raste fatkeqësish	30,000	nr 780 dt 28.05.18
2		30,000	nr 989 dt 05.06.18
3		30,000	nr 1281 dt 23.08.18
4		30,000	nr 1578/1 dt 27.12.18
5		30,000	nr 1622/1 dt 31.10.18
6		30,000	nr 1592/1 dt 25.10.18
7	Rast vdekje	62,960	nr 1588 dt 14.12.2017
8	Rast sëmundje	50,000	nr 899 dt 05.06.18
9		50,000	nr 1727 dt 19.11.18
10	Dalje në pension	41,750	nr 1328 /2 dt 10.01.18
11		101,500	nr 714 /2 dt 15.06.18
12		59,000	nr 715 /2 dt 15.06.18
Total		545,210	

Burimi: INSTAT

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” ku paraqiten ndryshimet e gjendjeve për materialet e mallrat në magazinë, paraqitet me vlerën 355,621 lekë, që përputhet me ndryshimin e gjendjes së inventarit sipas aktivitetit të bilancit.

Llogaria 85 “Rezultate nga funksionimi” me vlerë 51,714,902 lekë përfaqëson diferencën pozitive midis totalit të operacioneve të njësisë me totalin shpenzimeve, në përputje me Udhëzimin 14 datë 28.12.2016 kjo shifër është e barabartë me llogarinë 85 “Saldo kreditore” e pasivit të pasqyrave financiare.

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 471,251,939 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 501,262,536 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 2. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2011 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Format i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.

173. Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 8, dt. 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34 “Degët e thesarit gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si referencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë në zbatim të manualeve përkatës”.

Titulli i Gjetjes 4:	<i>Analizë e shpenzimeve të ushtrimit</i>
Situata:	Nga auditimi i shpenzimeve të ushtrimit, u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 471,251,939 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 501,262,536 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 2. Në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma. Edhe për vitin 2017 u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 430,391,536 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 448,520,652 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.20112 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pikat 172 dhe 173 si dhe UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34. Nga auditimi mbi rakordin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, u konstatua se për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.40-42 dhe 44 të Projekt Raportit të Auditimit)
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, dt. 06.02.20112 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014”. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit”
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrim i cunguar, jo i plotë dhe jo lehtësisht i kuptueshëm i situatës së njësisë ekonomike. Si dhe cënim i parimit të transparencës.
Shkaku:	Regjistrim i vlerave në llogari të ndryshme.
Rëndësia:	E lartë

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 4:

Për vitin 2018:

Vlera 471,251,939 lekë në pasqyrat financiare formati 2 për vitin 2018 përbëhet nga shpenzimet korrente të cilat sipas situacionit të kuadruara me Degen e Thesarit janë 471,336,299 lekë të cilës i zbritet vlera e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin”(të drejta) gjëndje më dt.31.12.2017 dhe i shtohet gjëndje e llogarisë 4342 më dt. 31.12.2018 me vlerë (-19,678,087 +19,593,729) lekë e cila përfaqëson detyrimin e shtetit ndaj institucionit për shpenzimet e konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara si paga , sigurime shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhura etj shpenzime të muajit dhjetor 2018 ,por që do të paguhet nga buxheti i vitit 2019.

Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit vlera 501,262,536 lekë përfaqëson totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale përkatësisht 471,336,299 dhe 29,926,237 lekë.

Për vitin 2017:

Vlera e 482,312,634 lekë në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit formati 3/1 përbëhet nga shpenzimet korrente sipas situacionit të kuadruara me Degën e Thesarit janë 429,617,664 lekë të cilës i zbritet vlera e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin debitor” gjëndje më dt. 31.12.2016 dhe i shtohet gjëndje e llogarisë 4342 më dt. 31.12.2017 me vlerë (-19,593,729+18,904,215) lekë.

Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit vlera 448,520,652 lekë përfaqëson totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale përkatësisht 429,617,664 dhe 18,902,988 lekë.

Pra nga sa me sipër pasqyra financiare formati 2 viti 2018 dhe pasqyra e shpenzimeve të ushtrimit formati 3/1 viti 2017 nuk duhet të jete e barabarte me shpenzimet korrente sipas situacionit të rakorduar me degen e thesarit.

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.4

Nga shqyrtimi i nënlllogarive të paraqitura në aktin e rakordimit rezultoi se p.sh në pasqyrat e bilancit 2018 gjendja e llogarisë nr. 604 “Transferta korrente të brendshme” është 622,000, kurse vlera e shënuar në aktin e rakordimit është 550,700 lekë. Po kështu, edhe në pasqyrat e bilancit 2017 gjendja e llogarisë nr. 604 “Transferta korrente të brendshme” është 198,000 lekë kurse vlera e shënuar në aktin e rakordimit është 215,300 lekë.

I njëjti fenomen haste edhe për llogaritë e tjera me përjashtim të 606.

Nga auditimi mbi rakordin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, u konstatua se për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Në pasqyrat financiare mungon shpjegimi dhe nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerat e rakorduara me thesarin dhe çfarë vlerash financiare përfshihen në deklaratat financiare dhe shpjegimi përse nuk rakordojnë këto shuma. Ky observacion nuk merret në konsideratë

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2018:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 1** “Pasqyra e pozicionit”

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 346,165,515 lekë në vitin 2018 dhe 218,099,836lekë për vitin 2017;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të **Formatit nr. 2** “Pasqyra e performancës”

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 522,966,841 lekë (471,251,939 + 51,714,902). Pra totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 2), në shumën 522,966,841 lekë;

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr.2, për 355,621 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 “Gjendja e inventarit” (kolona nr. 28) në aktivin e bilancit. Pra, (23,461,109-23,105,488) dhe janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 355,621 lekë.

- Kontrollat për llogaritë: Llogaria 841 “Transferimi i ndryshimit të gjendjes” në **Formatin nr. 3/1** “Shpenzime të ushtrimit”, duhet të jetë e barabartë sa llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në të njëjtën pasqyrë, me shenjë të kundërt dhe llogaria nr. 8423 “Transferim për ndryshim gjendje” nuk arrijmë dot ti kryejmë më si pasojë e ndryshimit të formatit të pasqyrave.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 3** “Pasqyra e cash floë”_kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Më hollësisht paraqitur në Aneksin nr.1

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 4** “Pasqyra e ndryimeve në aktivet neto/fondet neto” kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 316,518,775 lekë. Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr.1

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 5** “Shënimet shpjeguese”, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave tëparaqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë,etj);

- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësive;

- informacion në lidhje me elementë specifikë të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe

- informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i vakët, pyetjet 1,2,14,15 nuk kanë marr asnjë përgjigje.

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 6** “Investimet dhe Burimet e financimit”. balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për INSTAT rezulton 0. Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr.1

Nga auditimi konstatohet se, “Teprica ne mbyllje” **nuk rakordon** me shumën që figuron në postin përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit.

Sa më sipër, u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 7/a** “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto historike)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (materiale e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Formati nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (vlerë neto)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shtesat epakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (materiale e jomateriale) me vlerën neto të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës. Vlera neto përgjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, përpakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, **është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin.**

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket këtyre llogarive.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të **Formatit nr. 8** “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 6002 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket këtyre llogarive.

Mbyllja e bilancit për vitin 2018 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”

Veprimet për vitin 2018 janë axhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

RAKORDIMET E PASQYRAVE TË BILANCIT FINANCIAR:

Mbi shpenzimet:

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 **nuk përputhen** me vlerat e paraqitura në akt-rakordin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 471,251,939 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 501,262,536 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 2. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.20112 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”, pikat 172, 173 si dhe UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34. Trajtuar më gjerësisht në Aneksin nr.1

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
-----------	------------------------	---------------------	-----------------------	-----------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

60	I. Shpenzime Korrente	471,251,939	448,520,652	22,731,287
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	323,373,706	321,131,044	2,242,662
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	53,608,023	51,645,830	1,962,193
602	Mallra dhe shërbime te tjera	93,133,000	97,521,515	(4,388,515)
604	Transferta korente të brendshme	622,000	550,700	71,300
606	Transferta për buxh. familjare e individë	515,210	515,210	0

Burimi përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiare kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.

Në lekë

Art	Plan vjetor	Shpenzime thesari
231	5,000,000	4,560,354
2319999	23,000,000	23,000,000
231	3,411,800	2,365,883
Total	31,411,800	29,926,228

Burimi: INSTAT

Pasqyrimi i krahasimit mes dy formateve, pasqyrave financiare dhe situacionit të shpenzimeve:

Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	2018	
		Pasqyrat financiare	Situacion i shpenzimeve
231	Shpenzime në proces për rritjen e AQT		29,926,237

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

Nëse kryejmë një krahasim mes viteve 2017 dhe 2018, shohim ripërsëritje të fenomenit, përmbledhtas si më poshtë vijonë:

Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, konstatua se për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.

- Në lekë

Nr. llog.	SHPENZIMET E USHTRIMIT	2017		2018	
		Pasqyrat financiare	Situacion i shpenzimeve	Pasqyrat financiare	Situacion i shpenzimeve
231	Shpenzime në proces për rritjen e AQT		18,902,988		29,926,237

- Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes 13:	<i>Analizë mbi rakordimin me situacione</i>
Situata:	Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, u konstatua se, për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.44-45 të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	Udhëzimi nr. 39, datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018”
Ndikimi/Efekti:	Mungesë e rakordimit dhe unifikimit të vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.
Shkaku:	Mos pasqyrim i saktë i zërave në pasqyrat financiare.
Rëndësia:	E lartë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 13 sqaroj se :

Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara siç është trajtuar nga audituesit.

Në aktiv të bilancit grupi i llogarive 23 paraqiten për investime në proces.

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.13

Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohet vlerë, ndërkohë në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiare kjo llogari nuk paraqitet me asnjë vlerë.

Përsa i përket kostos direkte të investimit gjatë periudhës së zbatimit të tij, ajo pasqyrohet në analizat respektive të llogarive të grupit 23 "Aktive të qëndrueshme të trupezuara në proces" me kundër parti kreditin e llogaritë të detyrimeve apo dhe llogaritë financiare. Fondet e përdorura për krijimin e tyre duhet të evidentohen në debi të llogarive financiare me kundër parti kreditin e llogarive respektive 105,106,16,17.

Ky observacion nuk merret në konsideratë

Mbi të ardhurat:

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2018, nënshkruar nga specialistja e financës znj. L. B dhe specialistja e Degës së Thesarit znj. Sh. C. Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë për 83,394,541.48 lekë, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2018, nga e cila janë derdhur në buxhet 9,055,205.00 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin 2019 prej 8,090,685.48 lekë.

Në lekë

Kod Institucion i	Klasifikim i Buxhetor	Përshkrimi	Shuma e arkëtuar	Pjesa e Institucionit	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Mbeten për tu trashëguar
1050001	7113099	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	41,058,279.00	32,250,000.00	32,250,000.00	8,808,279.00	
1050001	7115600	Të ardhura të tjera	246,926.00			246,926.00	
1050001	7211100	Grant nga org ndërkombëtare	42,089,336.48	33,998,651.00	33,998,651.00		8,090,685.48
		Totali	83,394,541.48	66,248,651.00	66,248,651.00	9,055,205.00	8,090,685.48

Burimi: INSTAT, Sektori i Financës.

Konstatohet se, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 2 Performanca Financiare "Të ardhurat e ushtrimit 2018", me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezulton se ka mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik. Më konkretisht:

Në lekë

Klasifikimi Buxhetor	Përshkrimi i të ardhurave	Sipas formatit nr. 2 të pasqyrave financiare	Sipas të dhënave të akt rakordimit vjetor me degën e thesarit
71	Te ardhura jo tatimore	29,353,280	
7113099	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve	0.00	41,058,279.00
7115600	Të ardhura të tjera	0.00	246,926.00
7211100	Grant nga org ndërkombëtare	74,804,253	42,089,336.48

Burimi: përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se në pasqyrat financiare (Formati 2), në llogarinë ekonomike 720 "Grant korrent i brendshëm" është vënë shuma 418,809,308 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 "Grant nga organizma ndërkombëtare" pasqyrohet me vlerën 74,804,253 lekë në Pasqyrën e performancës ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 42,089,336.48 lekë. Po ashtu detajimi i të ardhurave dytësore në akt rakordimin e thesarit pasqyrohet në të tjera llogari nga ato të pasqyrës së pperformancës, sikundër reflektohen edhe në tabelën e mësipërme.

Ky veprim i regjistrimit të këtyre zërave bën të vështirë leximin e pasqyrave financiare nga ana e përdoruesve të jashtëm, si dhe ul transparencën e Institucionit.

Titulli i Gjetjes 5:	<i>Analizë e të ardhurave të ushtrimit</i>
-----------------------------	--



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Situata:	Nga auditimi i “Të ardhurat e ushtrimit 2018”, sipas formatit nr. 2 të bilancit vjetor, kanë mospërputhje me të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik, të pasqyruara në aktin e rakordimit vjetor për të ardhurat. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë për 83,394,541.48 lekë, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2018, nga e cila janë derdhur në buxhet 9,055,205.00 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin 2019 prej 8,090,685.48 lekë. Konstatohet se, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 2 Performanca Financiare “Të ardhurat e ushtrimit 2018”, me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezulton se ka mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik. Nga analiza e llogarive në pasqyrat financiare (Formati 2), konstatohet se në llogarinë ekonomike 720 “Grant korrent i brendshëm” është vënë shuma 418,809,308 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “Grant nga organizma ndërkombëtare” pasqyrohet me vlerën 74,804,253 lekë në Pasqyrën e performancës ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 42,089,336.48 lekë. Po ashtu detajimi i të ardhurave dytësore në akt rakordimin e thesarit pasqyrohet në të tjera llogari nga ato të pasyrës së performancës. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe ne pasqyrën financiare të vitit 2017) <i>(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.39-40 dhe 45 të Projekt Raportit të Auditimit)</i>
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar me ligjin nr.8282, datë 21.01.1998, ligjin Nr. 9040, datë 27.03.2003 dhe ligjin Nr. 9807, datë 20.09.2007
Ndikimi/Efekti:	Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 2 Performanca Financiare me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezulton mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik. Nuk është arritur të shfrytëzohen të gjitha mjetet si rrjedhojë nuk është arritur të realizohen objektivat lidhur me përdorimin e disa fondeve, pavarësisht faktit se kishte mjete ne dispozicion për qëllime të caktuara
Shkaku:	Regjistrim i vlerave në llogari të ndryshme.
Rëndësia:	E mesme

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 5:

Për vitin 2018:

Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara janë 83,394,541 lekë, të cilat janë të barabarta me të hyrat në pasqyrën e flukseve monetare (CASH/FLOË) përkatësisht në rreshtat 6 dhe 7.

6	Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	41,305,205
7	Te hyra, Sponsorizime nga te trete, (+)	42,089,336
	TOTALI	83,394,541

Sipas aktarkordimit të ardhurat jotatimore janë realizuar në shumën 41,305,205 lekë (41,058,279+246,926) nga të cilat limiti i institucionit sipas ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018” i ndryshuar, është 32,250,000 lekë, dhe pjesa tjetër derdhet në buxhet në shumën 9,055,205 lekë.

Gjithashtu në buxhet derdhet, edhe teprica midis pjesës që i takon institucionit (limitit) 32,250,000 lekë dhe shpenzimeve faktike të kryera nga të ardhurat me vlerë 29,353,280 lekë e barabartë me 2,896,720 lekë.

Si përfundim të ardhura që i takojnë institucionit janë 29,353,280 e barabartë me rrjeshtin 39 në pasqyrën e performancës financiare.

Derdhjet në buxhetin e shtetit janë 11,951,925 (9,055,205+2,896,720) lekë të cilat janë të barabarta me rreshtin 29 të pasqyrës së flukseve monetare.

Llogaria grant korrent i brendshëm paraqitet në pasqyrë me vlerën 418,809,308 e cila llogaritet si diferencë e shpenzimeve operative nga fondet e buxhetit të shtetit (kapitulli 1) me vlerë 418,893,668 dhe vlerës 19,678,087 lekë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) gjëndje më dt. 31.12.2017.

Llogaria grant korrent i huaj paraqitet në pasqyrë me vlerën 74,804,253 e cila përbëhet nga të ardhurat e vitit 2018 me vlerë 42,089,366 të cilës i shtohen të ardhurat e trashguara nga viti i kaluar 35,080,800 lekë dhe i zbriten shpenzimet për investime të vitit me vlerë 2,365,913 lekë sipas rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2017:

Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara janë 67,739,117 lekë, të cilat janë të barabarta me të hyrat në “Pasqyrë e lëvizjes në CASH” rrjeshti 9 dhe 11.

6	2. Te ardhura e te hyra gjate vitit ne "Cash"	67,739,116
----------	--	-------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

9	- Te ardhura jo tatimore ne "Cash"	46,345,713
11	- Sponsorizime, grante e te ardhura te tjera "Cash"	21,393,403

Sipas aktarkordimit të ardhurat jotatimore janë realizuar në shumën 46,345,713 lekë nga të cilat limiti i institucionit sipas Ligjit nr.130/16 “Për buxhetin e vitit 2017” i ndryshuar, është 29,930,000 lekë, pjesa tjetër derdhet në buxhet në shumën 16,415,713 lekë.

Gjithashtu në buxhet derdhet, edhe teprica midis pjesës që i takon institucionit (limitit) 29,930,000 lekë dhe shpenzimeve faktike të kryera nga të ardhurat me vlerë 29,505,413 lekë e barabartë me 424,587 lekë.

Si përfundim të ardhura që i takojnë institucionit janë 29,505,413 e barabartë me rreshtin 39 në pasqyrën e ardhurave 3/1.

Derdhjet në buxhetin e shtetit janë 16,840,300 (16,415,713 +424,587) të cilat janë të barabarta me rreshtin 22 në “Pasqyrë e lëvizjes në CASH”.

Llogaria grant korent i brendshëm paraqitet në pasqyrë me vlerën 360,868,205 e cila llogaritet si diferencë e shpenzimeve operative nga fondet e buxhetit të shtetit (kapitulli 1) me vlerë 379,772,420 lekë dhe vlerës 18,904,215 lekëtë llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) gjëndje më dt. 31.12.2016.

Llogaria grant korent i huaj paraqitet në pasqyrë me vlerën 55,420,627 e cila përbëhet nga të ardhurat e vitit 2017 me vlerë 21,393,403 të cilës i shtohen të ardhurat e trashguara nga viti i kaluar 34,027,234 dhe i zbriten shpenzimet për investime të vitit ushtrimor me vlerë zero lekë sipas rakordimit me degën e thesarit.

Sipas pikës 37 të udhëzimit nr 8 datë 09.03.2018:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, para përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor, janë të detyruara të rakordojnë, vetëm për të dhënat mbi bazë cash, me degën e thesarit të juridiksionit që i mbulon. Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e aktrakordimit apo situacionin e të ardhurave e shpenzimeve për vitin që raportohet. Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dyja palët.

Përgjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.5

Nuk e kuptojmë nëse quhet rakordim fakti që “Të ardhurat e ushtrimit 2018”, sipas formatit nr. 2 të bilancit vjetor, kanë mospërputhje me të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik, të pasqyruara në aktin e rakordimit vjetor për të ardhurat.

Në bilancin kontabël (Formati 2), në llogarinë ekonomike 720 “Grant korrent i brendshëm” është vënë shuma 418,809,308 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “Grant nga organizma ndërkombëtare” pasqyrohet me vlerën 74,804,253 lekë në Pasqyrën e performancës ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 42,089,336.48 lekë. Po ashtu detajimi i të ardhurave dytësore në akt rakordimin e thesarit pasqyrohet në të tjera llogari nga ato të pasyrës së performancës, sikundër reflektohen edhe përgjatë materialit.

Gjithashtu edhe në “Të ardhurat e ushtrimit 2017” sipas formatit 3/2 të bilancit rezultojnë se Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se në bilancin kontabël (Formati 3/2), në llogarinë ekonomike 720 “Grant korrent i brendshëm” është vënë shuma 380,546,294 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “Grant nga organizma ndërkombëtare” pasqyrohet me vlerën 55,420,627 lekë në PASH ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 21,393,403 lekë. Ky veprim i regjistrimit të këtyre dy zërave si sponsorizime në pasqyrat e bilancit është e gabuar.

Ky observacion nuk merret në konsideratë

Sikundër jemi shprehur më lartë, nga analiza e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, rezultojnë se me 31.12.2018 ajo ka të regjistruar në debi vlerën 60,480,888 lekë, e pasqyruar kjo në llogarinë 85 “Rezultat i ushtrimit” në vlerën 51,714,902 lekë dhe një diferencë prej 8,765,986 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kësaj llogarie. Pasqyrimi i këtyre fondeve në këtë llogari për 51,714,902 lekë e denatyrton kuptimin e kësaj llogarie dhe nga sektori financiar si kundërparti duhet të ishin llogaritë e klasës së 4-rt, kjo bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njëjve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar, që përcakton detyrimin e rakordimit të debisë së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”, (ku janë të kontabilizuar të gjitha autorizimet buxhetore si dhe shtesat apo paksimet e bëra gjatë vitit), me kundër parti llogarinë 476 “të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

INSTAT **nuk ka arritur ti shfrytëzoj** të gjitha mjetet nga grantet dhe subvencioni, përkatësisht për 51,714,902 lekë. Gjykojmë të nevojshme rikonsiderimin dhe përdorimin e këtyre shumave. Konkluzioni është se nuk është arritur të realizohen objektivat lidhur me përdorimin e disa fondeve, pavarësisht faktit se kishte mjete në dispozicion për qëllime të caktuara.

REGJISTRIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME TË INSTAT NË ZVRPP.

Për periudhën objekt auditimi, pra nga viti 2017 e në vijim, në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të INSTAT, është vepruar si më poshtë vijon:

Në bazë të VKM nr.878 datë 17.12.2014 : “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve për INSTAT” i është kaluar kati i katërt me sipërfaqe 748.8m² dhe mjediseve rrethuese të godinës nr.2 të ish Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme.

Specifikohet se ngarkohet INSTAT dhe Krye-regjistruesi i PP për zbatimin e këtij vendimi.

Njëkohësisht me VKM nr.542, datë 09.08.2006 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve për INSTAT” i është kaluar në administrim kati i dytë dhe i tretë (pa specifikuar sipërfaqen).

Përmes Urdhrit të përbashkët për kalim kapital të aktiveve pa pagesë, është kryer dorëzimi i ambienteve cituar në VKM nr.878 datë 17.12.2014 me vlerë totale 99,018,247 lekë, si dhe i materialeve dhe pajisjeve shoqëruese të godinës me vlerë fillestare 28,762,779 lekë.

Konstatim:

Nga ana e INSTAT nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohet ZVRPP regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit.

Sa më sipër, në kushtet që nga ana e INSTAT nuk ka nisur asnjë procedurë për regjistrimin e marrjes së aktit në përdorim të pasurisë dhe kufijvetë kësaj pasurie të paluajtshme në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Ndërtesa që INSTAT disponon është regjistruar në kontabilitet, në bilancin kontabël të datës 31.12.2018 me vlerën që i është vendosur në Urdhrin e kalimit kapital, por nuk kemi informacion nëse kjo pronë është e regjistruar në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjithashtu për të nuk zotërohet Akti i marrjes në përdorim, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.

Nga auditimi, nuk arritëm të sigurojmë informacion nëse përcaktimi i vlerës së tokës është kryer Bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 961).

Titulli i Gjetjes 8:	Analizë e inventarizimit të pronës shtetërore
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e INSTAT është zbatuar pjesërisht detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nuk është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, nuk janë dërguar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP) listat e inventarit, për t’iu dërguar më tej për miratim Këshillit të Ministrave. Nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohet AITPP, regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Gjithashtu konstatohet se, nuk është finalizuar procesi i miratimit të listës së pronave dhe nuk është vijuar me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP. Sa më sipër, në kushtet që nga ana e INSTAT nuk ka nisur asnjë procedurë për regjistrimin emarrjes së aktit në përdorim të pasurisë dhe kufijvetë kësaj pasurie të paluajtshme në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Ndërtesa që INSTAT disponon është regjistruar në kontabilitet, <u>në bilancin kontabël të datës 31.12.2018</u> me vlerën që i është vendosur në Urdhrin e kalimit kapital, por nuk kemi informacion nëse kjo pronë është e regjistruar në inventarin e shtetit pranë Zyrës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

	<u>Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjithashtu për të nuk zotërohet Akti i marrjes në përdorim, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.</u> Nga auditimi konstatohet se, nga ana e INSTAT nuk janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që ky institucion ka në dispozicion, plani i rievimit (kadastral dhe topografik), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk arritëm të sigurojmë informacion nëse përcaktimi i vlerës së tokës është kryer Bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. (Trajtuar më hollësisht në faqen 46 të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	<i>Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar Ligji nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.</i> <i>VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mungon gjurma e auditimit për mënyrën e sigurimit të kësaj pasurie, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, si dhe mungon saktësimi i listës së pronave dhe vijimi me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave. Mungesë sigurie nëse përcaktimi i vlerës së tokës pasqyron situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.
Shkaku:	Mosndjekje e hapave dhe për pasojë mospërfundim i procesit.
Rëndësia:	E mesme

Të tjera nga pasqyrat financiare.

INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE, VLERËSIMI, NXJERRJET JASHTË PËRDORIMIT DHE ASGJESIMI I AKTIVEVE:

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë për aspektet e menaxhimit dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, kjo çështje është audituar për periudhën 2017-2018. Në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 30 që formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Mirëpo, ky regjistër duhet të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, ku kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Inventarizimi i vitit 2017:

Nga ana e INSTAT janë ngrit komisionet për vlerësimin e aktiveve me Urdhër të Brendshëm:

- nr.16 datë 26.12.2017, me përbërje Z.K. Sh, Znj L. B dhe Znj.H .M, me Urdhër të Brendshëm nr.8 datë 03.08.2017 me përbërje Znj.Zh .C, Znj.K .D dhe Z.O. H pasuar me dy Urdhra të tjerë
- nr.11 datë 18.09.2017 për ndryshim të anëtarit O. H me Z.M. Sh



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- nr.10 datë 06.09.2017 ndryshim të anëtarit K.Dme Z.D. Gj.

Është ngritur komision për asgjësimin e disa pajisjeve dhe materialeve të zyrave me Urdhër protokolluar me 1647/1 prot dhe datë 05.01.2018. Mbështetur mbi këta urdhëra vlera e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në fund të vitit 2017 rezulton të jetë 32,499,145 lekë.

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me shkresën nr. 1088/3 prot, datë 24.11.2017 është hartuar raporti mbi invenatrin e kryer në institucion, ku është realizuar inventarizimi i gjendjes faktike të materialeve në cdo zyrë krahasuar me kartelën e inventarit. Në raport specifikohet se në përgjithësi invenatri ka dal në rregull me disa përjashtimepo ashtu specifikohets se:

Në shumë zyra ka materiale të cilat pretendohet se janë jashtë funksionit dhe ne mendojmë se duhet te nxirren jashtë përdorimit nga një komision i posacëm pasi të vërtetohet funksionimi i tyre (lipas listës bashkangjitur) por ndërkohë lista bashkangjitur përmban materialet të cilat kanë dal jashtë përdorimit, si dhe kjo listëështë jo e plotë pasi përmban si të dhëna vetëm: Emër, mbiemër, copë artikulli dhe cmim.

Inventarët janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

E njëjta gjë vlen edhe për të konsoliduarin, në raportin mbi invenatrin e kryer në rrethe bashkangjitet lista e artikujve vtë nxjerrë jashtë përdorimit dhe jo një listë mbi gjendjen e tyre përpara nxjerrjes jashtë përdorimit.

- Me datën 04.01.2018 është hartuar procesverbali për vlerësimin e aktiveve.

Sipas këtij proces verbali janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi 88 artikuj me vlerë 22,651,499 lekë nga të cilat, AQT 61 artikuj me vlerë 20,656,400 lekë, 3 artikuj licenca me vlerë 1,084,512 lekë të cilave ju ka kaluar koha e skadencës dhe janë djegur dhe 24 artikuj aktive qarkulluese me vlerë 910,587 lekë të cilave ju ka kaluar koha e përdorimit dhe janë të dëmtuar. Në këto artikuj peshën më të madhe e zënë canta laptopi dhe 26 tonera me vlerë 178,929 lekë rë cilave ju ka kaluar koha e përdorimit. Bahkangjitur proces verbalit është lista e materialeve të vlerësuara sipas magazinave, por sikundër më lart nuk është në përputhje me Udhëzimin 30.

- Me datën 11.01.2018 është hartuar nga Komisioni i Asgjësimit të Pajisjeve dhe Materialeve, në tëspecifikohet se këto artikuj sipas listës së dorëzuar nga komisioni janë asgjësuar. Përmes copëtimit, deformimit dhe kthimit në gjendje të paidentifikueshme.

Sa më sipër, mungon lista, janë prezente vetëm disa foto të artikujve përpara asgjësimit por asnjë evidencë pas apo gjatë tij.

- Me datën 12.01.2018 është dërguar për zbatim Drejtorisë së Financës dhe shërbimeve mbështetëse urdhri për kontabilizimin e rezultateve të inventarizimit.

Referencat e vëna në këto urdhra administrativë mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita në fuqi, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, mirëpo nga analiza e praktikave të mësipërme rezulton se nuk zbatohen siç duhet dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në lidhje me mjetet e transportit grupi i auditimit ka konstatuar se:

- Me Urdhër të brendshëm, nr. 255 prot, dt 14.02.2017 është ngrit Komisioni i inventarizimit të automjeteve.

Përbërë nga Z.L.B, Z.O.H dhe Z.E.T. Janë hartuar procesverbalet në përputhje me Udhëzimin 30, kartelat e inventarit si dhe raporti i ekspertit mbi gjendjen e automjeteve.

Proces Verbali me datë 17.02.2017 i hartuar nga komisioni i inventarizimit shprehet mbi verifikimin e kryer mbi të 7 automjetet dhe rezulton si më poshtë vijon:

Tipi Autoveturës	Targa	Viti prodhimi t	Dalin nga përdorimi	Gjendje
Ford Everest	TR3492T	2009		X
Toyota Land Cruiser	TR2617R	2006		X
Hyundai Tuscon	TR5259N	2007		X



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Land Rover Discovery	TR7675	1996	X	
Opel	TR6310E	2005	X	
Opel Frontera	TR0151A	1996	X	
Ford Mondeo	TR3718L	1998	X	

- Me Urdhër nr.255/1 prot, dt 21.02.2017 është urdhëruar nxjerrja jashtë përdorimit e automjeteve si më poshtë paraqitet, si dhe shkarkimi i vlerës prej 12,217,027 lekë nga kontabiliteti.

Ford Mondeo, me targë TR.....;

Opel, me targë TR.....;

Opel Frontera, me targë

Land Rover Discovery, me targë.....

Nr	Dokumenti	Komisioni	Vlera e aktivitet (lekë)	
			Vlera e Aktiveve sipas inventarit	Nga kjo: Jashtë funksionit
I.	Procesverbal i inventarizimit, datë 17.02.2017	1.L.B 2.O.H 3.E.T	20,630,352	12,217,027
II.	Procesverbal i nxjerrjes jashtë përdorimit	Mungon		
		Përmbledhje		

Nga auditimi u konstatua se, përse i përket automjeteve, në procesverbalin e inventarizimit janë vlerësuar të 7 automjet që disponon institucioni, nga të cilat 3 janë ende funksional dhe 4 janë nxjerrë jashtë përdorimit. Procesverbal mbi gjendjen teknike të tyre është mbajtur prej ekspertit të fushës, Ing.A.S. Në vitin 2013 janë nxjerrë në ankand 2 prej tyre Ford Mondeo dhe Opel Frontera por nuk ka patur ofertues. Për automjetin Land Rover Discovery nga ana e servisit janë dhënë dy opsione, i pari është riparim i motorrit me një kosto 238,000 lekë dhe i dyti blerja e një motorri të përdorur me kosto 150,000 lekë por komisioni bazuar në gjendjen e amortizuar dhe koston teper të lartë për ta rikthyer në punë vendosi nxjerrjen jashtë përdorimit.

Më datë 07.12.2017, është paraqitur kërkesë nga ana e INSTAT për zhvillimin e ankandit publik për shitjen e dy automjeteve:

- 1.“Opel” tipi Fuoristradë Frontiera, me targë TR0151A, me fuqi motorike 1900 cc, me vit prodhimi 1996;
- 2.“Ford Mondeo”, me targë TR3718L, me fuqi motorike 1800 cc, me vit prodhimi 1998;

Bazuar në shkresën Nr. 1617 Prot., datë 21.12.2017, është ngritur urdhri për ngritjen e komisionit të ankandit publik me objekt “Shitje e dy automjeteve në pronësi të INSTAT”, ku janë përcaktuar emrat e anëtarëve të Komisionit, vlera fillestare e ankandit dhe lloji i procedurës së ankandit. Janë hartuar dokumentat e ankandit dhe Formulari i Njoftimit të Ankandit është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Më datë 15.02.2018, është hapur procedura e ankandit dhe ka rezultuar që nuk ka marrë pjesë asnjë ofertues. Në këto kushte, bazuar në VKM Nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”, të ndryshuar, procedura e ankandit publik me objekt “Shitje e 2 (dy) automjeteve në pronësi të INSTAT”, është anuluar.

Bazuar në faktin që automjetet nuk janë shitur në Ankand si dhe në procesverbalin e Komisionit të Inventarizimit dhe Vlerësimit është sugjeruar që automjetet e dala jashtë përdorimit të shiten për skrap pas vlerësimit nga një ekspert i licencuar, referuar dhe faktit që ka shpenzime shtesë për transportin dhe asgjësimin e tyre.

Referuar Regjistrimit të Parashikimeve 2020, është kërkuar nga ana e institucionit një ekspert i licencuar për të parashikuar vlerën fillestare të ankandit për shitjen e automjeteve të dalë jashtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

përdorimit për skrap. Eksperti është kërkuar për faktin se, përveçse peshimit të lëndës hekur, automjetet kanë edhe lëndë të ndryshme përbërëse (bakër, alumin etj.), të cilat kanë çmime të ndryshme.

Aktualisht këto automjete vazhdojnë të jenë në hapsirën e INSTAT.

Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit dhe të vepronin konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011, si për: *procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; procesin verbal të vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme*, duke marrë si reference paragrafin 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrit të Financave.

Konkretisht, nga shqyrtimi i praktikave të disponuara mbi mjetet e transportit dhe situatën e aktiveve në magazinë, rezulton si vijon:

Nr	Dokumenti	Komisioni	Vlera e aktivitetit (lekë)	
			Vlera e Aktiveve sipas inventarit	Nga kjo: Jashtë funksionit
I.	Procesverbali i inventarizimit, date 04.01.2018	1.K.Sh 2.L. B 3.H. M	22,651,523	22,651,499
II.	Procesverbali i asgjësimit, date 11.01.2018	1.A.C 2.A. Q 3.A.I 4.M K 5.I. D		
		Përmbledhje		

Burimi: përpunuar nga grupi i auditimit

Titulli i Gjetjes 11:	<i>Analizë mbi mjetet e transportit</i>
Situata:	Nga auditimi i mjeteve të transportit, u konstatua se, prej vitit 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 (katër) automjete. Në vitin 2018 janë nxjerrë në ankand 2 prej tyre Ford Mondeo dhe Opel Frontera por nuk ka patur ofertues. Për automjetin Land Rover Discovery nga na e servisit janë dhënë dy opsione, i pari është riparim i motorrit me një kosto 238,000 lekë dhe i dyti blerja e një motorri të përdorur me kosto 150,000 lekë por komisioni bazuar në gjendjen e amortizuar dhe koston teper të lartë për ta rikthyer në punë vendosi nxjerrjen jashtë përdorimit. Aktualisht këto automjete vazhdojnë të mbahen në hapsirën e INSTAT. (Trajtuar më hollësisht në faqet 47-49 të Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	<i>Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"</i>
Ndikimi/Efekti:	Mbajtja e tyre riskon që të bëhen të papërdorshme edhe shitjen për skrap apo pjesë. Përveç faktit që ka shpenzime shtesë për transportin dhe asgjësimin e tyre duke qenë se janë të palëvizshme.
Shkaku:	Procedura të tejzgjatura
Rëndësia:	E mesme

Inventarizimi i vitit 2018:

Nga ana e INSTAT janë ngrit komisionet për vlerësimin aktiveve me Urdhër të Brendshëm nr.36 datë 10.12.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Me Urdhër të Brendshëm, protokolluar me nr.1475 prot, datë 28.09.2018, pika 6 e tij specifikon përbërjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në zyrat rajonale me 3 anëtar, dhe pika 5 e tij specifikon përbërjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për Drejtorinë e Përgjithshme me Z.A.B, Z.E. M dhe Znj.A.D

Me shkresë nr.1475/2 datë 24.12.2018 është Urdhëruar ngritja e komisionit të asgjësimit të disa pajisjeve dhe materialeve të zyrave Instat, me përbërje: L.L, G. H, A.Xh, A. N, O.H

Me shkresë nr.1475/3 datë 31.12.2018 është Urdhëruar kryerja e kontabilizimit të rezultateve të inventarizimit.

Mbështetur mbi këta Urdhëra është shkarkuar nga kontabiliteti shuma 17,362,325.39 lekë, ku për Aparatin Qendror shuma 16,573,331 lekë është përbërë nga:

- 41 artikuj AQT me vlerë 15,832,308 lekë
- 28 artikuj aktive qarkulluese me vlerë 741,023 lekë

Procedura e ndjekur nga komisionet respektive është si vijon:

- Me anë të proces-verbalit të datës 19.11.2018 është hartuar raporti mbi inventarin e kryer në Drejtorinë e Përgjithshme, ku është realizuar inventarizimi i gjendjes faktike të materialeve në cdo zyrë krahasuar me kartelën e inventarit. Në raport specifikohet se në përgjithësi inventari ka dalë në rregull me disa përjashtime, po ashtu specifikohet se:

...por ka aktive mjaft të konsumuara por për shkak të nevojës nuk propozohet të nxirren jashtë përdorimit...

Komisioni propozon nxjerrjen jashtë përdorimit të 142 artikujve me vlerë 19,160,048 lekë nga të cilat, 18,419,025 lekë AQT dhe 741,023 lekë AQ (lipas listës bashkangjitur) por ndërkohë lista bashkangjitur përmban materialet të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, dhe jo një kopje të plotë të inventarit të kryer, si dhe kjo listë është jo e plotë pasi përmban si të dhëna vetëm: Emër, mbiemër, copë artikulli dhe cmim.

Listat e artikujve të propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit janë nënshkruar rregullisht nga komisioni dhe personat përgjegjës.

E njëjta gjë vlen edhe pasqyrat financiare të konsoliduara, në raportin mbi inventarin e kryer në rrethet bashkangjitet lista e artikujve të nxjerrë jashtë përdorimit dhe jo një listë mbi gjendjen e tyre përpara nxjerrjes jashtë përdorimit.

- Me datën 21.12.2018 është hartuar procesverbali për vlerësimin e aktiveve.

Sipas këtij proces verbal janë propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi 69 artikuj me vlerë 17,314,354 lekë nga të cilat, AQT 41 artikuj me vlerë 16,573,331 lekë dhe 28 artikuj aktive qarkulluese me vlerë 741,023 lekë të cilave ju ka kaluar koha e përdorimit dhe janë të dëmtuar. Bashkangjitur proces verbalit është lista e artikujve të vlerësuar për mosnxjerrje jashtë përdorimit, dhe jo një listë e plotë me artikujt e vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit, dhe këto dokumenta nuk janë hartuar në përputhje me Udhëzimin 30.

- Me datën 24.12.2018 është hartuar nga Komisioni i Asgjësimit të Pajisjeve dhe Materialeve, në të specifikohet se këto artikuj sipas listës së dorëzuar nga komisioni janë asgjësuar përmes copëtimit dhe deforimit.

Sa më sipër, mungon lista dhe nuk ka asnjë gjurmë të këtij procesi. (asnjë evidencë pas apo gjatë këtij procesi).

- Me datën 31.12.2018 është dërguar për zbatim Drejtorisë së Financës dhe shërbimeve mbështetëse urdhri për kontabilizimin e rezultateve të inventarizimit.

Referencat e vëna në këto urdhra administrative mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, janë dispozita në fuqi, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, mirëpo nga analiza e praktikave të mësipërme rezulton se nuk zbatohen siç duhet dispozitat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të njësisë, pas auditimit të dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit u



konstatua: *gjurmë jo e plotë e auditit përsa i përket procesit të asgjësimit*, në dosje nuk kishte evidencë të materialeve të cilat do të asgjësoheshin dhe as të procesit të kryerjes. Në procesverbal specifikohet se mënyra e kryerjes së asgjësimit ishte nëpërmjet copëtimit në pjesë të vogla dhe deformimit por mungonin provat justifikuese sikundër e kërkon pika 122 e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011.

Vet procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë nuk është kryer në përputhje me pikat 95 dhe 102 të Udhëzimit 30. Gjatë auditimit u konstatua se lista e materialeve për dalje jashtë përdorimi ishte hartuar vetëm me kredencialet e punonjësit (emër/mbiemër), emërtim të materialit, numrin e tij, vleftën dhe cmimin por jo në përputhje me pikën 95 të Udhëzimit 30 i cili specikon se: Procesi duhet kryer mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim. Po ashtu në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit të licencave nuk specifikohet jetëgjatësia e tyre mbi bazën e së cilës duhet të kryhet procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapsirës fizike në këtë të fundit. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.

Konstatime për procesin e inventarizimit të aktiveve materiale:

Në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të njësisë, pas auditimit të dokumentacionit justifikues të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit u konstatua: *gjurmë jo e plotë e auditit përsa i përket procesit të asgjësimit*, në dosje ishin prezente foto të materialeve të cilat do të asgjësoheshin, përpara procesit por jo evidence gjatë dhe pas tij. Në procesverbal specifikohet se mënyra e kryerjes së asgjësimit ishte nëpërmjet copëtimit në pjesë të vogla, deformimit dhe kthimit në gjendje të paidentifikueshme por mungonin provat justifikuese sikundër e kërkon pika 122 e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011.

Vet procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë nuk është kryer në përputhje me pikat 95 dhe 102 të Udhëzimit 30. Gjatë auditimit u konstatua se lista e materialeve për dalje jashtë përdorimi ishte hartuar vetëm me kredencialet e punonjësit (emër/mbiemër), emërtim të materialit, numrin e tij, vleftën dhe cmimin por jo në përputhje me pikën 95 të Udhëzimit 30 i cili specikon se: Procesi duhet kryer mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim. Po ashtu në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit të licencave (konkretisht për vitin 2017 janë 3 licenca me vlerë 1,084,512 lekë IBM-SPSS, Watch Guard dhe Adobe) nuk specifikohet jetëgjatësia e tyre në bazë të së cilës duhet të kryhet procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapsirës fizike në këtë të fundit. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive. Detajuar problematikat si më poshtë vijon:

1. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, pasi nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Nuk ka një evidentim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

2. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2017 nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, (ekziston një informacion, që nuk është në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

përputhje me detyrimet e UMF nr. 30/2011), në kundërshtim me *paragrafin* nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që përcakton se komisioni duhet:

“Të përpilojë një raport lidhur me:

- *inventarizimin fizik të aktiveve,*
- *për kushtet e ruajtjes së tyre,*
- *gjendjen fizike dhe për*
- *vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara,*
- *për shkaqet e tyre dhe*
- *personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”.*

Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.

3. Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30, që përcakton se *“ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”,* gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.

Si mangësi në pamje të parë për realizimin e këtij inventarizimi rezulton se komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj,

4. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* që sanksionon se, Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kritereve :

- a. *kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;*
- b. *kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;*
- c. *kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit,*
- d. *kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktiviteti të ngjashëm.*
- e. *kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;*
- f. *kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;*
- g. *kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;*
- h. *kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.*

5. Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit dhe të vepronin konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011, si për: *procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; procesin verbal të vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme, duke marrë si reference paragrafin 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrit të Financave.

6. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapsirës fizike në këtë të fundit.

7. Po ashtu nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.

Titulli i Gjetjes 9:	Analizë mbi procesin e inventarizimit të aktiveve materiale
Situata:	Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit të aktiveve materiale u konstatua se: 1. Procedurat e inventarizimit janë zhvilluar për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara (Inventar Ekonomik, pajisje dhe makineri, mobilie, etj) si dhe gjendjet e inventarit të magazinave (kimikate, inventari i imët, qelqurina). Nuk i janë nënshtruar procesit të inventarizimit vjetor ndërtesat, karburanti, mallrat dhe aktivet e tjera qarkulluese, mjetet e transportit, aktivet e patrupëzuara etj. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me nenin 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, 2. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, pasi nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. <u>Nuk ka një evidentim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.</u> 3. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2017-2018 nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, (egziston një informacion, që nuk është në përputhje me detyrimet e UMF nr. 30/2011), në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011’. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve. 4. Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30, që përcakton se “ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përftimi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Si mangësi në pamje të parë për realizimin e këtij inventarizimi rezultojnë se komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj, 5. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 6. Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo <u>nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit</u> po ashtu nuk është operuar konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011 duke marrë si referencë pikën 95 e vazhdim. 7. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapsirës fizike në këtë të fundit. 8. Nga auditimi rezultoj se, nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive. (Trajtuar më hollësisht në faqet 47-53 të Projekt Raportit të Auditimit).
	Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Kriteri:	<i>ndryshuar, Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i>
Ndikimi/Efekti:	Mangësi e parregullsi në kryerjen e proceduarve të inventarizimit, si dhe mospërfshirje e të gjithë elementeve të aktiveve.
Shkaku:	Moszbatim i plotë i UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”
Rëndësia:	E lartë

Observacion nga ana e subjektit

Përsa i përket gjetjes 9 sqaroj se :

Sipas Urdhërit nr.8 datë 03.08.2017 dhe nr 1475 28.09.2018 janë ngritur komisionet e inventarizimit të aktivevetë qëndrueshme të trupëzuara aktiveve të patrupëzuara dhe aktiveve qarkulluese materiale dhe objekte inventari.

Nga ana e sektorit të financës në zbatim të urdhërave të mësipërm janë nxjerrë gjendjet kontabile të aktiveve më datë 31.08.2017 dhe 30.09.2018, janë përpiluar kartelat e inventarit për çdo person përgjegjës material.

Nga ana e komisioneve të inventarizimit në zbatim të udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është bërë krahasimi i gjendjes kontabile me atë fizike, janë firmosur kartelat nga komisioni dhe personi përgjegjës material, janë përgatitur raportet e inventarizimit përkatësisht shkresa nr 1088/3 dt 24.11.2017 dhe proces verbal dt 19.11.2018 si dhe listat e materialeve që propozohen të dalin nga përdorimi.

Duhet theksuar se titulli i listës për vitin 2017 është gabim pasi duhej lista e materialeve që propozohen të dalin nga përdorimi. Kjo vërtetohet se këto lista janë firmosur nga anëtar të komisionit të inventarizimit dhe janë lista të ndryshme nga lista e materialeve të vlerësuara për të dalë nga përdorimi të cilat janë firmosur nga anëtar të komisionit të vlerësimit.

Proçesit të inventarizimit i janë nënshtruar të gjitha aktivet ndërtesa, mjete transporti, paisje inventar ekonomik, karburant etj gjë e cila provohet me kartelat e inventarit të çdo personi përgjegjës material referuar Projekt raportit tuaj faqe 47.

Sipas Urdhërit nr.16 datë 26.12.2017 dhe Urdhërit nr.36 10.12.2018 janë ngritur komisionet e vlerësimit të aktiveve që propozohen të dalin nga përdorimi sipas komisioneve të inventarizimit.

Komisionet e vlerësimit kanë bërë vlerësimin e aktiveve dhe kanë hartuar proces verbalet e përkatëse të dt 04.01.2018 dhe 21.12.2018 janë përpiluar listat e materialeve të vlerësuara për të dalë nga përdorimi si dhe materialeve që nuk do të dalin nga përdorimi.

Si kriter për vlerësimin e aktiveve është operuar në përputhje me pikat 103 dhe vijues të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

- Është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nuk mund të riparohen
- Kur riparimi i tyre është i pamundur si pasojë e konsumimit;
- Kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune;
- Kur vlera e riparimit është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm.

Nga ana e nëpunësit zbatues është përpiluar pasqyra ku jepen të dhëna për datën e hyrjes së aktivitetit sasia, cmim, vlera amortizimi i llogaritur, shpenzimet e shvlerësimit, amortizimi i akumuluar dhe vlera neto pjesë e dosjes së inventarizimit (pasqyra bashkëngjitur).

Me shkresat nr.1647/1 prot datë 05.01.2018 nr.1475/2 datë 24.12.2018 është Urdhëruar ngritja e komisionit të asgjësimit të disa pajisjeve dhe materialeve të zyrave Instat për vitin 2017 dhe 2018 të cilët kanë përpiluar procesverbalin e asgjësimit.

Me shkresë 1647/2 prot datë 12.01.2018 dhe nr.1475/3 datë 31.12.2018 është Urdhëruar kryerja e kontabilizimit të rezultateve të inventarizimit.

Nga sa më sipër institucioni ka finalizuar të gjitha proceset inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit dhe kontabilizimit të rezultateve në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të vertetuara me urdherat e mësipërm të cilat janë konstatuar dhe nga ana juaj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Pergjigje e KLSH

Mbi observacionin e gjetjes nr.9

Nuk e kuptojmë sesi një proces i cili fund e krye nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore mund të vlerësohet i rregullt. Risjellim në vëmendjen tuaj, ashtu sikundër është trajtuar gjerësisht edhe përgjatë materialit, operimin në përputhje me nenin 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Njësia duhet të ketë një evidencim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin e vlerësuar jashtëm funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj

Ky informacion duhet të vij në formën e një dokumenti ligjor në përputhje me detyrimet e përcaktuara në paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 dhe jo si një shkrim narrativ.

Vet procesi duhet të kryhet sikundër përcaktohet në paragrafin nr. 95, të UMF nr. 30, “Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfundi bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”,

Po ashtu vlerësimi i aktiveve duhet kryer sipas përcaktimeve të paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i cili sanksionon kriteret.

Ky observacion nuk merret në konsideratë

Përsa i përket pasqyrave financiare të konsoliduara të cilat janë trajtuar gjerësisht në Ankeset shoqëruese u konstatua se,

Titulli i Gjetjes 14:	Analizë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara
Situata:	Nga auditimi mbi hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2017, konkretisht Formatit nr.8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”, i cili është shprehje analitike e llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël në celje dhe përfundim të vitit ushtrimor ku lëvizjet për shtesa dhe pakësime duhet të rakordojnë me gjendjet përkatëse në bilanc dhe çdo shtesë e pakësim duhet kryer konform kërkesave të pasqyrës duke marrë të dhënat nga formatet përkatëse në Bilancin Kontabël. U konstatua mosrakordim mes dy formateve përsa i përket tepricave në celje dhe në mbyllje të llogarive respektive të fondeve, konkretisht një diferencë prej 4,500 lekë. Këto teprica duhet detyrimisht të jenë të rakorduara me të dhënat e këtyre llogarive të pasqyruara në grupin A të pasivit të bilancit kontabël. (Trajtuar më hollësisht në Aneksin nr.1 bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit).
Kriteri:	Udhëzim i Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 “Për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.14, datë 28.12.2006”.
Ndikimi/Efekti:	Mos rakordimin dhe unifikimin i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare në përputhje me kërkesat e bazës ligjore.
Shkaku:	Diferenca të ardhura si pasojë e sistemeve të kryera të cilat bëjnë që të mos kemi pasqyrim të saktë të zërave në pasqyrën financiare.
Rëndësia:	E mesme

4. VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në bazë të auditimit të kryer në terren në zbatim të pikës 4 të drejtimeve kryesore të programit të auditimit Nr.63/1, datë 21.01.2020, mbi vlerësimin e funksionit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit: a. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit, b. Vlerësimi i Menaxhimit të Riskut, c. Vlerësimi i Aktiviteteve të Kontrollit, ç. Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi.

U shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

1.Strukturat përgjegjëse të Institutit të Statistikave (INSTAT), kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në,(miratuar me urdhrin e Titullarit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010) dhe Manualin e ri, (miratuar me urdhrin e Titullarit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale janë bazuar në Strategjinë Sektoriale 2019-2021 dhe PBA 2019-2021.

Me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSAT Nr.383, datë 10.03.2017 është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Njesisë Publike për periudhën 2017-2020 dhe Gjurma e Auditimit për vitin 2017.

2.Për periudhën objekt auditimi është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitin 2017, për vitin 2018, me urdhrin e Titullarit të INSAT nr.270, datë 28.03.2018 dhe për vitin 2019 GMS është ngritur me urdhrin e Titullarit të INSAT nr. 329, datë 15.04.2019, INSAT ka është ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) për 2019. GMS shërben për të evidentuar të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, sipas përcaktimit të neneve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për MFK”. Si dhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhërin e Titullarit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

“GMS luan një rol kyç përse i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.

Me urdhrin e brendshëm të titullarit të INSAT të titullarit të kohës “ Mbi ngritjen e grupit për menaxhimin Strategjik (GMS) me nr. 1567 Prot, datë 28.12.2016 është ngritur GMS me përbërje sipa pozicioneve të punë dhe jo nominative, konkretisht: Kryetar, Drejtori i Përgjithshëm dhe Anëtar, Koordinator për Sistemin Kombëtar Statistikor, Koordinator për Cilësinë Statistikore, Drejtori i Drejtorisë së Llogarive Kombëtare, Drejtori i Drejtorisë së Statistikave Ekonomike, Drejtori i Drejtorisë së Statistikave Sociale, Drejtori i Drejtorisë së Statistikave Bujqësore dhe Mjedisit, Drejtori i Drejtorisë së IT, Drejtori i Drejtorisë së Integritetit, Koordinimit të Projekteve, Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në vitin 2019 me anë të Urdhërit të Brendshëm me nr.13, datë 17.04.2019, Për një ndryshim në urdhrin e brendshëm nr. 1567, datë 28.12.2016 “Mbi ngritjen e grupit Për menaxhimin Strategjik (GMS), me shkresën Nr. 235/1 Prot., datë 17.04.2019. Pika 2 e këtij urdhri është ndryshuar si më poshtë: Kryetar, Drejtori i Përgjithshëm dhe Anëtar Sekretar i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit.

1.Nga auditimi i kryer në lidhje me politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet e politikave vijuese të dala në zbatim të tij, konstatohet se INSAT ushtron veprimtarinë mbështetur në Rregulloren e Brendshme, miratuar me vendimin Nr. 39, datë 10.01.2017, në vitin 2018 me anë të vendimin nr.39/1Prot., datë 15.01.2018 “Për një shtesë në Rregulloren e brendshme të INSTAT-IT” është miratuar Rregullorja e brendshme, në vitin 2019 me anë të vendimit me nr. 2018/20, datë 09.07.2019 është miratuar Rregullorja e Brendshme. Në lidhje me rregulloren e brendshme të INSAT, si derivat i saj janë hartuar edhe rregullore për secilën drejtori, ku parashikohen detyrat sipas pozicioneve të punës me përshkrimet e punës.

INSAT me ane të vendimin të titullarit Nr. 390 prot., datë 13.03.2017 dhe në vitin 2019 me anë të vendimit Nr. 4, datë 24.05.2019 të titullarit me shkresën Nr.208/15prot., datë 24.05.2019, kanë miratuar Kodin e Etikës ku parashikohen rregullat e mbarëvajtjes së punës dhe masat që merren në rast të shkeljes së tyre.

2. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Financës:**

Duke përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar,

1.Nga ana e institucionit të INSAT janë përgatitur **Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm për vitin 2018.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Deklarata për cilësinë deklarate për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të ministrisë së shëndetësisë për vitin 2018, sipas shkresës nr. 1340 prot, datë 28.02.2019; dërgimit të tyre sipas Manualit të MFK është deri me datën 28 shkurt 2019. Këto akte janë nënshkruar nga SP i INSAT dhe i janë dërguar Njësisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar të Kontrollit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Janë hartuar deklarata mbi sistemin dhe raporti përkatës për cilësinë kontrolleve të brendshme për vitin 2018, deklarata e nëpunësit autorizues për cilësinë e sistemit të kontrollit, në bazë të përgjegjësi të kreut III, pika 3.3 e Manualit PMFK dhe cilësimeve të nenit 18 të ligjit nr.10296. Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është dorëzuar brenda afatit ligjor, përcaktuar në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 dhe 6, të Udhëzimit të Titullarit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se *“deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”*

Nga analiza e hollësishme e këtij dokumenti vërejmë se:

Ky raport është përgatitur nga ana e NA, në koordinim me hallkat e tjera të këtij institucioni. Është hartuar edhe plani i ngritjes dhe zhvillimit të sistemit të MFK për **vitin 2017, 2018 dhe 2019**.

Është hartuar Raporti sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbëhet nga:

- (a) Përmbledhja ekzekutive;
- (b) Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë;
- (c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i Ministrisë së linjës;
- (ç) Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan-veprimin për të ardhmen;
- (d) Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.”

Grupi i auditimit të KLSH u fokusua në realizimin e objektivave të institucionit dhe përdorimin me efektivitet të fondeve të tij, për të gjithë komponentët si “mjedisi i kontrollit”, “menaxhimi i riskut”, “aktivitetet e kontrollit”, “informimi dhe komunikimi” dhe “monitorimi”. Nga shqyrtimi i plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit rezulton se nuk është plotësuar në zbatim të plotë me formatin e miratuar pjesë e Manualit për MFK, aneksi 6 kërkesat e kapitullit V.

siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu “Procesi i Implementimit të MFK” dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Titullarit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

2.Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të INSAT, (parashikuar në pikën 8, neni 8, të ligjit nr.10296), konstatohet se, kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:

-hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të Institucionit, të planeve vjetore dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave;

-miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

-miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësi të tyre;

1. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Në institucionin e INSAT është hartuar regjistri i riskut për vitin 2018 dhe 2019 ku janë evidentuar risqet para kontrollit dhe përfshin zotëruesit e këtyre risqeve, si dhe rezultatet ndryshimeve. Konkretisht në takimin e GMS në datën 03.05. 2019 me shkresën nr. 235\6 Prot. është miratuar regjistri i rrishtit. Për çdo sektor janë përcaktuar rrishtet para dhe pas kontrolleve, masat e marra dhe ndryshimet që pas kontrollit të fundit. Por nuk është hartuar regjistri i riskut për vitin 2017.

2. Grupi i auditimit konstaton se në institucion ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i TIK. Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup), gjë që mundëson ruajtjen e një kopje të informacionit, *Konstatim:* Nga INSTAT është hartuar Rregullorja për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
3. Kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 16, të ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:

“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, INSTAT ka funksionuar në bazë të ligjit të saj organik. Fillimisht ka qenë në varësi të Kryeministrit, por nga hyrja në fuqi e ndryshimit të ligjit organin Nr. 17\2018 ky institucion është person juridik i pavarur dhe struktura organizative e INSTAT miratohet me vendim të Kuvendi. Misioni dhe vizioni i INSTAT është përcaktuar në nenin 1 të Rregullores së Brendshme.

Sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, (i ndryshuar), ka përcaktuar në kapitullin e III, detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit.

Hapi I “Organizimi i procesit”, përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme.

Konstatim:

GMS duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor lidhur me këtë, gjë e cila **nuk** është realizuar.

- Për vitin **2017** grupi i auditimit ka hartuar strategjinë e rrishtit **por nuk disponojmë takimet e GMS.**

- Për vitin **2018** dhe **2019** janë kryer takime periodike të GMS me pjesëmarrjen e anëtarëve ku janë diskutuar problematikat dhe masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes së institucionit, si dhe është hartuar regjistri i riskut.

Punonjësit e institucionit për vitin 2017, 2018 dhe 2019 kanë ndërtuar skemën e trajnimeve:

- Trajnime tek ASPA
- Trajnime jashtë vendit



Identifikimi i nevojave për stafin në lidhje me trajnimet e ardhshme, bëhet duke i dërguar me email drejtorëve të drejtorive ku secili paraqet nevojat e stafit që ka në varësi, tek përgjegjësi i BNJ.

Konstatohet se:

*Në listat e trajnimeve të realizuara, nivelet menaxheriale **nuk kanë zhvilluar trajnime të dedikuara** mbi njohuritë për menaxhimin financiar dhe kontrollin, për vitin 2017, 2018 dhe 2019. Madje grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion planet vjetore të miratuara për periudhën objekt auditimi.*

b. Etika personale dhe profesionale.

Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e brendshme dhe ate te personelit, ku ka disa zera te rregullores se etikë për INSTAT, Nga ana tjetër, në lidhje me zbatimin e Parimit 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”, dhe se “Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë” hartuar sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, konstatohet se nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e INSTAT këto norma janë përcaktuar në Kodin e Etikës, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “ a” dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

c. Struktura organizative.

Për periudhën e audituar (2017- 2018- 2019), si bazë ka shërbyer VKM nr. 28 datë 08.03.2017, për miratimin e strukturave organizative, i cili është ndryshuar me VKM nr.127/2018.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre sipas kuadrit ligjor mbi funksionet dhe pozicionet e punës, kurse një pjesë e tyre rekrutohen për periudha nga 1 deri në 12 muaj me kontrata të përkoshme për periudhat e anketimeve. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se funksionet dhe punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo Titullari i INSTAT.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës.

Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, ka përcaktuar në kreun II, faqe 21 në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

- *Një procedure transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;*
- *Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;*
- *Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;*
- *Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;*

Njësia ka programin buxhetor, drejtues i të cilit është Titullari i institucionit, që është dhe nëpunësi autorizues. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit

Nga ana e kësaj njësie publike për vitin 2017 – 2018- 2019, rezulton të jenë kryer vlerësime vjetore të punës për punonjësit për periudha 6 mujore, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në



përputhje me përcaktimet e rregullores së brendshme. Procesi i përshkrimit dhe vlerësimit të punës për çdo pozicion në INSTAT bazohet në nenin 26, të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim Bordin Nr.5, datë 09.07.2019 “Për miratimin e rregullores së Brendshme të INSTAT”. Kjo rregullore është formati i përditësuar i rregullores së brendshme të më parshme të miratuar me anë të vendimit të Titullarit Nr. 39 Prot., datë 10.01.2017.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale INSTAT ka një plan vjetor të trajnimeve por jo në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në vitin 2018 është miratuar strategjia e trajnimeve 2018-2020

Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikas nr. 3/1, nënçështja “Politikat dhe praktikatat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016, (fq. 26).

Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime për gjithë stafin menaxhues në drejtim të drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimit të fondeve publike së njësive menaxhuese.

2.Vlerësimi i riskut (a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analiza etj).

- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezultoi se në institucionin e INSTAT, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, është përditësuar regjistri i risqeve.

3.Aktivitetet e kontrollit: (a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plotë, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në INSTAT proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e institucionit.

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).

Titullari i INSTAT, shefat e sektorëve dhe NZ i njësive zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Në rregulloren e brendshme të INSTAT apo edhe të secilës drejtori nuk parashikohet shprehimisht rruga që ndiqet për informimin që përgjegjësit e sektorëve i bëjnë Titullarit me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme.

I vetmi dokument që e ka raportimin nga përgjegjësi tek titullari është përshkrimi i punës të përgjegjësit të sektorit.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkrese zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Sistemi i IT-së, është i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ripërfitimin e tyre, në rast aksidenti për të gjitha informaciont që Instituti Statistikave gjeneron.

5. Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuar se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).

Në INSTAT është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë.

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paraINSTATafi 257, nënpika 63 “Raportet e monitorimit”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku shprehimisht përcaktohet që: “Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.

Titulli i Gjetjes:	Mbi mos zbatimin e detyrimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata:	- Në rregulloren e brendshme të INSTAT apo edhe të secilës drejtori nuk parashikohet shprehimisht rruga që ndiqet për informimin që përgjegjësit e sektorëve i bëjnë Titullarit me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. - Nuk janë bërë pjesë e planit të trajnimeve temat në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Kriteri:	- pikas nr. 3/1 , nënçështja “Politikat dhe praktikak që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016, (fq. 26). -Ligji nr.10-296-datë-8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 23, pika 2
Ndikimi/Efekti:	- Mund të riskoj mungesën e rakordimit dhe bashkëpunimit midis hallkave. -Mosnjohja e të gjithë stafit me çështjet e menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Shkaku:	-Mungesa e parashikimit të në rregulloren e brendshme të raportimit nga poshtë lartë. -Kjo ka ndodhur si mungesë e planifikimit të temave referuar menaxhimit financiar dhe kontrollin.
Rëndësia:	I mesëm

VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM.

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara. Auditimi i përputhshmërisë me Ligji nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Nga auditimi rezultoi se përgjatë vitit 2017 – 2019 kjo strukturë rezulton ende e pa plotësuar me burime njerëzore. Kjo stukturë gjithmonë është parashikuar me tre punonjës , me përbërje (1(një) përgjegjës sektori të auditimit dhe 2 (dy) auditues). Kështu për rrjedhojë, sektori i auditimit të brendshëm përbëhet nga një përgjegjës dhe një specialist.

Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave

-Nga auditimi u evidentua se në muajin tetor të vitit paraardhës janë hartuar planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm që do realizohen për vitin pasardhës, duke marrë miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për vitet 2017,2018 dhe nga Zëvendës Kryetare e Bordit për vitin 2019 dhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave.

Kjo në përputhje me

- ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, gërma d, është dërguar në DHAB “Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm të INSTAT, periudha 2019 – 2021” me shkresën nr. 1397/1, datë 17.10.2018; “Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

- brendshëm të INSTAT, periudha 2020 – 2022” me shkresën nr. 1871/1, datë 18.10.2018; “Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm të INSTAT, periudha 2019 – 2021” me shkresën nr. 1397/1, datë 17.10.2018;
- 1. Nga INSTAT është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm “Raportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të INSTAT” me nr. shkresë 1265/1, datë 14.02.2018 “Për raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2017 dhe evidencat përkatëse”, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14 gërma ç.
 - 2. “Raportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të INSTAT për vitin 2018” me nr. shkresë 313, datë 18.02.2018 “Për raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2018 dhe evidencat përkatëse”, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14 gërma ç.
 - 3. “Raportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të INSTAT për vitin 2019” me nr. shkresë 56/1, datë 06.02.2018 “Për raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2019 dhe evidencat përkatëse”, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14 gërma ç.

Raportimet janë dërguar brenda afateve kërkuara dhe janë sipas kërkesave dhe metodologjisë së kërkuar nga DHAB.

Me miratimin e ligjit 114/2015 të “Auditimit të Brendshëm për Sektorin Publik”, sektori i auditimit ka hartuar kartën e auditimit me nr.1383 prot, datë 10.09.2018 Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, një kopje i është dërguar gjithashtu edhe Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm .

Nga auditimet e realizuara NJAB e INSTAT vihet re se ka rënie të numrit të planifikimit është në rënie për arsye të mungesës së theksuar të burimeve njerëzore.

Struktura e INSTAT ka në varësi dhe zyrat rajonale (Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Dibër, Durrës; Vlorë, Fier, Kukës, Berat, Gjirokastrë.)

Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm .

Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:

Në vitin 2017, sektori i auditimit të brendshëm planifikoi të realizonte 7 auditime. Gjatë kësaj periudhe sektori i auditimit të brendshëm ka kryer 6 auditime:

5 auditime të përputhshmërisë;

1 auditim performance;

1 auditim i kombinuar

Njësia e Auditimit të brendshëm në INSTAT është e organizuar në Sektor me strukturë të miratuar 1, përgjegjës dhe 2, specialistë (1+2); gjatë vitit 2017 ky sektor ka funksionuar me një specialist dhe një përgjegjës.

Auditimet janë planifikuar pranë zyrave rajonale dhe drejtorive në INSTAT.

Për vitin 2017 janë dhënë nga sektori i auditimit të brendshëm 38 rekomandime ku:

- ✓ 17 rekomandime për përmirësimin e sistemeve;
- ✓ 11 rekomandime që synonin përmirësim organizativ
- ✓ 10 rekomandime të natyrave të tjera

Për periudhën Janar – Dhjetor 2017, Sektori i Auditimit të Brendshëm i INSTAT ka kryer auditime të përputhshmërisë në lidhje me përdorimin e fondeve, monitorimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe realizimin e auditimeve të performancës të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për INSTAT në drejtim të realizimit të objektivave në mënyrë sa eficiente dhe efektive nga personeli i tij



-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2017 janë audituar 5 dosje të realizuara në zyrat rajonale Vlorë, Gjirokastrë dhe Shkodër Elbasan, Durrës ku rezulton se nga, NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

-Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i Përgjegjës të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bëjë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

Në vitin 2018, sektori i auditimit të brendshëm planifikoi të realizonte 10 auditime. Gjatë kësaj periudhe sektori i auditimit të brendshëm ka kryer 7 auditime:

6 auditime të përputhshmërisë;

1 auditim performance;

Njësia e Auditimit të brendshëm në INSTAT është e organizuar në Sektor me strukturë të miratuar 1, përgjegjës dhe 2, specialistë (1+2); gjatë vitit 2018 ky sektor ka funksionuar me një specialist, ndërsa gjatë gjashtë muorit i dytë kjo strukturë u kompletua.

Auditimet janë planifikuar pranë zyrave rajonale (Durrës, Elbasan, Shkodër, Gjirokastrë dhe Vlorë) dhe drejtorive të statistikave në INSTAT (Drejtoria e statistikave ekonomike, Drejtoria e mbledhjes së të dhënave, Drejtoria e Integ. Evrop, koordinimit të projekteve dhe publikimeve, Drejtoria e Finances dhe Shërbimeve mbështetëse).

Për vitin 2018 janë dhënë nga sektori i auditimit të brendshëm 32 rekomandime ku:

- ✓ 4 rekomandime me nivel të ulët;
- ✓ 25 rekomandime me nivel të mesëm
- ✓ 3 rekomandime me nivel të lartë

Për periudhën Janar – Dhjetor 2018, Sektori i Auditimit të Brendshëm i INSTAT u orientua drejt përmbushjes së objektivave prioritare të programin vjetor të vitit 2018, hartuar në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të brendshëm si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Programit Strategjisë për periudhën 2018-2020.

Një nga synimet kryesore gjatë sigurimit të cilësisë ka qenë monitorimi nëse auditimet kanë qenë me integritet, objektivitet, kofindencialitet dhe me kompetencë nga grupi i auditimit. Rishikimi i cilësisë është bërë nga audituesit dhe përgjegjësi i sektorit, ky veprim bie në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”; neni 14, pika,iii.

-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2018 janë audituar 7 dosje të realizuara në zyrat rajonale Korçë, Dibër, Fier, Kukës, Drejtoria e Integritetit dhe Koordinimit të Projekteve, Sektori i Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ku rezulton se nga, NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

-Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i Përgjegjës të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bëjë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

Në vitin 2019, sektori i auditimit të brendshëm planifikoi të realizonte 8 auditime. Gjatë kësaj periudhe sektori i auditimit të brendshëm ka kryer 6 auditime:

4 auditime të përputhshmërisë;

1 auditim performance;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

1 auditim financiar

Njësia e Auditimit të brendshëm në INSTAT është e organizuar në Sektor me strukturë të miratuar 1, përgjegjës dhe 2, specialistë (1+2); gjatë vitit 2019 ky sektor ka funksionuar me një specialist, dhe një përgjegjës.

Auditimet janë planifikuar pranë zyrave rajonale (Gjirokastrë, Vlorë, Berat dhe Lezhë) dhe drejtorive në INSTAT (Koordinatori për Sistemin Kombëtar Statistikor, Drejtoria e Financës dhe Projekteve Auditimi i Fondeve Ipa dhe Drejtoria e Statistikave Sociale).

Për vitin 2019 janë dhënë nga sektori i auditimit të brendshëm 71 rekomandime ku:

- ✓ 13 rekomandime me nivel të ulët;
- ✓ 43 rekomandime me nivel të mesëm
- ✓ 15 rekomandime me nivel të lartë

Për periudhën Janar – Dhjetor 2019, Sektori i Auditimit të Brendshëm i INSTAT u orientua drejt përmbushjes së objektivave prioritare të programin vjetor të vitit 2019, hartuar në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të brendshëm si dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Programit Strategjisë për periudhën 2019-2021.

Një nga synimet kryesore gjatë sigurimit të cilësisë ka qenë monitorimi nëse auditimet kanë qenë me integritet, objektivitet, kofindencialitet dhe me kompetencë nga grupi i auditimit. Rishikimi i cilësisë është bërë nga audituesit dhe përgjegjësi i sektorit, ky veprim bie në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”; neni 14, pika,iii.

-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2018 janë audituar 6 dosje ku rezulton se nga, NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

-Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i Përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

Titulli i Gjetjes 1:	<i>Auditimi i Brendshëm</i>
Situata:	Në Institucionin INSTAT rezultoi se, sektori i auditimit është një strukturë jo e plotë me burime njerëzore dhe si rrjedhojë numri i auditimeve është ulur, duke mos plotësuar me auditim të gjitha subjektet dhe drejtoritë me risk. Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/Efekti:	Mos mbulimi i të gjitha fushave me risk dhe mos rritja e frekuencës së angazhimeve të auditimit.
Shkaku:	Vendet vakante në Sektorin e Auditimit të Brendshëm
shRëndësia:	I mesëm

NË PËRFUNDIM PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES REKOMANDOJMË MARRJEN E MASAVE SI MË POSHTË:

1. Gjetje nga auditimi: Në raportet e monitorimit u konstatua se mungon relacioni shpjegues në lidhje me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, si në nivel me te detajuar dhe artikulli. Mungon një analize e detajuar në lidhje me investimet me financim të huaj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Veprime këto në kundërshtim me Kapitullin n IV pika 49 të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

- Në raportet e monitorimit periodik mungojnë informacionet shtesë për parashikimin e realizimeve të pritshëm deri në fund të vitit si për produktet edhe për shpenzimet, për të evidentuar nëse ky parashikim është më i lartë apo më i ulët se plani fillestar i parashikuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”

- Në raportet e monitorimi mungon rakordimi me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për shpenzimet buxhetore të realizuara nga institucioni.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 12-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Monitorimit dhe mbikëqyrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e planifikimit të investimeve në INSTAT të marrin masat që:

- Në raportet e monitorimit, të relatohet në lidhje me realizimin e treguesve në raport me parashikimin, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të fondeve buxhetore, si dhe ndërmarrjen në kohë të veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, si dhe duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës objekt auditimi INSTAT ka paguar në total shumën 8,853,616 lekë si pasojë e humbjes së gjyqeve nga ish punonjës të INSTAT, të cilët janë liruar nga detyra para vitit 2017 dhe gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë në favor të ish punonjësve me kompensim monetar dhe/ose kthim në detyrë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Instituti i Statistikave të marri masa që lirimet nga detyra të kryhen duke respektuar afatin e njoftimit sipas parashikimit në Kodin e Punës në zgjidhjen e kontratës së punës

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018 në aktiv të bilancit kontabël llogaritë financiare paraqiten në shumën 60,480,888 lekë dhe përfshinë llogarinë 520 “Disponibilitete në thesar” për të njëjtën vlerë e cila është shtuar prej vitit 2017 me 22,428,902 lekë, dhe përfaqëson rritjen e sponsorizimeve që do të trashëgohen në vitin 2019 si dhe rritjen e detyrimeve të shpenzimeve të njohura për vitin 2018 dhe që do të likujdohen në vitin 2019. Në mbështetje të Udhëzimit nr.14 të MF “Procedurat e mbylljes së llogarive”, Llogaria 520 nuk mbyllet në fund të periudhës për sponsorizimet e trashëgueshme.

Nga auditimi u konstatua se, në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 60,480,888 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur nga sponsorizimet, në pasivin e bilancit është paraqitur në llogarinë nr. 85 “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” në vlerën 51,714,902 lekë si dhe një diferencë prej 8,765,986 lekë e cila nuk pasqyrohet.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se, teprica në llogarinë 520 duhet të vërtetohet me aktrakordin me Thesarin, e cila duhet të paraqitet e strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (e ardhur si efekt i sponsorizimeve) për vitin 2018 mungon.

Vlerat e mësipërme të kontabilizuara në llogaritë “Rezultati i mbartur nga funksionimi” dhe “Rezultati ushtrimor nga funksionimi” e denatrojnë këto llogari dhe vlera e mësipërme duhej të paraqitej në klasën 4 “Detyrimet afat shkurtër” që përfaqësohet nga shuma detyrimeve afatshkurtër (specifikisht të analizuara sipas llojeve dhe afateve, kryesisht në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe “Llogari të tjera” që përfaqësohet nga shuma e posteve përkatëse të disa llogarive rregulluese që veprojnë në sensin kreditor). Në rastin konkret, si kundërparti duhet të shërbejë llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, bazuar në përcaktimet e pikës 3, të UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe



njësitë që varen prej tyre si dhe të njëjstëve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar. Llogaria 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, është llogari rregulluese që përfaqëson rezultatin e trashëguar nga viti ose vitet e mëparshme. Në të dhënat shpjeguese të llogarisë vjetore nuk shpjegohet besueshmëria ligjore e rezultatit të trashëguar dhe të sqarohet përbërja e tij (në ndarjen të konstatuara dhe të arkëtuara). Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit nga funksioni” kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë më vete dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepriçë kreditore e kësaj llogarie. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe në pasqyrën financiare të vitit 2017).

(Trajtuar më hollësisht në faqet 28 për vitin 2017 dhe 43 për vitin 2018 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës së INSTAT të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.

3.2 Drejtoria e Financës të marrë masat për të kryer sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85 “Rezultate operacioni” në grupin e llogarive të klasës së 4, për një pasqyrim më të drejtë të kundërpartisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

3.3 Pasqyrat financiare vjetore, të përmbajnë një informacion më të plotë shpjegues, lidhur me pasqyrimin e fondeve, pasi konstatohet mungesa e informacionit mbi shpjegimet e nevojshme të mospërputhjeve të disa llogarive në aktet e rakordimit dhe bilancin kontabël.

3.4 Drejtoria e Financës të informojë në vijimësi menaxhimin e lartë mbi nivelin e realizimit të sponsorizimit dhe fondeve duke i adresuar ato në llogaritë e duhura, si dhe të sqarojnë arsyet për mosrakordimin e të dhënave të pasqyruara në kontabilitet/bilanc me të dhënat e akteve të rakordimit, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në vazhdimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve të ushtrimit, u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 2 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 471,251,939 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 501,262,536 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 2. Në pasqyrat financiare nuk tregohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma. Edhe për vitin 2017 u konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 nuk përputhen me vlerat e paraqitura në akt-rakordimin me degën e thesarit Tiranë, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave paraqiten në vlerën 430,391,536 lekë kurse sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 448,520,652 lekë të cilat nuk rakordojnë me shpenzimet korrente të pasqyrës 3/1.

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Kreu III, “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”, nënkapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pikat 172 dhe 173 si dhe UMF nr. 28, dt. 18.12.2014 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2014” pika 34.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.32 dhe 38-39 për vitin 2017 dhe nr.49-52 për vitin 2018 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës së INSTAT të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.



4.2.Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e INSTAT dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

4.3.Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e shpenzimeve të realizuara kundrejt fondeve të akorduara, realizimin e regjistrit të prokurimeve të parashikuara sipas katër mujorëve, etj.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i “*Të ardhurat e ushtrimit 2018*”, sipas formatit nr. 2 të bilancit vjetor, kanë mospërputhje me të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik, të pasqyruara në aktin e rakordimit vjetor për të ardhurat. Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë për 83,394,541.48 lekë, është shënuar shuma e papërdorur e të ardhurave të vitit 2018 , nga e cila janë derdhur në buxhet 9,055,205.00 lekë dhe mbeten për tu trashëguar në vitin 2019 prej 8,090,685.48 lekë. Konstatohet se, nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në Formatin nr. 2 Performanca Financiare “*Të ardhurat e ushtrimit 2018*”, me të dhënat e aktit të rakordimit vjetor për të ardhurat, rezulton se ka mospërputhje të të ardhurave sipas klasifikimit ekonomik.

Nga analiza e llogarive në pasqyrat financiare (Formati 2), konstatohet se në llogarinë ekonomike 720 “*Grant korrent i brendshëm*” është vënë shuma 418,809,308 lekë, kur sipas aktit të rakordimit mungon ky zë, ndërsa llogaria 7211 “*Grant nga organizma ndërkombëtare*” pasqyrohet me vlerën 74,804,253 lekë në Pasqyrën e performancës ndërkohë që në akt rakordim me vlerën 42,089,336.48 lekë. Po ashtu detajimi i të ardhurave dytësore në akt rakordimin e thesarit pasqyrohet në të tjera llogari nga ato të Pasqyrës së performancës. (I njëjti fenomen ka ndodhur dhe në pasqyrën financiare të vitit 2017)

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.33 dhe 39-40 për vitin 2017 dhe nr.48-56 për vitin 2018 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. Rekomandim:

5.1. Drejtoria e Financës INSTAT të marrë masat për regjistrimin e drejtë dhe ndjekjen e nën llogarive të granteve dhe subvencioneve, duke respektuar klasifikimin ekonomik kontabël dhe bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “*Për sponsorizimet*”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar.

5.2.Të hartohen dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për të ardhurat e ushtrimit nga veprimtaria e INSTAT dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

5.3.Nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik dhe Nëpunësit Zbatues të përgatiten raporte periodike tremujore për menaxhimin e lartë, lidhur me nivelin e të ardhurave të siguruara, arkëtimin e tarifave nga licencimi, kryerja e analizave, grantet etj., si dhe përdorimit të këtyre shumave.

5.4.Regjistrimi dhe pasqyrimi në kontabilitet i llogarive duhet të kryhet në përputhje me Parimet e kontabilitetit në sektorin publik, ku dy prej të cilëve specifikojnë se, pasqyrat financiare duhet të sigurojnë transparencë si dhe të jenë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e jashtëm të tyre.

Periodikisht dhe çdo muaj

6.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare **të vitit 2018** (të aparatit edhe ato të konsoliduara) në zërin e aktiveve afatgjata, llogaria 203 “*Koncensione, patenta, licenca e të ngjashme*” është shtuar nga viti i shkuar me 1,873,730 lekë. Nga auditimi u konstatua se, në bilancin **e vitit 2017** vlera e kësaj llogarie figuronte 0 lekë ndërsa në bilancin e vitit 2018 tek rreshti ‘ushtrim paraardhës’ rezulton me vlerën 5,389,513 lekë, shifër e cila as në shënimet shpjeguese nuk justifikohet se nga vjen.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



6.1Rekomandim:Drejtoria e Financës INSTAT të marrë masa për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare në përputhje me Udhëzimin mbi përgatitjen e llogarive vjetore.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aktiveve, u konstatua se në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pasi regjistri është prezent në formë elektronike, në përputhje me pikën 30 të udhëzimit i hartuar në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit por pa specifikimet e tjera sikundër kërkon Udhëzimi i sipërcituar.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1Rekomandim: Drejtoria e Financës INSTAT të marrë masa që regjistri i aktiveve përveç hartimit të tij sipas llojit të aktiveve afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, që lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga ana e INSTAT është zbatuar pjesërisht detyrimi i pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nuk është përgatitur inventari i pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, nuk janë dërguar në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP) listat e inventarit, për t’iu dërguar më tej për miratim Këshillit të Ministrave. Nuk ka asnjë praktikë shkresore apo kërkesë administrative, ku ti kërkohej AITPP, regjistrimi i inventarizimit të pronave të institucionit. Gjithashtu, vërehet se mungon aprovimi i listës së pronave dhe fillimi i procedurave për miratimin e listës së inventarit. Gjithashtu konstatohet se, nuk është finalizuar procesi i miratimit të listës së pronave dhe nuk është vijuar me procedimin për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP.

Sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, INSTAT nuk ka nisur asnjë procedurë për regjistrimin e marrjes së aktit në përdorim të pasurisë dhe kufijve të kësaj pasurie të paluajtshme.

Ndërtesa që INSTAT disponon është regjistruar në kontabilitet, në bilancin kontabël të datës 31.12.2018 me vlerën që i është vendosur në Urdhrin e kalimit kapital, por nuk kemi informacion nëse kjo pronë është e regjistruar në inventarin e shtetit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjithashtu për të nuk zotërohet Akti i marrjes në përdorim, në kundërshtim këto me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e INSTAT nuk janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që ky institucion ka në dispozicion, plani i rievimit (kadastral dhe topografik), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nuk arritëm të sigurojmë informacion nëse përcaktimi i vlerës së tokës është kryer bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.



(Trajtuar më hollësisht në faqen 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.Rekomandim:

8.1.Drejtori i INSTAT, të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e këtyre objekteve, të ndërtojë gjurmën e auditimit për mënyrën e sigurimit të kësaj pasurie, duke saktësuar origjinën dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, si dhe pas saktësisht të listës përfundimtare, duke reflektuar efektet e vendimeve të Këshillit të Ministrave për vlerësimin e trojeve dhe të pronave që ky Institutucion ka administruar, të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore e të pasqyrojnë situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit.

8.2.Të aplikohet pranë AITPP, pasi të jenë kryer korrigjimet e duhura dhe rakorduar gjendjen e këtyre pasurive me listën analitike të aktiveve të INSTAT

Në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit të aktiveve materiale u konstatua se:

1. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, pasi *nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit*, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Nuk ka një evidentim të situatës së inventarizimit për çdo llogari, arsyetimi i shkaqeve mbi inventarin jashtë funksionit, qëndrimi i titullarit / disponimi mbi mënyrën se si do të procedohet në vijim, etj.

2. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2017-2018 *nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë*, (ekziston një informacion, që nuk është në përputhje me detyrimet e UMF nr. 30/2011), në kundërshtim me paragrafin nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011’.

Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.

3. Procesi i inventarizimit nuk jep informacion për të dhënat e aktiveve, siç përcakton paragrafin nr. 95, e UMF nr. 30, që përcakton se *“ky është një proces që kryhet gjatë ose pas inventarizimit. Mbi bazën e procesit të të dhënave për vitin e vënies në punë, përdorimit, vlerën fillestare, kohën, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”*, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast. Si mangësi në pamje të parë për realizimin e këtij inventarizimi rezultoi se komisioni nuk ka pasqyruar vitin e blerjes apo të bërjes hyrje të aktiveve dhe nuk ka një analizë për destinacionin përfundimtar, mundësinë e riparimit të pajisjeve, etj.

4. Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 103, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

5. Nga ana e komisioneve të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, mirëpo *nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit* po ashtu nuk është operuar konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011 duke marrë si referencë pikën 95 e vazhdim.

6. Rezultoi se, materialet e përcaktuara për nxjerrje jashtë përdorimi qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces mbahen në zyra dhe jo në magazinë, me argumentimin e mungesës së hapësirës fizike në këtë të fundit.

7. Nga auditimi rezultoi se, nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të rretheve kryhet në Tiranë dhe jo pranë qendrave ku janë pjesë këto aktive.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. Rekomandim



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

9.1. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar dhe kriteret për vlerësim, procesverbalin për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve në referencë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9.2. Nga strukturat e menaxhimit të INSTAT të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, duhet të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

9.3. Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

9.4. Drejtori i INSTAT duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionet për vlerësim të pasurive në mënyrë që të sigurojë informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë. Gjithashtu, Nëpunësi Zbatues detyrimisht para se të kryhet inventarizimi fizik i aktiveve nga komisionet përkatëse, është i detyruar që tu vejë në dispozicion regjistrat e aktiveve sipas gjendjeve kontabël, ku komisionet kanë për detyrë për të evidentuar sasi të fizike.

9.5. Të shmangët praktika e nxjerrjes jashtë përdorimit bazuar vetëm mbi kredenciale të punonjësit por të operohet në përputhje me Udhëzimin 30.

9.6. Të shmangët praktika e mbajtjes së aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit në zyra qysh prej momentit të vlerësimit si të tilla e deri në momentin që nis ky proces

9.7. Të vlerësohet mundësia e transferimit me ose pa pagesë e aktiveve të cilat njësisë nuk i hyjnë më në punë pranë njësive rajonale apo institucioneve të tjera.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Përsa i përket debitorëve të ndryshëm, pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 1,295,034 lekë, pas auditimit të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e institucionit mbi korrespondencën e mbajtur me këta debitorë, i përket mundësisë së arkëtimit të këtyre shumave, u konstatua se, Subjekti i ka pjesërisht të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

-Detyrimet e mbartura janë përpara vitit 2008 dhe kanë mundësi shumë të pakta arkëtimi (Trajtuar më hollësisht në faqet 26,27 për vitin 2017 dhe 44 për vitin 2018, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Në lidhje me detyrimet e mbartura përpara vitit 2008 duke parë historikun e mundësive për arkëtim të tyre që është i ulët, bazuar në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12, pika 3g e cila specifikon se, „Nëpunësi zbatues duhet të garantojë mbledhjen e të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta, rekomandoj të ndiqen edhe njëherë të gjitha hapat ligjore për rikuperimin e debitorëve dhe të vlerësohet mundësia e testimit për zhvlerësimin e tyre duke mos rënduar më pasqyrat financiare.

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: U konstatua se, në vitin 2017 janë nxjerrë jashtë përdorimit 4 (katër) automjete dhe në vitin 2018 janë nxjerrë në ankand 2 prej tyre, Ford Mondeo dhe Opel Frontera



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

por nuk janë shitur se nuk kanë patur ofertues. Për automjetin Land Rover Discovery nga kontrolli teknik i bërë për këtë qëllim, janë dhënë dy opsione, i pari është riparim i motorit me një kosto 238,000 lekë dhe i dyti blerja e një motori të përdorur me kosto 150,000 lekë, por komisioni bazuar në gjendjen e amortizuar dhe koston tepër të lartë për ta rikthyer në punë vendosi nxjerrjen jashtë përdorimit. Aktualisht këto automjete vazhdojnë të mbahen në hapësirën e INSTAT.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Bazuar në faktin që automjetet nuk janë shitur në Ankand, gjykojmë që këto automjete të dala jashtë përdorimit duhet të shiten për skrap pas vlerësimit nga një ekspert i licencuar, (nisur nga fakti se përveç peshës së lëndës hekur, automjetet kanë edhe lëndë të ndryshme përbërëse si bakër, alumin etj., të cilat kanë çmime të ndryshme) referuar dhe faktit që ka shpenzime shtesë për transportin dhe asgjësimin e tyre duke qenë se janë të palëvizshme.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me rregullshmërinë e paraqitjes së pasqyrave financiare, u konstatua se, Pasqyrat financiare, si të aparatit ashtu edhe të konsoliduarat, për vitin 2017 dhe 2018 nuk janë shoqëruar me relacionin përkatës i cili është domosdoshmëri të bashkangjitet dërgimit të tyre.

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Nga ana e Zv. Drejtorit Ekonomik, Drejtorit të Përgjithshëm si dhe Drejtorit të Financës të merren masa për të plotësuar mungesën e rregullshmërisë në lidhje me pasqyrat financiare.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rakordimin e vlerave mes situacionit të shpenzimeve dhe ato të pasqyruara në pasqyrat financiare, për të dy vitet objekt auditimi 2017/2018, u konstatua se, për llogarinë 231 në situacionin e shpenzimeve pasqyrohej vlerë, si në planin vjetor ashtu edhe në shpenzime thesari, ndërkohë në aktiv të bilancit kontabël kjo llogari nuk paraqitej me asnjë vlerë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Nga ana e INSTAT të merren masa nga Drejtoria e Financës të marrë masat për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: - Në rregulloren e brendshme të INSTAT apo edhe të secilës drejtori nuk parashikohet shprehimisht rruga/gjurma që ndiqet për informimin që përgjegjësit e sektorëve i bëjnë Titullarit me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. - Nuk janë bërë pjesë e planit të trajnimeve temat në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të MFK.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: : Të merren masa që të parashikohet qartë raportimi nga poshtë lartë, në rregulloren e brendshme.

14.2. Të merren masa që të përfshihen në planin vjetor të trajnimeve tema në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, për të gjithë stafin e INSTAT.

Në vazhdimësi



15. Gjetje nga auditimi Në Institucionin INSTAT rezultoi se, sektori i auditimit është një strukturë jo e plotë me burime njerëzore dhe si rrjedhojë numri i auditimeve është ulur, duke mos plotësuar me auditim të gjitha subjektet dhe drejtoritë me risk. Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i përgjegjës të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bëhet në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 75-76 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15. Rekomandim:

15.1. INSTAT duhet të marrë masat e menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e auditimit si dhe të shqyrtohet mundësia e rritjes së numrit të audituesve në INSTAT, me qëllim mbulimin e të gjitha fushave me risk dhe rritjen e frekuencës së angazhimeve të auditimit.

15.2. Sektori i auditimit të brendshëm, të marrë masa që të rrisë frekuencën e auditimeve të IT dhe auditimeve të performancës në INSTAT. Të merren masa nga menaxhimi i lartë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit të brendshëm.

Në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Grupi i Auditimit

**ANEKSI I:****QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT**

Gjatë procesit të planifikimit, janë mbledhur informacion për subjektin në mënyrë që të vlerësohet risku dhe të përcaktohen nivelet e materialitetit për hartimin e procedurave të auditimit. Evidencat e mbledhura më pas janë vlerësuar si një bazë për formimin e përfundimeve dhe për qëllime raportimi. Materialiteti është i rëndësishëm për këtë vlerësim.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe kryqëzimin e tyre me të dhënat e gjeneruara nga databaza e sistemit të Thesarit, në Ministrinë e Financave, si edhe rakordimi në situacionet e Thesarit.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 2% ku niveli i precizionit pranohet në vlerën 8,652 mijë lekë për vitin 2018 dhe 12,325 mijë për vitin 2019.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan: teste të detajeve

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
31.12.2018			
Paga (600)	349,979	0.7	28
Sigurime Shoqërore (601)	56,533	0.7	5
Mallra e Shërbime (602)	81,195	2	19
Shpenzime llog 604-606	108	0.7	0
Investime të brenda. (230-231)	46,267	0	0
Total	534,082		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	10,682		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,068		
Nëntotali	9,613		
Pozicioni i planifikuar (80 - 90%)	90%		
Vlera e pozicionit	8,652		

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
31.12.2019			
Paga (600)	416,524	0.7	24
Sigurime Shoqërore (601)	69,320	0.7	4
Mallra e Shërbime (602)	80,367	2	13
Shpenzime llog 604-606	1,067	0.7	0
Investime të brenda. (230-231)	193,519	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT NË INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Total	760,797
Materialiteti në %	2%
Materialiteti në vlerë	15,216
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,522
Nëntotali	13,694
Pozicioni i planifikuar (80 - 90%)	90%
Vlera e pozicionit	12,325

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):

- kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “efektiv”;
- kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si “pjesërisht efektiv” ose “jo efektiv”.

Aneksi II:

Llojet e opinioneve të aplikuara nga klsh.

Baza për Opinionin

a. Manuali i auditimit financiar të KLSH.

Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinionin me rezerve. Opinionin me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinionin i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

- kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose



2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinion i negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

Aneksi III:

Auditimi i detyrimeve (Të tjera operatione me shtetin).

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin (42 e 43).

Nëmarrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor”

- llogaria 4341 “Të tjera operatione me shtetin kreditor”

Llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm këto) si; pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Nëse veprimi kontabël:

- a. Është bërë gjatë konstatimit të shpenzimit veprimi;
 - debi llogarite respektive të klasës 6 “shpenzime korrente”,
 - kredi llogarite e detyrimeve afat shkurtër për konstatimin e detyrimit (42,43,40, e tjera).
- b. Në fund të periudhës ushtrimore është bërë veprimi;
 - debi llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor”
 - kredi llogari 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”
- c. Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës është bërë veprimi;
 - debi llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4)
 - kredi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.
- d. Paralel me veprimin e mësipërm nëse është artikuluar veprimi tjetër;
 - debi llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”



- kredi llogaria 4342 “*Të tjera operatione me shtetin debitor*”;

Llogaria 4341 “*Të tjera operatione me shtetin kreditor*”, është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuar e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Nëse veprimi kontabël;

- a. Është bërë konkretisht kur më parë ka ndodhur situata për konstatimin e një të ardhure (*pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion*);
- debi llogaria 411/468, “*klientë e llogari të ngjashme*” apo “*debitorë të ndryshëm*”,
- kredi llogarite respektive të klasës 7, të ardhura të konstatuar.
- b. Kur e ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi;
- debi llogaria 8424 “*Transferim për debitorë të konstatuar të ngjashëm*”,
- kredi llogaria 4341 “*Të tjera operatione me shtetin kreditor*”,
- c. Në momentin kur arkëtohet e ardhura është kryer veprimi;
- debi llogaria 520 “*Disponibilitete në thesar*”;
- kredi llogaria 411/468, “*klientë e llogari të ngjashme*” apo “*debitorë të ndryshëm*”,
- d. Me qenë se e drejta u arkëtua dhe llogaria 520 është llogari e thesarit nëse në fund të periudhave përkatëse është bërë veprimi përkatës;
- debi llogaria 4341 “*Të tjera operatione me shtetin kreditor*”,
- kredi llogaria 520 “*Disponibilitete në thesar*” (*për mbylljen e kësaj pjese*).

Aneksi IV:

Auditimi i detyrimeve

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogaria 45 “*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*”.

Ky grup llogarish përfaqëson specifikat që shoqërojnë marrëdhëniet e institucioneve me njëra tjetrën dhe me të tjerë të tretë për xhirimet materiale në natyrë.

Nga pikëpamja e kontabilitetit institucionet e lidhura auditohen nëse përgjithësisht kanë përdorur skemën si me poshtë;

- a. Institucioni dhënës i cili ka kryer blerjet mbi bazën e fondeve të akorduara sipas skemës së zakonshme të buxhetimit, përveç veprimeve që lidhen me blerjen e operacionet e tjera buxhetore, nëse i ka bërë hyrje materialet e blera.
- Debi llogaritë e klasës 3 në kredi të llogarisë 63 “*Ndryshim i gjendjeve të inventarit*”.
- b. Institucioni dhënës për daljet pa pagesë që u bën njërive vartëse apo të tretëve nëse;
- Krediton llogaritë përkatëse të klasës 3 me kundër parti debitin e llogarive të grupit 45 “*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*”.
- c. Institucioni dhënës nëse ka mbyllur llogarinë 45 pas marrjes së konfirmimit nga institucioni përfitues dhe ka;
- debituar llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*” në kredi të grupit 45 “*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*”.
- d. Institucioni marrës i këtyre vlerave nëse i ka bërë hyrje ato duhet të;
- debitojë llogarite përkatëse të klasës 3 me kundër parti kreditimin e llogarisë së grupit 45 “*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*”.
- e. Institucioni marrës nëse e ka mbyllur llogarinë 45 “*marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*” me dërgimin e konfirmimit në institucionin dhënës dhe të debitojë këtë llogari në kredi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*”.
- f. Llogaria 45 “*Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit*” në fund të periudhës ushtrimor duhet të rakordohet dhe, si rregull, duhet të jetë e mbyllur.

**Llogaria 466** “Kreditorë për Mjete në ruajtje”.

Është llogari specifike në sektorin publik.

Në kredi të saj regjistrohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve të cilat në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve.

Të tilla mund të jenë:

- mjetet e xhiruara për llogari të zyrës së përmbarimit,
- paradhëniet e paguara nga të tretet për pjesëmarrje në ankande,
- garancitë bankare të ndryshme,
- të hyra për llogari të komisionit të kthimit e kompensimit të pronave,
- derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen,
- depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër,
- rimbursimi i tvsh nga llogaria e tatimeve,
- etj.

Llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”, përdoret si llogari kalkulative gjatë vitit ushtrimor.

Veprimet e mundshme në kontabilitet me këtë llogari janë;

- Debi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në kredi të llogarisë 476, për akordimin e fondeve buxhetore.
- Debi llogaria 476 (ose kredi me stornim) në kredi të llogarisë 520 (ose debi me stornim) për fondet buxhetore të pa përdorura në fund të periudhës ushtrimore dhe që nuk trashëgohen për vitin e ardhshëm.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 105, “Grante të brendshme kapitale” apo në kredi të llogarisë 720 “Grante korrente të përgjithshme” lidhur me përdorimet e këtyre fondeve respektivisht për investime e për shpenzime funksionimi.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 4342, paralel me pagesën e bërë për shlyerje detyrimesh të vitit të mëparshëm me fondet e akorduara të vitit ushtrimor.

Llogaria 481 “Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime”, karakteristike kryesisht për institucionet e vetëqeverisjes vendore. Është llogari rregulluese ku përfshihen shpenzimet e kryera për riparimet e mëdha, shpenzimet për punime parapërgatitore të një lloji veprimtarie, shpenzime të kryera gjatë vitit ushtrimor (që nuk përfshihen në aktivet e qëndrueshme dhe nuk mund të rëndohen tërësisht në rezultatin e ushtrimit). Këto shpenzime shpërndahen (amortizohen) në vitet e ardhshme.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i te cilave ndodh në një ushtrim të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh. qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara avancë, e tjera.

Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse” e cila hyn në grupin e llogarive rregulluese. Sipas rastit të çdo institucioni evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.

Llogaria 478 “Diferenca konvertimi -pasive” pasqyron diferencat pasive që lidhen me konvertimet që rezultojnë nga vlerësimi me kurset e këmbimit në mbyllje të ushtrimit (të kërkesave debitore dhe detyrimeve) të shprehura në monedha të huaja.

Llogaria 480 “Të ardhura për t’u klasifikuar ose për tu rregulluar” pasqyron të ardhura të arkëtuara, por me dokumentacion të pa plotësuar ose të paqartë deri në datën e mbylljes së bilancit kontabël të institucionit. Teprica kreditore e kësaj llogarie kërkon sqarime në të dhënat shpjeguese.

Llogaria 487 “Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së urdhrat” regjistron të ardhurat e arkëtuara, të cilat ekzistojnë në institucion të derdhura por nuk është marrë konfirmim nga Thesari deri në fund të periudhës ushtrimore.



Aneksi V:

Dokumentimi i levizjes së aktiveve.

(Bazuar në UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

- Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kudoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues – janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomike që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumente vërtetues – vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletë hyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandatarkëtimet, mandatpagesat, procesverbalet, dhe te tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit – janë dokumentet përmbledhës, ose regjistrat kontabël (*libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj*) të çdo lloji forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore, ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

- Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (*Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë*).

- Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletë daljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve.

- Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë. Aktiviteti që hyjnë pjesë-pjesë për në vendmbërritje, pasqyrohen me dokumente të përkohshme, por fletë hyrja ose fletë dalja për gjithë sasinë plotësohet me mbërritjen e gjithë sasisë së aktivitetit, duke u bashkëlidhur edhe dokumentet e përkohshme.

- Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (*shitësit*) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre.

- Në raste të caktuara sipas nevojave të njësisë publike, behet dërgimi i aktiveve drejtpërdrejt nga furnizuesi ose dhuruesi të përdoruesit (*p.sh direkt në njësinë shpenzuese të njësisë publike*) dhe bëhen hyrje e dalje pa kaluar në magazinë (*p.sh. Në magazinën qendrore të njësisë publike*). Në këtë rast duhet të miratohen nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike procedura të qarta të lëvizjes, të shoqëruara me përgjegjësitë respektive. Veprimet bëhen në prani të punonjësve të ngarkuar me administrimin e aktiveve.